



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 184

Tiranë – E martë, 31 dhjetor 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 83/2019, datë 18.12.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 14987
Dekret i Presidentit nr.11399, datë 30.12.2019	Për shpallje ligji..... 14995
Ligj nr. 84/2019, datë 18.12.2019	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar..... 14995
Dekret i Presidentit nr. 11400, datë 30.12.2019	Për shpallje ligji..... 14997
Ligj nr. 85/2019, datë 18.12.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 14997
Dekret i Presidentit nr. 11401, datë 30.12.2019	Për shpallje ligji..... 15000
Ligj nr. 86/2019, datë 18.12.2019	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar..... 15000
Dekret i Presidentit nr. 11402, datë 30.12.2019	Për shpallje ligji..... 15001
Ligj nr. 88/2019, datë 18.12.2019	Për buxhetin e vitit 2020..... 15001
Dekret i Presidentit nr. 11403, datë 30.12.2019	Për shpallje ligji..... 15049
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 866, datë 24.12.2019	Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale, 2020–2023, dhe të Planit të Veprimit në zbatim të saj..... 15049

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 882, datë 24.12.2019	Për mekanizmin e bashkërendimit ndërinstitucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike.....	15093
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 884, datë 27.12.2019	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 391, datë 3.5.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të regjistrimit dhe të publikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit”.....	15124
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 885, datë 24.12.2019	Për një ndryshim në vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë”, të ndryshuar.....	15125
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 886, datë 30.12.2019	Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2019, për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për përballimin e shpenzimeve për inspektimin dhe vlerësimin e dëmeve në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të prekura nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019.....	5125
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 888, datë 31.12.2019	Për organizimin dhe funksionimin e Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor.....	15126



LIGJ
Nr. 83/2019

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 9920, DATË 19.5.2008,
“PËR PROCEDURAT TATIMORE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 41, pika 1, fjalia e dytë, fjalët “sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 121, të këtij ligji” zëvendësohen me fjalët “sipas pikës 2, të nenit 121, të këtij ligji”.

Neni 2

Në nenin 46 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, fjalët “faturë tatimore, dëftesa tatimore ose kupon tatimor” zëvendësohen me fjalën “faturë”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Tatimpaguesi nuk është i detyruar të mbajë regjistra të veçantë, sipas pikës 2, të këtij neni, për të cilët administrata tatimore harton raporte automatike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.”.

Neni 3

Në nenin 47 bëhen këto ndryshime:

1. Fjalët “ faturë të thjeshtë tatimore apo kuponë tatimore” zëvendësohen me fjalën “faturë”.

2. Në fund të paragrafit shtohen fjalët “dhe legjislacionit në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.

Neni 4

Në nenin 48, pika 3 shfuqizohet.

Neni 5

Nenet 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55 dhe 56 shfuqizohen.

Neni 6

Në nenin 57, pika 4, fjalët “fatura të thjeshta tatimore, dëftesa tatimore dhe kuponë tatimore” zëvendësohen me fjalën “faturë”.

Neni 7

Në nenin 58, pas fjalëve “dokumentet e nevojshme tatimore” shtohen fjalët “duke përfshirë faturën e shoqërimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.

Neni 8

Në nenin 71, shkronja “ë” ndryshohet si më poshtë:

“ë) tatimpaguesi nuk lëshon faturë dhe/ose nuk kryen procedurat e fiskalizimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.”.

Neni 9

Në nenin 75, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Në raste të veçanta, shumat e tatimeve dhe të taksave për t’u paguar apo të paguara më tepër në administratën tatimore ose administratën doganore mund të kompensohen përkundrejt njëra-tjetrës. Ministri përgjegjës për financat përcakton me udhëzim rastet e veçanta, procedurat dhe kriteret për zbatimin e kësaj pike.”.



Neni 10

Në nenin 75/1, pas pikës 1/1 shtohet pika 1/2 me këtë përmbajtje:

“1/2. Përjashtimisht përcaktimeve të pikave 1 dhe 1/1, të këtij neni, në raste të veçanta, me kërkesë të administratës tatimore dhe me dakordësinë e tatimpaguesit mund të lidhet një marrëveshje për pagesë me këste, e cila përmban një plan të skeduar pagesash për detyrimet që administrata tatimore ka ndaj tatimpaguesve, si rezultat i kërkesave të miratuara për rimbursimin e TVSH-së. Në këto raste, detyrimi i administratës tatimore ndaj tatimpaguesit konsiderohet i shlyer dhe nuk aplikohen kamatëvonesat. Rastet kur do të aplikohet, procedurat dhe kriteret për zbatimin e kësaj pike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 11

Në nenin 77, pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Marrëveshja për pagesë me këste mund të lidhet për detyrime tatimore të vendosura nga administrata tatimore, si rezultat i një vlerësimi tatimor të kryer, sipas nenit 68, të këtij ligji, si dhe për detyrime tatimore të vetëdeklaruar nga tatimpaguesi.

Pavarësisht sa më sipër, administrata tatimore nuk hyn në një marrëveshje të pagesës me këste, për detyrim tatimor mbi të ardhurat, të mbajtur në burim dhe të vetëdeklaruar nga tatimpaguesi, si dhe për detyrim nga kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, i cili është llogaritur ose mbledhur, ose mbajtur prej tatimpaguesit.

Përjashtimisht, në rastet kur në cilësinë e tatimpaguesit janë institucione apo ente shtetërore apo publike, qendrore apo vendore, apo ente të tjera ku shteti është palë, për raste të një interesi të lartë publik ose të nevojës për moslejimin e cenimit të rendit e të sigurisë kombëtare, mund të lidhet një marrëveshje me këste edhe për detyrimet e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

Marrëveshja me këste nuk lehtëson pozitën ligjore të personit përgjegjës në rastet e prezumimit apo të konsumimit të veprës penale të parashikuar ligjërisht, lidhur me detyrimin tatimor të vetëdeklaruar nga tatimpaguesi, i cili është llogaritur ose mbledhur, ose mbajtur prej tij, përfshirë

kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore.”.

Neni 12

Në nenin 80, pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Administrata tatimore kryen mbikëqyrjen e dispozitave të lëshimit të faturave dhe të monitorimit të qarkullimit (në vijim, kontrolli i lëshimit të faturave), në përputhje me legjislacionin në fuqi për faturën e sistemin e monitorimit të qarkullimit dhe tatimin mbi vlerën e shtuar.”.

Neni 13

Në nenin 81, pas pikës 6 shtohen pikat 7, 8, 9 dhe 10 me këtë përmbajtje:

“7. Njoftimi i kontrollit tatimor i lëshimit të faturave i dërgohet tatimpaguesit në të njëjtën ditë kur fillon kontrolli tatimor në vendndodhjen e biznesit të tatimpaguesit.

8. Njoftimi, sipas pikës 7, të këtij neni, përveç të dhënave të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 2, të këtij neni, përmban edhe të dhënat e mëposhtme:

a) përshkrimin e të drejtave dhe të detyrimeve të tatimpaguesit gjatë dhe pas përfundimit të kontrollit tatimor;

b) nënshkrimin e personit përgjegjës të administratës tatimore.

9. Me përjashtim të pikave 7 e 8, të këtij neni, njoftimi i kontrollit tatimor i lëshimit të faturave nuk është i nevojshëm t’i dërgohet tatimpaguesit përpara fillimit të kontrollit tatimor, nëse kontrolli tatimor ka filluar mbi bazën e informacionit nga strukturat kompetente, sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi dhe njoftimi paraprak i tatimpaguesit do të rrezikonte qëllimin e kontrollit tatimor. Në këtë rast kontrolli tatimor fillon menjëherë.

10. Në rastet e përcaktuara në pikën 9, të këtij neni, njoftimi i kontrollit tatimor i dërgohet tatimpaguesit në të njëjtën kohë me raportin e kontrollit tatimor, sipas nenit 83 të këtij ligji.”.

Neni 14

Në nenin 83, pas pikës 6 shtohen pikat 7, 8, 9, 10 e 11 me këtë përmbajtje:



“7. Në rastin e kontroleve për lëshimin e faturave, raporti i kontrollit tatimor përmban rezultatet e kontrollit tatimor dhe listën e shkeljeve të konstatuara, përfshirë edhe përshkrimin e dispozitave ligjore, të cilat janë shkelur. Raporti i kontrollit tatimor i lëshimit të faturave nënshkruhet nga inspektori/inspektorët, i cili/të cilët kanë marrë pjesë në kontrollin tatimor.

8. Raportin e kontrollit tatimor të lëshimit të faturave, sipas pikës 7, të këtij neni, e miraton struktura përkatëse e ngarkuar me atë detyrë. Një kopje e raportit të kontrollit i dërgohet me postë tatimpaguesit.

9. Tatimpaguesi ka të drejtë t'i kundërshtojë rezultatet e kontrollit tatimor brenda 15 ditëve kalendarike, duke filluar nga e nesërmja e datës së marrjes së aktit.

10. Pas marrjes së kundërshtimit ndaj raportit të kontrollit tatimor, kryhet një raport plotësues, i cili nënshkruhet nga personi që mbikëqyr inspektorët, të cilët kanë kryer kontrollin tatimor, ndërsa miratohet nga personi përgjegjës i drejtorisë rajonale të tatimeve, duke përfshirë përgjegjësin e sektorit, drejtorin e drejtorisë përkatëse dhe drejtorin e drejtorisë rajonale të tatimeve.

11. Nëse në raportin e kontrollit tatimor konstatohen shkelje, zbatohen dënimet administrative të parashikuara në legjislacionin tatimor.”.

Neni 15

Pas nenit 81 shtohet neni 81/1 me këtë përmbajtje

“Neni 81/1

1. Administrata tatimore kryhen verifikime në terren për zbulimin në kohë të shkeljeve lidhur me regjistrimin e personave të tatueshëm; përdorimin e pajisjeve fiskale; dokumentimin e mallrave në ruajtje, përdorim dhe transport; dokumentimin e çdo transaksioni shitjeje të mallrave apo të shërbimeve dhe lëshimin e faturave tatimore; regjistrimin e punonjësve, si dhe çdo verifikim tjetër për zbatimin e legjislacionit tatimor.

2. Verifikimet, sipas pikës 1, të këtij neni, kryhen pa njoftimin paraprak të personit të tatueshëm. Përpara verifikimit, punonjësi i administratës tatimore tregon dokumentin personal të identifikimit si dhe urdhrin ditor të punës, të

lëshuar nga drejtori i drejtorisë përgjegjëse për verifikimin në terren.

Për kundërvajtjet administrative tatimore, të evidentuara gjatë verifikimit në terren, merren masat administrative sipas këtij ligji.

Neni 16

Në nenin 88, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje.

“5. Mbledhja e detyrimeve të papaguara kryhet nga drejtoritë përgjegjëse të mbledhjes me forcë të detyrimeve të papaguara, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.”.

Neni 17

Në kreun XI, kudo në nenet 88 deri në 104, të këtij ligji, përcaktimi “drejtori i drejtorisë rajonale tatimore” zëvendësohet me përcaktimin “drejtori i drejtorisë përgjegjëse për mbledhjen e detyrimeve të papaguara.”.

Neni 18

Në nenin 90, pika 1, pas fjalëve “i kërkon çdo banke” shtohen fjalët “shqiptare të nivelit të dytë, sipas përcaktimeve në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat”.

Neni 19

Në nenin 91, pika 1, pas fjalëve “sigurohet në favor të administratës tatimore mbi të gjithë pasurinë e tatimpaguesit” shtohen fjalët “në përputhje me rregullat e detajuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat”.

Neni 20

Në nenin 96 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit riformulohet: “Shitja e pasurisë së konfiskuar”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Ministria përgjegjëse e drejtësisë dhe ministria përgjegjëse për financat, me udhëzim të përbashkët, përcaktojnë procedurat që do të zbatohen për shitjen e pasurisë së konfiskuar sipas aktit administrativ të konfiskimit.”.



Neni 21

Në nenin 103, pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Deklarimi i pambledhshëm i detyrimit tatimor apo i një pjese të tij bëhet si më poshtë:

a) për shuma deri në 1 000 000 (një milion) lekë bëhet me urdhër të drejtorit rajonal të tatimeve, bazuar në vendimin e marrë nga komisioni i ngritur për këtë qëllim në DRT, i cili funksionon sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat, në zbatim të këtij ligji.

b) për shuma mbi 1 000 000 (një milion) lekë deri në 5 000 000 (pesë milionë) lekë, sipas propozimit të DRT-së, bëhet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, bazuar në vendimin e marrë nga komisioni i ngritur për këtë qëllim në DPT. Komisioni funksionon sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat, në zbatim të këtij ligji.

c) për shuma mbi 5 000 000 (pesë milionë) lekë, sipas propozimit të DPT-së, bazuar në vendimin e marrë nga komisioni i ngritur për këtë qëllim në DPT, bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për financat. Komisioni funksionon sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat, në zbatim të këtij ligji.”.

Neni 22

Në nenin 119, pika 1, fjalia e dytë e shkronjës “b” kalon si paragraf më vete dhe ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Këto gjopa nuk aplikohen në rastin kur nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e aktivitetit të tatimpaguesit me status ligjor person fizik, evidentohen persona mbi 16 vjeç, të cilët deklarohen si “të vetëpunësuar me punonjës të papaguar të familjes”. Pas konstatimit, organi tatimor vërteton në portalin “e-Albania”, nëpërmjet certifikatës familjare të të vetëpunësuarit, nëse ai plotëson ose jo kushtet për t’u konsideruar si person i papaguar i familjes apo si bashkëjetues, sipas kuptimit të Kodit Civil.

Neni 23

Neni 121 riformulohet si më poshtë:

“Neni 121

Mallrat e pashoqëruara me dokumente tatimore

1. Për tatimpaguesit, që mbajnë në ruajtje, përdorin ose transportojnë mallra të pashoqëruara me dokumente tatimore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit, aplikohen dënimet si më poshtë:

a) tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, të cilët nuk janë të regjistruar për TVSH-në, dhe tatimpagues të tjerë dënohen me gjobë prej 25 000 lekësh;

b) tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël dhe për TVSH-në dënohen me gjobë prej 50 000 lekësh;

c) tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit mbi fitimin dhe për TVSH-në dënohen me gjobë prej 75 000 lekësh.

2. Personi, i cili ushtron veprimtari ekonomike tregtare i paregjistruar, sipas përcaktimeve të nenit 41, të këtij ligji, dënohet me gjobë prej 50 000 lekësh.

3. Për shkeljet e parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, në përputhje me përcaktimet e nenit 116, të këtij ligji, administrata tatimore kallëzon penalisht tatimpaguesin, në përputhje me parashikimet e nenit 131 të këtij ligji.

4. Ruajtja, përdorimi ose transportimi i mallrave, me qëllim të ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, sipas kuptimit të pikës 1, të këtij neni, konsiderohet ajo sasi e mallrave, pavarësisht nga lloji, origjina dhe prishja, që nuk i shërben as nevojave të personit të kapur me mallra, as anëtarëve të familjes së tij.”.

Neni 24

Neni 122 ndryshohet në titull dhe në përmbajtje si më poshtë:

“Neni 122

Shkeljet për mosregjistrimin e të dhënave të subjekteve që lëshojnë fatura

1. Personi, i cili është subjekt i lëshimit të faturës ose i faturës shoqëruese, në përputhje me legjislacionin në fuqi për faturën dhe sistemin e



monitorimit të qarkullimit, dënohet me gjobë si më poshtë:

a) tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, të cilët nuk janë të regjistruar për TVSH-në, dhe tatimpagues të tjerë dënohen me gjobë prej 25 000 lekësh;

b) tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël dhe për TVSH-në dënohen me gjobë prej 50 000 lekësh;

c) tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit mbi fitimin dhe për TVSH-në dënohen me gjobë prej 75 000 lekësh.

2. Gjobat, sipas shkronjave “a”, “b”, “c”, të pikës 1, të këtij neni, aplikohen nëse:

a) brenda 24 orëve përpara lëshimit të faturës së parë, nuk njofton administratën tatimore për fillimin e kryerjes së furnizimit me mallra e shërbime, mbi bazën e së cilës është i detyruar të lëshojë fatura në përputhje me këtë ligj, përveç nëse është person i regjistruar në regjistrin e administratës tatimore si tatimpagues i TVSH-së, tatimpagues i tatimit mbi fitimin ose tatimpagues i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël;

b) brenda 24 orëve përpara lëshimit të faturës së parë, nuk dorëzon në administratën tatimore të dhënat për vendndodhjen e biznesit që përdor për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike;

c) nuk i dorëzon të dhënat për çdo operator, person fizik i autorizuar për të lëshuar faturat, brenda 24 orëve përpara fillimit të lëshimit të faturës nga secili operator;

ç) nuk dorëzon informacionin për mirëmbajtësin e software-it brenda 24 orëve nga lidhja e kontratës për këtë shërbim;

d) nuk dorëzon të dhënat në administratën tatimore për ndryshimin e të dhënave, sipas shkronjave “b”, “c” dhe “ç”, të kësaj pike, brenda afateve kohore të përcaktuara.”.

Neni 25

Neni 123 ndryshohet në titull dhe në përmbajtje si më poshtë:

“Neni 123

Shkeljet për moslëshimin e faturave dhe të faturave shoqëruese

1. Personi, i cili është subjekt i lëshimit të faturës ose i faturës shoqëruese, në përputhje me legjislacionin në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit dhe për TVSH-në, kryen shkelje nëse:

a) nuk lëshon faturë për çdo furnizim të mallrave ose të shërbimeve në Republikën e Shqipërisë;

b) nuk lëshon faturë për çdo pagesë të bërë përpara furnizimit të mallit ose përpara përfundimit të shërbimit (për parapagimin);

c) nuk lëshon faturë për çdo pranim të mallrave ose të ofrimit të shërbimit, nëse është subjekt i “vetëfaturimit”;

ç) nuk lëshon faturë në kohën e furnizimit të mallrave ose shërbimeve ose brenda afateve kohore të parashikuara që përbëjnë përjashtim të këtij rregulli;

d) lëshon faturë që nuk përmban të gjitha elementet e përcaktuara të faturës;

dh) faturën që lëshon për pagesat me para në dorë dhe, në raste të veçanta, faturën për pagesat pa para në dorë, nuk i shtyp në letër e nuk zbaton procedurën e fiskalizimit, si dhe nuk i dorëzon faturën blerësit në kohën e furnizimit;

e) shuma e parave në dorë të arkëtuara mbi maksimumin e arkës ose nëse shuma totale, në rastet e përcaktuara, nuk depozitohet në një llogari të hapur në bankë, jo më vonë se fundi i ditës së ardhshme të punës;

ë) nuk lëshon faturë shoqëruese për çdo lëvizje të mallrave nga një vend në tjetrin pa tjetërsim të pronësisë ndaj mallrave.

Tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, të cilët nuk janë të regjistruar për TVSH-në, dhe tatimpagues të tjerë dënohen me gjobë prej 25 000 lekësh.

Tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël dhe për TVSH-në, dënohen me gjobë prej 50 000 lekësh, por jo më pak se vlera e TVSH-së së munguar.

Tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit mbi fitimin dhe për TVSH-në



dënohen me gjobë prej 75 000 lekësh, por jo më pak se vlera e TVSH-së së munguar.

2. Për tatimpaguesit, të cilët kryejnë shkeljet, sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij neni, përveç masës së gjobës, siç përcaktohet në pikën 1, për tatimpaguesit e regjistruar për TVSH-në bëhet vlerësim tatimor për tre muajt e fundit, duke përdorur metodat alternative, të parashikuara në nenet 71 e 72 të këtij ligji.

3. Për tatimpaguesin, i cili, për herë të dytë brenda vitit kalendarik, kryen një shkelje, sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij neni, merren edhe masat e mëposhtme:

a) gjobë prej 50 000 lekësh për tatimpaguesit e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël pa TVSH-në; 100 000 lekë, për tatimpaguesit e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël me TVSH-në; 150 000 lekë, për tatimpaguesit e tjerë të regjistruar për tatim fitimi dhe TVSH-në;

b) për tatimpaguesit e regjistruar për TVSH-në bëhet vlerësim tatimor për periudhat e fundit të pavlerësuara, por jo më tepër se tre muaj, duke përdorur metodat alternative, të parashikuara në nenet 71 e 72 të këtij ligji;

c) merret masa e bllokimit të veprimtarisë në vendin ku është konstatuar shkelja për 30 ditë kalendarike.

Masa e bllokimit, sipas shkronjës “c”, të kësaj pike, hiqet, nëse tatimpaguesi paguan penalitetet e vendosura.

4. Tatimpaguesi, i cili, për herë të tretë e në vijim brenda vitit kalendarik, kryen shkeljet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij neni, përveç dënimit, sipas pikës 3, të këtij neni, procedohet për ndjekje penale, sipas pikës 2, të nenit 116, të këtij ligji. Gjithashtu, publikohen emri i tatimpaguesit, NIPT-i dhe emri i përfaqësuesit të biznesit në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

5. Për tatimpaguesin, ndaj të cilit, pas rikontrollit tatimor të kryer brenda 15 ditëve nga konstatimi i parë i shkeljeve, sipas shkronjës “e”, të pikës 1, të këtij neni, përsëri konstatohet shkelje e njëjtë, zbatohen dënimet e përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 3, të këtij neni.

6. Tatimpaguesi, i cili lëshon një dëftesë tatimore/biletë me vlerë të parashtypur, që nuk përmban elementet e përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore, për dëftesën tatimore/biletën

me vlerë të parashtypur dënohet me gjobë në masën 25 000 lekë.

7. Tatimpaguesi, i cili lëshon dëftesë tatimore, ku ka shënuar një vlerë të ndryshme nga vlera e furnizimit ose e çmimit të afishuar, dënohet me gjobë në masën 25 000 lekë.

8. Moslëshimi i biletave të shërbimit me vlerë të parashtypur, të prodhuara nga institucionet e autorizuar, të përdorura në sektorë të ndryshëm, dënohet me gjobë në masën 5 000 lekë për çdo biletë.”

Neni 26

Neni 124 ndryshohet në titull dhe në përmbajtje si më poshtë:

“Neni 124

Shkeljet në procedurën e fiskalizimit të faturave dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit

1. Tatimpaguesi, i cili është subjekt i lëshimit të faturës ose i faturës shoqëruese, në përputhje me legjislacionin në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit, dënohet me gjobë si më poshtë:

a) tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, por që nuk janë të regjistruar për TVSH-në, dhe tatimpagues të tjerë dënohen me gjobë prej 25 000 lekësh;

b) tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël dhe për TVSH-në dënohen me gjobë prej 50 000 lekësh;

c) tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit mbi fitimin, në përputhje me ligjin për tatimin mbi të ardhurat dhe për TVSH-në, dënohen me gjobë prej 75 000 lekësh.

2. Gjobat, sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij neni, aplikohen nëse:

a) nuk instalojnë pajisjen elektronike të faturimit ose nuk pajisen me pajisje elektronike të faturimit të lëvizshëm dhe me printer fiskal, i cili përmban një software për nënshkrimin elektronik të faturës dhe nuk sigurojnë një lidhje interneti për shkëmbimin elektronik të të dhënave me administratën tatimore, në rast të pagesave me para në dorë;



b) nuk instalojnë pajisjen elektronike ose nuk pajisen me pajisje elektronike të lëvizshme dhe një printer, i cili përmban një software për nënshkrimin elektronik të faturës shoqëruese dhe nuk sigurojnë një lidhje interneti për shkëmbimin elektronik të të dhënave me administratën tatimore;

c) nuk pajisen nga AKSHI me certifikatën digjitale të përcaktuar për nënshkrimin elektronik të faturës ose të faturës shoqëruese dhe për identifikimin e tatimpaguesit që lëshon fatura;

ç) nuk lëshojnë faturat nëpërmjet pajisjeve elektronike të faturimit të përcaktuar në shkronjën “a”, të kësaj pike, ose nëpërmjet përdorimit të një software-i të përcaktuar për lëshimin e faturave pa para në dorë;

d) nuk zbatojnë procedurën e fiskalizimit për shitje nëpërmjet pajisjeve të vetëshërbimit;

dh) nuk përdorin software që mundësojnë shmangien nga zbatimi i fiskalizimit të lëshimit të faturave ose zbatimit të fiskalizimit të shitjes nëpërmjet pajisjeve të vetëshërbimit;

e) në rast të ndërprerjes së internetit, nuk krijojnë lidhje elektronike brenda 48 orëve nga data kur lidhja është ndërprerë dhe nuk i dorëzojnë të gjitha faturat e lëshuara pa të dhënat e numrit identifikues të veçantë të faturës (NIVF-së) tek administrata tatimore, ose në atë afat nuk njoftojnë administratën tatimore për pamundësinë e krijimit të një lidhjeje elektronike (internet);

ë) në rast të ndërprerjes së plotë të punës së pajisjes fiskale, nuk lëshojnë dëftesat e vërtetuara nga administrata tatimore dhe, në afatin e përcaktuar, nuk rivendosin punën e pajisjeve fiskale për lëshimin e faturave ose nuk pajisen brenda afatit të caktuar me pajisje të re, nuk dorëzojnë të gjitha faturat e lëshuara në administratën tatimore, gjatë kohës së ndërprerjes së punës së pajisjes fiskale;

f) ushtrojnë veprimtari ekonomike në vendndodhjen e biznesit, ku nuk është e mundur të vendoset një lidhje elektronike (internet) dhe për këtë ka një vërtetim të AKEP-it, të cilin nuk e dorëzojnë në administratën tatimore dhe nuk dorëzojnë të dhënat për faturat e lëshuara brenda afatit të përcaktuar e në mënyrën e përcaktuar;

g) nuk afishojnë një njoftim në secilën pajisje elektronike të faturimit ose në një vend tjetër të dukshëm në vendndodhjen e biznesit, që tregon detyrimin për të lëshuar faturën, si dhe detyrimin e blerësit për të marrë dhe ruajtur faturën.”.

Neni 27

Pas nenit 124 shtohen nenet 124/1 dhe 124/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 124/1

Mosregjistrimi i prodhuesit dhe i mirëmbajtësit të software-it për lëshimin e faturave

1. Prodhuesi dhe/ose mirëmbajtësi i software-it, i cili nuk është regjistruar në regjistrin e prodhuesve ose të mirëmbajtësit të software-it, përpara fillimit të ofrimit ose të mirëmbajtjes së software-it për lëshimin e faturave ose të faturave shoqëruese, në administratën tatimore, në përputhje me ligjin që rregullon faturën e sistemin e monitorimit të qarkullimit, dënohet me gjobë 1 000 000 lekë për këtë shkelje.

2. Prodhuesi dhe/ose mirëmbajtësi i software-it, programi i të cilit përdoret nga subjekti që lëshon fatura, nuk mundëson procedurën e fiskalizimit dhe nëse software përmban mundësi, të cilat shmangin procedurën e fiskalizimit të faturës së lëshuar, në përputhje me ligjin që rregullon faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit, dënohet me gjobë 1 000 000 lekë për këtë shkelje.

Neni 124/2

Shkeljet në procedurën e lëshimit, dërgimit dhe pranimit të e-Faturës

1. Personi, i cili është subjekt i lëshimit të e-Faturës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit, dënohet me gjobë si më poshtë:

a) tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, por që nuk janë të regjistruar për TVSH-në, dhe tatimpagues të tjerë dënohen me gjobë prej 50 000 lekësh;

b) tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël dhe për TVSH-në dënohen me gjobë prej 100 000 lekësh, por jo më pak se vlera e TVSH-së së munguar;

c) tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit mbi fitimin, në përputhje me ligjin për tatimin mbi të ardhurat dhe për TVSH-



në, dënohen me gjobë prej 150 000 lekësh, por jo më pak se vlera e TVSH-së së munguar.

2. Gjobat, sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij neni, aplikohen nëse:

a) nuk lëshojnë apo dërgojnë e-Faturën dhe dokumentet shoqëruese, në përputhje me ligjin që rregullon faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit;

b) lëshojnë dhe dërgojnë e-Faturat dhe dokumentet shoqëruese që nuk janë në përputhje me rregullat e përdorimit të e-Faturës;

c) nuk janë regjistruar në regjistrin qendror të shkëmbimit të e-Faturave.

3. Personat, të cilët janë të detyruar të pranojnë e-Faturën, në përputhje me ligjin që rregullon faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit, dënohen me gjobë si më poshtë:

a) tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, por që nuk janë të regjistruar për TVSH-në, dhe tatimpagues të tjerë dënohen me gjobë prej 50 000 lekësh;

b) tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël dhe për TVSH-në dënohen me gjobë prej 100 000 lekësh;

c) tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit mbi fitimin dhe për TVSH-në dënohen me gjobë prej 150 000 lekësh, por jo më pak se vlera e TVSH-së së munguar.

4. Gjobat, sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 3, të këtij neni, aplikohen nëse:

a) pranojnë dhe përpunojnë e-Fatura dhe dokumentet shoqëruese që nuk janë në përputhje me rregullat e përdorimit të e-Faturës;

b) nuk pranojnë ose nuk përpunojnë e-Faturat dhe dokumentet shoqëruese, në përputhje me ligjin që rregullon faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit;

c) kryejnë pagesat e e-Faturës, në kundërshtim me dispozitat e ligjit që rregullon faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.

5. Personi, i cili është ndërmjetës i teknologjisë së informacionit që ofron shërbime për lëshim/dërgim të e-Faturës, të cilat nuk janë në përputhje me ligjin që rregullon faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit ose ofron shërbime për lëshim/dërgim të e-Faturës dhe të dokumenteve tjera shoqëruese, të cilat nuk janë në përputhje me rregullat e përdorimit të e-Faturës,

sipas legjislacionit në fuqi, dënohet me gjobë 50 000 lekë për çdo faturë.”.

Neni 28

Neni 125 ndryshohet në titull dhe në përmbajtje si më poshtë:

“Neni 125

Mosmarrja e faturës

Blerësi ose çdo pranues i faturës së lëshuar për pagesë me para në dorë, i cili nuk e merr faturën e lëshuar dhe me kërkesë të personit të autorizuar të administratës tatimore, nuk i tregon faturën e marrë pas largimit nga vendndodhja e biznesit të shitësit, dënohet me:

a) 50 000 lekë, nëse është tatimpagues i regjistruar për TVSH-në dhe/ose tatimin mbi fitimin;

b) 25 000 lekë, nëse është tatimpagues i regjistruar për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin;

c) 1 000 lekë, nëse është individ, konsumator final.”.

Neni 29

Në nenin 128/1 bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën “a”, fjalët “sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për TVSH-në” zëvendësohen me fjalët “në përputhje me legjislacionin në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.

2. Shkronjat “c” dhe “ç” shfuqizohen.

Neni 30

Në nenin 129, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) 100 000 lekë për çdo rast, nëse banka apo institucioni financiar që ofron shërbime të pagesave pa para në dorë të e-Faturave të lëshuara nga subjekti, i cili ka zbatuar procedurën e fiskalizimit, nuk e regjistron pagesën e kryer, si dhe për këtë pagesë nuk e njofton administratën tatimore nëpërmjet sistemit elektronik, menjëherë pas pagesës, në përputhje me ligjin që rregullon faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.”.



Neni 31
Shfuqizime

Nga data e fillimit të zbatimit të këtij ligji, shfuqizohen udhëzimi nr. 16, datë 3.5.2010, i Ministrit të Financave, “Për administrimin dhe dokumentimin e procedurave të pajisjeve fiskale”, vendimi nr. 781, datë 14.11.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për karakteristikat teknike e funksionale të pajisjeve fiskale, sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike, të deklarimeve financiare, sistemit të komunikimit, për procedurën e dokumentacionin për miratimin e tyre dhe për kriteret për pajisjen, me autorizim, të shoqërive të autorizuar për ofrimin e pajisjeve fiskale”, i ndryshuar, dhe dispozitat e tjera të ligjeve zbatuese të nxjerra në zbatim të këtij ligji, të cilat janë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 32
Hyrja në fuqi

1. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren zyrtare.

2. Përfshihet përcaktimet e pikës 1, të këtij neni, nenet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 12, 13, 14, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29 dhe 30 i fillojnë efektet respektivisht në të njëjtën datë me afatet specifike të përcaktuara në legjislacionin për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.

Miratur në datën 18.12.2019

Shpallur me dekretin nr.11399, datë 30.12.2019, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

DEKRET
Nr.11399, datë 30.12.2019

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 83/2019 “Për disa ndryshime dhe shtetsa në ligjin nr. 9920, datë

19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 84/2019

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 8438, DATË 28.12.1998,
“PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 8/1, pas pikës 11 shtohet pika 11.1 me këtë përmbajtje:

“11.1 Kalimi i së drejtës së pronësisë për banesën dhe/ose truallin, brenda lidhjes gjinore në familje, bashkëshort, bashkëshorte, fëmijë, vetëm një herë ndaj një përfutuesi, nëpërmjet dhurimit dhe/ose heqjes dorë nga pasuria.”.

Neni 2

Në nenin 13, pika 4, pas fjalisë së parë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Ky përfutur nuk zbatohet për individët, të cilët janë të punësuar në më shumë se një punëdhënë. Këta individë deklarojnë në deklaratën e tyre vjetore të të ardhurave, në një shumë të vetme, të gjitha të ardhurat e siguruar nga punësimi, llogarisin shumën totale të detyrimit tatimor mbi pagat, zbresin, kur është rasti, tatimin e mbajtur nga punëdhënësi dhe përcaktojnë shumën



e detyrimit tatimor që duhet të paguajnë për buxhetin e shtetit.”.

Neni 3

Në nenin 20, paragrafi i dytë, fjalët “fatura tatimore me TVSH, fatura e thjeshtë tatimore.” zëvendësohen me fjalët “fatura, e cila është lëshuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.

Neni 4

Në nenin 21, pika 1, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në shkronjën “h” shtohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje:

“Për tatimpaguesit eksportues, përjashtuar prodhuesit me material porositi, të cilët në 3 vitet e fundit kanë realizuar mbi 70 për qind të të ardhurave nga eksporti, shpenzimet e dokumentuara, të kryera për pjesëmarrje, prezantim në panaire apo ekspozita jashtë vendit, njihen si shpenzime të zbritshme deri në masën 3 për qind të qarkullimit vjetor.

2. Në shkronjën “j”, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Nuk njihen si shpenzime të zbritshme, për qëllime tatimore, shumat e sponsorizuara, që tejkalojnë kufijtë e përcaktuar në ligjin nr. 7892, datë 21.12.1994, “Për sponsorizimet”, të ndryshuar.

Për personat juridikë, të cilët realizojnë fitim vjetor të tatueshëm mbi 100 milionë lekë, shumat e sponsorizuara, brenda kufijve të parashikuar në ligjin nr. 7892, datë 21.12.1994, “Për sponsorizimet”, të ndryshuar, për veprimtaritë e ekipeve sportive, pjesë të federatave sportive të njohura nga legjislacioni në fuqi i fushës, për efekt të përlogaritjes së tatimit mbi fitimin e periudhës tatimore, janë të zbritshme sa trefishi i vlerës së shumës së sponsorizuar. Nuk lejohet mbartja e tyre në periudhat tatimore të ardhshme. Parashikimet e këtij paragrafi aplikohen pas lëshimit të “Autorizimit të sponsorizimit” nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, sipas procedurave të parashikuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.”.

Neni 5

Në nenin 27 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Përjashtimisht përcaktimeve të pikës 1, të këtij neni, për tatimpaguesit, të cilët investojnë në projekte biznesi me vlerë mbi 1 miliard lekë, në rast se fitimi i tatueshëm në një periudhë tatimore rezulton negativ, humbjet e rezultuara mund të mbulohen me fitimet në pesë periudhat e ardhshme tatimore, sipas parimit “humbja e parë më përpara se ajo e fundit”. Ministri përgjegjës për financat përcakton me udhëzim kriteret dhe procedurat për zbatimin e kësaj pike.”.

2. Në pikën 2, fjalët “paragrafi i mësipërm” zëvendësohen me fjalët “pika 1 dhe pika 1/1 e këtij neni”.

Neni 6

Në nenin 27/1, pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Parashikimet e këtij neni zbatohen në çdo rast, përveç kur ndryshimi i pronësisë (kapitalit aksionar, kuotave ose e të drejtave të votimit të një personi juridik) i nënshtrohet dispozitave të marrëveshjeve të ratifikuara për shmangien e tatimit të dyfishtë në fuqi.

Neni 7

Në nenin 28, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Për personat juridikë, të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomike në industrinë automotivë, shkalla e tatimit mbi fitimin është 5 për qind. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim aktivitetet, kriteret dhe procedurat për zbatimin e kësaj pike.”.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare me përjashtim të nenit 3, të këtij ligji, i cili i fillon efektet, respektivisht, në të njëjtën kohë me afatet e përcaktuara në ligjin për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.

Miraturar në datën 18.12.2019

Shpallur me dekretin nr. 11400, datë 30.12.2019, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

**DEKRET****Nr.11400, datë 30.12.2019****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 84/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

**LIGJ
Nr. 85/2019**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 92/2014 “PËR TATIMIN
MBI VLERËN E SHTUAR NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 49, pika 7 ndryshohet si më poshtë:
“7. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e mjeteve të transportit publik të licencuar të udhëtarëve me autobus me nëntë plus një vende ose më shumë, vetëm me motor elektrik, është 6 për qind.”.

Neni 2

Në nenin 51, pas shkronjës “o” shtohet shkronja “p” me këtë përmbajtje:

“p) furnizimi i automjeteve vetëm me motor elektrik, të reja, me zero km e që nuk janë regjistruar më parë për qarkullim në asnjë shtet tjetër, përveç atyre të përcaktuara në pikën 7, të nenit 49, të ligjit.”.

Neni 3

Në nenin 53, pas shkronjës “k” shtohen shkronjat “l” dhe “ll” me këtë përmbajtje.

“l) furnizimi i procesit të ndërtimit nga ndërtuesit subjekte të rindërtimit, brenda programit të rindërtimit, të autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, për rastet e shpalljes së “gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, përgjatë periudhës së rindërtimit, sipas përcaktimeve të legjislacionit për rindërtimin. Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen procedurat për lëshimin e autorizimit, si dhe mënyra e zbatimit të kësaj shkronje;

ll) furnizimi i shërbimeve dhe mallrave i kryer direkt për ndërtuesit subjekte të rindërtimit, brenda programit të rindërtimit, që përdoren prej tyre për procesin e ndërtimit për rastet e shpalljes së “gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, përgjatë periudhës së rindërtimit, sipas përcaktimeve të legjislacionit për rindërtimin, të autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Përjashtimi nga TVSH-ja duhet të reflektohet në çmimin e shitjes së këtyre mallrave dhe shërbimeve, furnizime të cilat duhet të jenë dukshëm me çmime me të ulëta se furnizimet e ngjashme për raste të tjera jo për qëllime të fatkeqësisë natyrore. Asnjë përjashtim nuk akordohet për furnizuesit e mallrave ose shërbimeve që nuk furnizojnë direkt ndërtuesit e autorizuar. Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen procedurat për lëshimin e autorizimit, si dhe mënyra e zbatimit të kësaj shkronje.”.

Neni 4

Në nenin 56, pika 28, përcaktimi “përjashtuar materialet dhe pajisjet e importuara për këtë qëllim nga organe shtetërore për rastet e shpalljes së “gjendjes së fatkeqësisë natyrore” brenda afatit të përcaktuar” zëvendësohet me përcaktimin



“përfshatuar materialet, pajisjet, ndërtesat e parafabrikuara, të importuara për këtë qëllim nga organe shtetërore, organizatat bamirëse dhe filantropike për rastet e shpalljes së “gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, brenda programit të rindërtimit. Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohet mënyra e zbatimit të kësaj dispozite”.

Neni 5

Në nenin 58, pika 2, paragrafi i fundit, fjalët “ e shoqëruar me kuponin tatimor, që vërteton pagesën e kryer,” hiqen.

Neni 6

Në nenin 95, shkronja “b”, fjalët “në një format elektronik” zëvendësohen me fjalët “në formatin elektronik, sipas legjislacionit në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.

Neni 7

Në nenin 96, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Faturimi kryhet sipas rregullave të përcaktuara në këtë seksion dhe në legjislacionin në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit për të gjitha furnizimet e mallrave dhe të shërbimeve, vendi i të cilave, sipas dispozitave të kreut IV, të këtij ligji, është në Republikën e Shqipërisë.”.

Neni 8

Në nenin 97, pika 2, fjalja e fundit ndryshohet si më poshtë:

“Dokumentimi i këtyre transaksioneve bëhet siç përcaktohet nga autoritetet që mbikëqyrin këto lloje veprimtarish, në marrëveshje me autoritetin tatimor dhe duhet të përmbajë, të paktën, informacionin e mëposhtëm:

- a) datën e lëshimit;
- b) identifikimin e personit të tatueshëm, që furnizon mallrat dhe shërbimet;
- c) identifikimin e mallrave dhe të shërbimeve të furnizuara.”.

Neni 9

Neni 98 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 98

Të tjera përcaktime mbi faturimin

Përveç sa përcaktohet në nenin 97, personi i tatueshëm duhet të sigurohet për lëshimin e faturës për çdo furnizim tjetër të mallrave ose shërbimeve, pavarësisht vlerës së furnizimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.”.

Neni 10

Në nenin 99, pika 2, fjalët “jo më vonë se data 14” zëvendësohen me fjalët “jo më vonë se data 10”.

Neni 11

Në nenin 101 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) datën, vendin dhe kohën e lëshimit të faturës.”.

2. Shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) numrin e faturës, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për faturën dhe sistemin për monitorimin e qarkullimit.”.

3. Pas shkronjës “nj” shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Fatura, përveç informacionit të përcaktuar në shkronjat “a” deri në “nj”, të këtij neni, duhet të përmbajë edhe elemente të tjera, sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.

Dokumentet e përcaktuara në nënndarjet “i” dhe “ii”, të shkronjës “c”, të nenit 95, të këtij ligji, përveç informacionit të përcaktuar në nenin 101, duhet të përmbajnë referencat e faturës fillestare përkatëse dhe detajet specifike që ato korrigjojnë.”.

Neni 12

Neni 102 shfuqizohet.

Neni 13

Neni 104 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 104

Mënyra e lëshimit dhe e dërgimit të faturave

Faturat tatimore dhe dokumentet e tjera, të lëshuara sipas këtij ligji, mund të vihen në dispozicion në letër ose në formë elektronike, siç



përcaktohet në legjislacionin në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.”.

Neni 14

Neni 105 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 105

Kriteret e dërgimit dhe të lëshimit të faturave

Vërtetësia e origjinës, integriteti i përmbajtjes dhe lexueshmëria e një fature, qoftë kjo në letër apo në formë elektronike, duhet të garantohen në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit, duke filluar nga momenti i lëshimit të saj deri në përfundimin e periudhës së ruajtjes së faturës.”.

Neni 15

Në nenin 106 bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Në pikën 3, fjalët “në të cilin parashikohet edhe dërgimi në rrugë elektronike” hiqen.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Deklarata e TVSH-së, e bërë sipas pikës 1, të këtij neni, do të krijohet automatikisht nga autoriteti tatimor, bazuar në informacionin në librin e blerjes dhe në librin e shitjes. Personi i tatueshëm duhet të kontrollojë të dhënat në atë deklaratë, t'i ndryshojë ose t'i plotësojë ato, nëse është e nevojshme, në përputhje me librin e blerjes dhe të shitjes, të konfirmojë saktësinë dhe plotësinë e tyre, duke përdorur shërbimin elektronik të autoritetit tatimor, dhe ta dorëzojë atë brenda afatit të përcaktuar në nenin 107 të këtij ligji.”.

Neni 16

Në nenin 109, pika 2, në fund të fjalisë së parë shtohen fjalët “në përputhje me legjislacionin në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.”.

Neni 17

Në nenin 110, pika 1, paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Këta persona, për faturimin i nënshtrohen dispozitave të legjislacionit në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.”.

Neni 18

Në nenin 157, pika 2 shfuqizohet.

Neni 19

Dispozitë kalimtare

Në periudhën kalimtare, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në fillimin e efekteve të dispozitave lidhur me përdorimin e detyrueshëm të faturave elektronike, siç përcaktohet në legjislacionin për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit, personi i tatueshëm, për transaksione pa para në dorë me personin tjetër të tatueshëm dhe personin juridik të patatueshëm duhet:

a) të lëshojë fatura tatimore me përmbajtjen dhe në formatin, në përputhje me nenet 101 dhe 104, të ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë deri në datën e fillimit të efekteve të neneve 11 dhe 13 të këtij ligji;

b) të dorëzojë deklaratën e TVSH-së, në përputhje me nenin 106, të ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, deri në datën e fillimit të efekteve të nenit 15 të këtij ligji;

c) të dorëzojë librin e blerjeve dhe librin e shitjeve, në përputhje me nenin 109, të ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, deri në datën e fillimit të efekteve të nenit 16, të këtij ligji.

Neni 20

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, me përjashtim të neneve 5, 6, 7, 8, 9, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18, të këtij ligji, të cilat i fillojnë efektet respektivisht në të njëjtën kohë me afatet e përcaktuara në legjislacionin për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.

Miratuar në datën 18.12.2019

Shpallur me dekretin nr. 11401, datë 30.12.2019, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

**DEKRET****Nr.11401, datë 30.12.2019****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 85/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

LIGJ**Nr. 86/2019**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 9975, DATË 28.7.2008,
“PËR TAKSAT KOMBËTARE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 2, pika 5, shkronja “b”, shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Vlera e mjetit plotësohet në sistemin informatik të DPTSHRR-së, kur mjeti regjistrohet për herë të parë ose/dhe sa herë ndryshon pronësia e tij. Vlera e mjetit, për efekt të klasifikimit “Automjet luksoz”, reduktohet çdo vit me 10 për qind të vlerës së mbetur.

Faqe | 15000

Për automjetet të cilat shiten, vlera e shitjes së tyre, për efekt klasifikimi si “Automjet luksoz”, nuk mund të jetë më e vogël se vlera e mjetit të amortizuar, sipas paragrafit të mësipërm.”.

Neni 2

Në nenin 4, pika 3, bëhen këto ndryshime:

Popullsia është një tregues i lidhur ngushtë me shpenzimet dhe nevojat për shërbime. Për rrjedhojë popullsia do të vazhdojë të mbetet kriteri kryesor për ndarjen e transfertës së pakushtëzuar ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore.

Koeficienti i përshtatjes së të dhënave të popullsisë	30%
Banorë rezidentë efektivë = $[CENSUS + (Regjistri\ i\ gjendjes\ civile - Census) * 30\%]$	3,311,231

Të dhënat për popullsinë që përdoren në aplikimin e formulës bazohen kryesisht në të dhënat e Censurit të vitit 2011. Këtyre të dhënave u shtohet 30% e diferencës midis të dhënave të Censurit dhe Gjendjes Civile (të vitit 2019) për secilën njësi të vetëqeverisjes vendore. Kështu, nëse një njësi e vetëqeverisjes vendore sipas Censurit të vitit 2011 ka 30,000 banorë, ndërsa sipas Regjistrit të Gjendjes Civile rezultojnë të ketë 45,000 banorë, atëherë, numri i popullsisë së përdorur për alokimin e fondeve për këtë bashki do të jetë $30,000 + [(45,000 - 30,000) * 30\%] = 34,500$ banorë të konsideruar rezidentë efektivë në atë njësi të vetëqeverisjes vendore. Në këtë mënyrë, popullsia rezidente rezultojnë rreth 3.3 milion banorë, nga 2.8 milion që raportohet nga Censusi dhe 4.5 milionë që raportohet nga Regjistri i Gjendjes Civile. Vlerësohet se një kompromis midis dy burimeve të të dhënave është i nevojshëm dhe rregullimi me 30% të diferencës midis të dhënave të Gjendjes Civile dhe Censurit amortizon ndryshimet në transfertë që do të pësonte një njësi nga kalimi nga një formulë në tjetrën.

5. Shpërndarja e transfertës së pakushtëzuar për Bashkitë

Për vitin 2020, transferta e pakushtëzuar e cila ndahet sipas formulës për 61 bashkitë është 19,952,280,548 lekë dhe do të ndahet sipas kriterëve të mëposhtme. Kriteret e shpërndarjes së fondeve në formulë kërkojnë të identifikojnë nevojat reale të shpenzimeve të njësive të ndryshme të vetëqeverisjes vendore mbi bazën e popullsisë, dendësisë së popullsisë dhe numrit të fëmijëve në kopshte dhe nxënësve në shkollat publike 9-vjeçare dhe të mesme në territorin e një bashkie.

Në formulë, 63.8% e transfertës për bashkitë alokohet mbi bazën e popullsisë relative. Në vijim të rregullimit të numrit të popullsisë së Censurit duke i shtuar atij edhe 30% të diferencës midis të dhënave të Gjendjes Civile dhe të dhënave të Censurit, çdo njësi e vetëqeverisjes vendore merr një transfertë të pakushtëzuar prej 3,845 lekë, për çdo banor rezident në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

Përbërja e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë	19,952,280,548
Komponenti I: Ndarja sipas popullsisë (në përqindje)	63.8%
Transferta e pakushtëzuar që shpërndahet sipas numrit të banorëve rezidentë efektivë	12,730,434,038
Transferta e pakushtëzuar për frymë	3,845

Dendësia e popullsisë është një kriter tjetër që përdoret për shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë. Dendësia e popullsisë më e ulët është në bashkitë që përbëhen kryesisht ose plotësisht nga zona rurale dhe/ose malore. Ka një korrelacion të fortë mes njësive të vetëqeverisjes vendore me dendësi të ulët dhe atyre sipërfaqja e të cilave është mbi 50% malore. Kështu koeficienti, “dendësi e ulët e popullsisë”, çon fonde shtesë në të njëjtin drejtim siç bënte formula e mëparshme e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar, nëpërmjet përdorimit të koeficientëve shtesë për njësitë vendore malore dhe në vështirësi financiare.



Në formulë 12 % e totalit të fondit për bashkitë, ndahet mbi bazën e dendësisë së popullsisë, e cila ndahet në kufij sipas tabelës së mëposhtme.

Komponenti II: Ndarja sipas dendësisë së popullsisë (në përqindje)							12%
Madhësia e Transfertës së Pakushtëzuar që shpërndahet sipas dendësisë së popullsisë							2,386,956,382
Mesatarja Kombëtare e Dendësisë së Popullsisë							117 banorë/km ²
Transferta për frymë nga densiteti i popullsisë							2,052 lek/banorë
Kufijtë e dendësisë së popullsisë si % ndaj mesatares kombëtare	Koeficientët e rregullimit	Numri i NJVV-ve përfituese	Dëndësia e popullsisë korresponduese	Popullsia në çdo grup	Popullsia e korrigjuar me koeficientin e rregullimit për çdo grup	Shuma e fondeve shtesë për çdo grup	
Kufiri 1	22%	2.32	10	25.1	115,851	268,775	551,524,693
Kufiri 2	43%	1.662	13	50.2	280,470	466,141	956,519,117
Kufiri 3	75%	0.90	10	87.5	348,551	313,696	643,701,704
Kufiri 4	110%	0.40	6	128.4	286,564	114,626	235,210,868
Totali			39		1,031,436	1,163,238	2,386,956,382

Një njësi e vetëqeverisjes vendore me një sipërfaqe të madhe dhe një popullsi më të ulët, nënkupton, për të gjitha kushtet e tjera të barabarta, të ketë kosto më të larta të ofrimit të shërbimeve, rrugë më të gjata dhe shpenzime të tjera infrastrukturore që kushtojnë. Për të kompensuar njësitë me dendësi më të ulët për kostot më të larta të shërbimit janë krijuar 4 grupime të njësisë të vetëqeverisjes vendore sipas ngjashmërisë më të madhe të dendësisë. Njësitë me dendësi më të ulët popullsie përfitojnë nga koeficientë shtesë më të lartë se ato njësi të cilat kanë një afërsi më të madhe të dendësisë me mesataren kombëtare. Nga ky kriter përfitojnë 39 njësi të vetëqeverisjes vendore, në të cilat banojnë 1,031,436 banorë rezidentë efektivë. Nëse një njësi e vetëqeverisjes vendore ka një dendësi mesatare nën 22% të mesatares kombëtare, ose mesatarisht 26 banorë për km², atëherë popullsia e saj relative do të shumëzohet me 2.32. Nëse ka një dendësi midis 22% dhe 44% të mesatares kombëtare, atëherë popullsia e saj relative do të shumëzohet me një koeficient prej 1.662. Pra duke u afuar mesatares kombëtare, koeficientët vijnë duke u zvogëluar. Në përfundim numri i popullsisë për çdo grup dendësie, shumëzohet me koeficientin përkatës dhe transfertën për frymë prej **2,052 lekë** për banorë (që rezulton nga pjesëtimi i shumës prej **2,386,956,382 lekë** me popullsinë totale që rezulton nga aplikimi i koeficientëve për çdo grup).

Kriteri i tretë mbi të cilin ndahet transfertat e pakushtëzuar për bashkitë është numri i fëmijëve në arsimin parashkollor i kombinuar me numrin e personelit mësimor në arsimin parashkollor, dhe numri i nxënësve në shkollat publike nëntë-vjeçare dhe të mesme. Nga viti 2019, dhe në vazhdim formula e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar përditësohet për të akomoduar përfshirjen dhe ndarjen e fondeve për pagat e personelit mësimor në sistemin arsimor parashkollor. Në këtë kuadër, komponenti i arsimit i formulës së transfertës së pakushtëzuar do të ndajë gjithsej 24.2% e totalit të transfertës për tu ndarë me formulë, ose 4,834,890,127 lekë. Nga kjo shumë, 4,039,238,000 lekë janë të dedikuara për pagat e personelit mësimor në arsimin parashkollor. Fondet ndahen 60% mbi bazën e numrit të fëmijëve të regjistruar në kopshte dhe 40% mbi bazën e numrit të edukatoreve pranë këtyre kopshteve. Në krahasim me vitin 2018, fondet për pagat e personelit mësimor të arsimit parashkollor janë 430 milion lekë ose 10% më të larta.

Ndërkohë, pjesa prej 5% e totalit të transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme për bashkitë, ose 795,652,127 lekë do të ndahet mbi numrin faktik të nxënësve në shkollat publike në çdo bashki, kundrejt totalit kombëtar të nxënësve. Bashkitë do të marrin një fond prej 1,920 lekë për çdo nxënës në territorin e tyre.



Komponenti III: Ndarja sipas numrit të fëmijëve dhe nxënësve (në %)	24.2%
Transferta e pakushtëzuar sipas numrit të fëmijëve dhe nxënësve, në lek	4,834,890,127
Vlera për personelin mësimor në arsimin parashkollor, në lek	4,039,238,000
Sipas numrit të nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme	795,652,127

6. Ekualizimi i transfertës së pakushtëzuar mbi bazën e të ardhurave nga taksat e ndara dhe në raport me transfertën e vitit të mëparshëm

Për të siguruar një ekualizim horizontal efektiv të transfertës së pakushtëzuar ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore në mënyrë që të merren në konsideratë kapacitetet e ndryshme fiskale ndërmjet tyre, në formulë llogaritjet bazohen mbi të ardhurat faktike nga taksat e ndara ndërmjet qendrore dhe asaj vendore, të cilat mbledhen dhe u transferohen plotësisht ose pjesërisht bashkive nga administrata qendrore. Ekualizimi fiskal bazohet në të ardhurat faktike nga tatim i thjeshtuar i fitimit mbi biznesin e vogël, nga taksa vjetore e automjeteve të përdorura dhe taksa e kalimit të pasurisë për pasuritë e paluajtshme të shitura nga personat juridikë të cilat mbledhen nga agjenci qendrore dhe u transferohen njësive të vetëqeverisjes vendore. Në këtë mënyrë njësitë e vetëqeverisjes vendore sigurohen që të ardhurat që ata mbledhin vetë nuk preken nga sistemi i ekualizimit duke evituar kështu çdo lloj disincitivimi në mbledhjen e taksave. Në vitin 2018, pjesa e të ardhurave nga këto taksa që u janë transferuar njësive të vetëqeverisjes vendore është 1,767,862,764 lekë, dhe të ardhurat kombëtare për frymë (TAKPF), ose mesatarja kombëtare për frymë rezulton 534 lekë për banor, sipas konceptit “banor rezident efektiv”.

Komponenti IV: Sistemi i Ekualizimit të të ardhurave						
Të ardhurat nga taksat e ndara që do të përdoren për ekualizimin e të ardhurave (Biznesi i Vogël + Taksa e Automjeteve + Taksa mbi transferimin e pasurisë nga personat juridik)						1,767,862,764
Të ardhurat kombëtare për frymë (TAKPF), Të ardhura për frymë (TAPF)						534
Nëse NJVV-të kanë TAPF nën	80%	të TAKPF, atëherë ato kompensohen me	100%	të diferencës	Madhësia e ekualizimit fiskal (fondet që duhet të shtohen)	343,882,788
duke u marrë NJVV-ve me të ardhura për frymë mbi	120%	të mesatares kombëtare (TAKPF)	50%	të diferencës	Fondet që efektivisht shkurohen	270,642,566
Koeficienti i rishpërndarjes						0.79

Njësitë e vetëqeverisjes vendore që kanë të ardhura për frymë (TAPF) nën 80% të mesatares kombëtare (TAKPF) prej 534 lekë/frymë, do të kompensohen me 100% të diferencës ndërmjet të ardhurave të tyre për frymë dhe mesatares kombëtare. Kjo llogaritje tregon sa fonde do duhej t'u shtoheshin njësive me të ardhura më të ulta për ti sjellë ato në nivelin prej 427 lekë/frymë (ku $534 \times 80\% = 427$ lekë). Për të sjellë të gjitha bashkitë me të ardhura më “të ulta” në nivelin prej 80% të mesatares kombëtare, njësive me të ardhura më të larta se 120% e mesatares kombëtare, (pra me TAPF mbi 640 lekë/frymë) do t'u merret 50% e diferencës midis të ardhurave të tyre për frymë dhe 120% të mesatares kombëtare. P.sh., nëse një njësi e vetëqeverisjes vendore ka të ardhura për frymë prej 1200 lekë/frymë, sipas formulës së mësipërme asaj do ti zbriten 280 lekë/frymë $\{[(1200 - (120\% \times 534)) \times 50\% = 280 \text{ lekë/banor}]\}$. Kjo llogaritje në fund tregon sa janë fondet realisht të disponueshme të cilat mund të transferohen nga njësitë me të ardhura më të larta tek ato më të ultat. Sistemi balancohet automatikisht nëpërmjet një koeficienti të rishpërndarjes i cili përcaktohet nga raporti midis fondeve disponibël për ekualizim dhe fondeve të nevojshme për ekualizim. Për vitin 2020, fondet e nevojshme për ekualizim janë 343,882,788 lekë, ndërkohë që fondet e disponueshme për ekualizim që vijnë nga “taksimi” prej 50% të të ardhurave mbi 534 lekë/frymë i njësive me të ardhura më të larta janë 270,642,566 lekë dhe për rrjedhojë koeficienti i rishpërndarjes është 0.79.



7. Shpërndarja e transfertës së pakushtëzuar për Qarqet

Qarqeve do t'u ndahen 550 milionë lekë, sipas një shume fikse, të barabartë për secilin nga 12 Qarqet, sipas popullsisë rezidente dhe sipas dendësisë së popullsisë në çdo qark kundrejt mesatares kombëtare. Sipas kriterit të parë, 20% e totalit të transfertës së pakushtëzuar të qarqeve (ose 110 milionë lekë) do të shpërndahet si një shumë fikse prej rreth 9.2 milionë lekë për secilin nga 12 Qarqet.

Përbërja e transfertës së pakushtëzuar për qarqet	550,000,000
Komponenti I: Shuma fikse për qarqet (në përqindje)	20%
Transferta e pakushtëzuar për t'u ndarë sipas shumës fikse	110,000,000
Shuma fikse e transfertës së pakushtëzuar për çdo qark	9,166,667

Sipas kriterit të dytë, 50% e transfertës së pakushtëzuar (ose 275 milionë lekë) do të ndahet përpjesëtimisht sipas popullsisë rezidente në çdo qark, kundrejt popullsisë totale. Të dhënat për popullsinë e qarqeve ndjekin të njëjtin rregullim të bërë për popullsinë e bashkive.

Komponenti II: Ndarja sipas banorëve rezidentë efektivë (në përqindje)	50%
Transferta e pakushtëzuar që shpërndahet sipas numrit të banorëve rezidentë efektivë	275,000,000
Transferta e pakushtëzuar për frymë (Banorë rezidentë efektivë)	83

Sipas kriterit të tretë, 30% e transfertës së pakushtëzuar (ose 165 milionë lekë) do të ndahen mbi bazën e dendësisë së popullsisë në çdo qark, kundrejt dendësisë mesatare kombëtare.

Komponenti III: Ndarja sipas dendësisë së popullsisë (në përqindje)							30%
Transferta e pakushtëzuar që shpërndahet sipas dendësisë së popullsisë							165,000,000
Mesatarja kombëtare e dendësisë së popullsisë							117 banorë/km²
Transferta për frymë nga komponenti i dendësisë së popullsisë							208 lek/banorë
Kufijtë e dendësisë së popullsisë si % ndaj mesatares kombëtare		Koeficientët	Numri i Qarqeve që përfitojnë	Dendësia e popullsisë për grup	Popullsia për çdo grup	Shuma e shtuar për secilin grup	% e shpërndarjes për grup
Kufiri 1	90%	0,3	4	105	918,119	56,840,673	34%
Kufiri 2	65%	0,5	3	75.8	668,919	68,965,186	42%
Kufiri 3	35%	1,0	2	40.8	190,458	39,194,141	24%
Totali			9		1,777,496	165,000,000	

Qarqet me dendësi më të ulët të popullsisë, duke prezumuar kosto më të larta për ofrimin e shërbimeve dhe/ose kapacitet fiskal më të ulët, do të përfitojnë fonde shtesë nëpërmjet koeficientëve të përcaktuar më sipër për secilin nga tre grupet. Qarqet janë ndarë në tre grupe të ndryshëm sipas raportit mes dendësisë së tyre të popullsisë dhe mesatares kombëtare. Kufijtë e ndarjes së grupeve ndjekin ngjashmërinë e raportit të dendësisë ndaj mesatares kombëtare. Kështu, nëse një Qark ka një dendësi të popullsisë nën 35% të mesatares kombëtare, që nënkupton mesatarisht më pak se 41 banorë për km², kundrejt mesatares kombëtare prej 117 banorë për km², dhe një popullsi prej 93,225 banorësh rezidentë, atëherë popullsia e atij qarku shumëzohet me koeficientin shtesë përkatës (+1) dhe transfertën për frymë prej 208 lekë për banor, duke rezultuar në një shtesë fondesh prej 19,390,800 lekë (i llogaritur në këtë mënyrë: 93,225*1*208).



ANEKS 2

KRITERET E SHPËRNDARJES SË FONDIT REZERVË

Nivelet e Pushtetit Vendor	Kriteret
A. Për bashkitë	- Kompensim për ndonjë gabim në përlllogaritjen e kriterëve të formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për vitin 2020. - Për funksionet e reja të transferuara në bashkitë që nga viti 2016. - Për nevoja të ndryshme financiare të bashkive.
B. Për qarqet	- Për shpenzime të ndryshme që mund të nevojiten gjatë vitit.

Shuma që akordohet nga fondi rezervë për njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk duhet të kalojë 50 për qind të nivelit të transfertës së pakushtëzuar të akorduar me ligjin e buxhetit të vitit 2020.

Pjesa e papërdorur e fondit rezervë në vitin buxhetor 2020, kalon në transfertën e pakushtëzuar të vitit 2021.

Procedurat për alokimin e këtij fondi përcaktohen në udhëzimin plotësues të zbatimit të buxhetit të vitit 2020.

ANEKSI 3

FONDI PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE DHE PROGRAMI PËR INFRASTRUKTURËN VENDORE DHE RAJONALE

1. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve është një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor.

2. Për vitin 2020, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përbëhet nga granti konkurrues për arsimin.

3. Shpërndarja e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve sipas projekteve kryhet nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve, i cili kryesohet nga Kryeministri dhe ka këtë përbërje:

1. Kryeministrin	Kryetar
2. Zëvendëskryeministrin	Zëvendëskryetar;
3. Ministrin e Financave dhe Ekonomisë	anëtar;
4. Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	anëtar;
5. Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	anëtar;
6. Ministrin e Kulturës	anëtar;
7. Ministrin e Brendshëm	anëtar;
8. Kryetarin e Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar;
9. Kryetarin e Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar;

10. Kryetarin e Shoqatës së

Qarqeve të Shqipërisë anëtar;

Në mungesë të kryetarit të Komitetit, mbledhja drejtohet nga zëvendëskryetari.

4. Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve miraton:

a) Specifikimet, rregullat dhe kriteret për financimin e projekteve dhe ndarjen e grantit të arsimit;

b) Shpërndarjen e fondeve për financim për projekte të reja investimi;

5. Fondi i Zhvillimit të Rajoneve me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces. Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në përputhje me ecurinë e projektit. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë mund të kërkojë rialokime midis projekteve të FZHR-së, sipas procedurave të miratuara për investimet publike.

6. Thirrjet për aplikim në Fondin e Zhvillimit të Rajoneve për vitin buxhetor mund të bëhen që në Nëntor të vitit paraardhës.

7. Fondi i Zhvillimit të Rajoneve nuk trashëgohet në vitin e ardhshëm, buxhetor.

8. Sekretariati teknik për grantin për arsimin ngrihet pranë Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve është një njësi pranë Kryeministrisë.



9. Subjektet aplikuese dhe zbatuese janë njësitë e vetëqeverisjes vendore. Komiteti miraton me vendim autoritetin kontraktor për zbatimin e projektit. Rregulla të hollësishme lidhur me raportimin e autoriteteve kontraktuese miratohen me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

Programi buxhetor për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale në Fondin Shqiptar të Zhvillimit

1. Fondet për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, të parashikuara si program buxhetor në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, janë një mekanizëm financiar që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor. Autoriteti programues, kontraktues dhe zbatues është Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

2. Specifikimet, rregullat, kriteret për financimin e projekteve si dhe shpërndarja e Fondit për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale për financimim e projekteve të reja miratohen nga Këshilli Drejtues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

3. Fondi Shqiptar i Zhvillimit administron nevojat dhe propozimet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, qendrore dhe aktorë të tjerë (përfshirë FSHZH dhe njësitë e zhvillimit rajonal të tij) që konsistojnë në projekte në interes dhe në funksion të zhvillimit lokal e rajonal, përfshirë edhe projekte zhvillimore me natyrë ekonomike, të zbatuara në partneritet midis FSHZH dhe njësive të vetëqeverisjes vendore dhe subjekte të tjera.

4. Nga fondi për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, Fondi Shqiptar i Zhvillimit me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces me burim financimi ish-Fondin e Zhvillimit të Rajoneve-Infrastrukura Vendore dhe Rajonale. Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve të FSHZH-së, në përputhje me ecurinë e projektit. Fondi Shqiptar i Zhvillimit mund të kërkojë rialokime midis projekteve, sipas procedurave të miratuara për investimet publike.

5. Rregulla të hollësishme lidhur me funksionimin e të gjithë procesit të programimit, monitorimit dhe raportimit të ecurisë së zbatimit miratohen me vendim të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar.

Programi buxhetor për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale në Fondin Shqiptar të Zhvillimit

1. Fondet për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, të parashikuara si program buxhetor në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, janë një mekanizëm financiar që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor. Autoriteti programues, kontraktues dhe zbatues është Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

2. Specifikimet, rregullat, kriteret për financimin e projekteve si dhe shpërndarja e Fondit për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale për financimim e projekteve të reja miratohen nga Këshilli Drejtues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

3. Fondi Shqiptar i Zhvillimit administron nevojat dhe propozimet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, qendrore dhe aktorë të tjerë (përfshirë FSHZH dhe njësitë e zhvillimit rajonal të tij) që konsistojnë në projekte në interes dhe në funksion të zhvillimit lokal e rajonal, përfshirë edhe projekte zhvillimore me natyrë ekonomike, të zbatuara në partneritet midis FSHZH dhe njësive të vetëqeverisjes vendore dhe subjekte të tjera.

4. Nga fondi për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, Fondi Shqiptar i Zhvillimit me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces me burim financimi ish-Fondin e Zhvillimit të Rajoneve-Infrastrukura Vendore dhe Rajonale. Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve të FSHZH-së, në përputhje me ecurinë e projektit. Fondi Shqiptar i Zhvillimit mund të kërkojë rialokime midis projekteve, sipas procedurave të miratuara për investimet publike.

5. Rregulla të hollësishme lidhur me funksionimin e të gjithë procesit të programimit, monitorimit dhe raportimit të ecurisë së zbatimit miratohen me vendim të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar.

ANEKS 4

PËR FUNKSIONET E TRANSFERUARA NË NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE

1. Konviktet e arsimit parauniversitar

Në transfertën e vitit 2020, disa bashkive i janë akorduar fondet për konviktet e arsimit parauniversitar. Në këtë transfertë përfshihen fondet për shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator),



për shpenzimet operative dhe për shpenzimet për investime.

Fondet për shpenzimet për personelin (paga dhe sigurime shoqërore) janë llogaritur mbështetur mbi numrin e punonjësve për secilin konvikt sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 502, datë 16.04.2008, “Për administrimin e konvikteve të sistemit arsimor parauniversitar” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1710, datë 29.12.2008, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 16.04.2008, “Për administrimin e konvikteve të sistemit arsimor parauniversitar”.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë para fillimit të vitit buxhetor 2020, duhet të dërgojë në njësitë e vetëqeverisjes vendore gjithë kuadrin ligjor dhe nënligjor lidhur me pagat dhe sigurimet shoqërore për konviktet e arsimit parauniversitar. Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore të personelit të këtyre konvikteve, njësitë e vetëqeverisjes vendore do të mbështeten në kuadrin rregullator që ka përdorur Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

2. Qëndrat e Shërbimeve Sociale

Në transfertën e vitit 2020 të bashkive, Berat, Elbasan, Shkodër, Vau i Dejës, Fier, Kuçovë dhe Kukës i janë akorduar fondet për paga dhe sigurime shoqërore për personelin shërbyes dhe shpenzime operative për qendrat, “Lira”, Berat, “Balash”, Elbasan, “Shpresa” Shkodër, “Opera Della Madonnina Della Grappa”, Shkodër, “Besa” Vau i Dejës, “Horizont”, Fier dhe qendrat ditore të fëmijëve me Aftësi të Kufizuara për bashkitë Kuçovë dhe Kukës.

Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore të personelit të këtyre qendrave bashkitë Berat, Elbasan, Shkodër, Vau i Dejës, Fier, Kuçovë, dhe Kukës do të mbështeten në kuadrin rregullator që përdor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këto qendra.

3. Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MZSH)

Në transfertën e vitit 2020, të bashkive është akorduar fondi për funksionin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi. Në këtë fond përfshihen fondet për shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore të punonjësve si dhe për shpenzime operative.

Ministria e Brendshme duhet t’ju dërgojë bashkive kuadrin ligjor dhe të dhëna të tjera që disponon të cilat janë të lidhura me shërbimin. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

4. Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar

Në transfertën e vitit 2020, njësitë e vetëqeverisjes vendore i janë akorduar fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor si dhe fondet për personelin ndihmës të arsimit parauniversitar. Në fondet e personelit ndihmës të arsimit parauniversitar nuk përfshihet arsimi i mesëm profesional.

Në menaxhimin e funksioneve të arsimit parauniversitar njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të mbështeten në ligjin nr.69, datë 21.06.2012, “Për sistemin e arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr.48, datë 23.07.2018).

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

5. Rrugët rurale

Në transfertën e vitit 2020, njësitë e vetëqeverisjes vendore i është akorduar fondi për rrugët rurale të transferuara nga qarku në bashki. Në këtë fond përfshihen fondet për shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe shpenzime për investime.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në rrugët rurale.



6. Administrimi i pyjeve

Në transfertën e vitit 2020, njësitë të vetëqeverisjes vendore i është akorduar fondi për Shërbimin Pyjor. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore të punonjësve si dhe për shpenzime operative.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, para fillimit të vitit buxhetor 2020, duhet të dërgojë në bashkitë përkatëse kuadrin ligjor dhe nënligjor lidhur me funksionimin e këtij shërbimi.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

7. Ujitja dhe Kullimi

Në transfertën e vitit 2020, njësitë të vetëqeverisjes vendore i është akorduar fondi për ujitjen dhe kullimin. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore të punonjësve si dhe për shpenzime operative.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, para fillimit të vitit buxhetor 2020, duhet të dërgojë në bashkitë përkatëse kuadrin ligjor dhe nënligjor lidhur me këtë shërbim.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

8. Klubet sportive shumësportëshe, “Partizani” dhe “Studenti”

Në transfertën e vitit 2020, bashkisë Tiranë i janë akorduar fondet për shpenzime për personelin dhe për shpenzime operative për klubet sportive shumësportëshe “Partizani” dhe “Studenti”. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Bashkia Tiranë mund të shtojë fonde nga të ardhurat e veta për të rritur cilësinë e shërbimit në këto klube.

DEKRET

Nr.11403, datë 30.12.2019

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Ilir Meta

VENDIM

Nr. 866, datë 24.12.2019

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË MBROJTJES SOCIALE, 2020–2023, DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT NË ZBATIM TË SAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale, 2020–2023, dhe të planit të veprimit në zbatim të saj.

2. Vendimi nr. 1071, datë 23.12.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale, 2015–2020, dhe të planit të veprimit, për zbatimin e saj”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Shërbimi Social Shtetëror, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, inspektorati përgjegjës për shërbimet shoqërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



STRATEGJIA KOMBËTARE E MBROJTJES SOCIALE

2020–2023

Dhjetor 2019

KONTEKSTI POLITIK, INSTITUCIONAL DHE SOCIAL

Politika për zbutjen e varfërisë, krijimi i kushteve që individët, familjet dhe fëmijët në situata të vështira të përballojnë efektet që shkakton varfëria, vulnerabiliteti dhe përjashtimi është prioritet kyç i Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2020–2023. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) është institucioni përgjegjës për zhvillimin e politikave të Mbrojtjes Sociale në Republikën e Shqipërisë.

Strategjia adreson objektiva të qartë dhe të matshëm për mbrojtjen sociale në Shqipëri. Ky dokumenti i paraqitur ka si qëllim të rishikojë dhe konsolidojë strategjinë aktuale të Mbrojtjes Sociale, si pjesë e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI 2015–2020), duke zgatur harkun kohor të saj deri në vitin 2023.

Dokumenti është hartuar mbi bazën e konsultimeve, diskutimeve dhe këshillimeve me profesionistë, ekspertë dhe aktorë të fushës së NE-së, PAK-së dhe Shërbimeve Shoqërore. Ky dokument reflekton parimet themelore të një sistemi modern të mbrojtjes sociale. Strategjia reflekton angazhimet e Qeverisë Shqiptare në fushën e Mbrojtjes Sociale, duke synuar që t'i sigurojë çdo qytetari shqiptar, burrë, grua, djalë apo vajzë, pavarësisht të ardhurave, origjinës, moshës, gjinisë, etnisë, edukimit, orientimit seksual, identitetit kulturor, bindjeve politike e fetare, shërbime publike cilësore, të cilat rikonceptohen me prioritet familjen dhe duke adresuar “qasjen e ciklit të jetës”.

Kjo strategji hartohet në përputhje me nenet 70 dhe 99, të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Dokumentit të Partneritetit 2007 dhe përmbush detyrimet që burojnë nga Plan i Kombëtar për Integrimin Evropian 2014–2020.

Strategjia gërsheton politika dhe programe specifike për të reduktuar varfërinë, duke zvogëluar ekspozimin e familjeve dhe popullatës/njerëzve ndaj rreziqeve dhe duke rritur kapacitetin e tyre për të mbrojtur veten nga rreziqet dhe mungesën e të ardhurave. Propozon ndërhyrje prioritare

nëpërmjet zbatimit të programeve të ndihmës ekonomike, sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve shoqërore e shëndetësore, duke përfshirë mbrojtjen e familjeve, fëmijëve dhe popullatës bazuar në skema makro (në nivel kombëtar) dhe në nivel mikro (në nivel bashkie, qyteti, fshati, komuniteti, familje), si dhe procesin e rikthimit drejt tregut të punës me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës për çdo individ dhe familje.

Strategjia synon të përmirësojë mirëqenien fizike, shoqërore dhe ekonomike të individëve, fëmijëve dhe familjeve, veçanërisht të atyre në kushte sociale ose ekonomikisht të pafavorizuara, duke garantuar shanse të barabarta dhe parimet e drejtësisë sociale.

Strategjia synon reduktimin e varfërisë, sidomos varfërisë ekstreme, duke garantuar një jetesë dinjitoze për familjet/individin dhe fëmijët. Varfëria do të ulet, duke nxitur zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive të tyre nëpërmjet adresimit të nevojave në kontekstin e rehabilitimit, integritetit në tregun e punës dhe të shërbimeve shoqërore.

Familja ka një aspekt mbështetës prioritar në këtë strategji në drejtim të konsolidimit të skemës së re të NE-së, duke prioritetizuar shënjestrimin më të mirë të familjeve të prekura nga varfëria dhe duke i mbështetur ato nëpërmjet sigurimit të asistencës afat-shkurtër për familjet/personat në nevojë dhe inkurajimin e mbështetjes së tyre për daljen nga skema duke hartuar dhe zbatuar një program të veçantë “daljeje”, i cili siguron mekanizmat e punësimit të anëtarëve në moshë pune të familjeve përfituese të skemës së NE-së, të cilët kanë periudhë të kufizuar qëndrimi në skemë. Politika më e re e qeverisë në drejtim të nxitjes së lindshmërisë dhe akordimit të ndihmës së menjëhershme financiare për nënat me foshnja të porsalindura është një tjetër prioritet i strategjisë.

Paketa mbështetëse me subvencione shtesë/bonuse për vaksinimin dhe arsimimin e fëmijëve, si dhe ofrimi i paketës së ndihmës në natyrë tregon vëmendjen e shtuar për të asistuar familjen në tërësi duke integruar të gjitha llojet e shërbimeve publike.

Risi e kësaj strategjie është reformimi i parimeve dhe sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, duke propozuar një model të ri multidisiplinor biopsikosocial i bazuar në standardet e Organizatës



Botërore të Shëndetësisë për vlerësimin në tërësi të nevojave të individit, i rritur apo fëmijë, me aftësi të kufizuara dhe jo duke u fokusuar vetëm në diagnostikimin e tyre. Qasja e re përfshin një paketë të plotë të integruar për PAK-në që nga identifikimi i hershëm, diagnostikimi, vlerësimi i nevojave, menaxhimi i rastit të plotë që nga këshillimi, rehabilitimi nëpërmjet shërbimeve të specializuara sociale dhe shëndetësore, dhe sipas rastit edhe integrimi për punësim dhe arsimim apo kualifikime profesionale.

Kjo strategji synon të zhvillojë një sistem të integruar funksional të shërbimeve të kujdesit shoqëror për çdo burrë, grua, djalë dhe vajzë, sistem që promovon zgjedhjen, pavarësinë dhe inkurajon pjesëmarrje të plotë dhe efektive në shoqëri, sipas një qasjeje të barabartë për të gjithë qytetarët që kërkojnë shërbime. Një objektivi specifik është edhe krijimi i sistemit të integruar të shërbimeve shoqërore dhe shëndetësore në nivel vendor për familjen, fëmijët dhe individët në nevojë. Lidhja midis “shërbimeve shëndetësore” dhe “shërbimeve sociale” lejon trajtimin multidisiplinar për individin dhe familjen e tij/saj.

Strategjia mundëson përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndikojnë në përmirësimin e jetës të individëve dhe familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

Zhvillimi i shërbimeve të përkujdesjes alternative, është një përgjigje ndaj institucionalizimit të grupeve në nevojë, sidomos fëmijëve. Shërbimet e asistencës shtëpiake për të moshuar dhe personave me aftësi të kufizuara, shërbimet për familjen dhe prindërimin, transformimi i institucioneve të përkujdesjes sociale, janë prioritetet thelbësore të strategjisë.

Për herë të parë nëpërmjet krijimit të një linje buxhetore të veçantë, Fondit Social, dhe alokimit të buxhetit qendror mundësohet që çdo bashki të ngrejë shërbime shoqërore në territor për grupet në nevojë duke garantuar shërbimet shoqërore minimale (apo shporta e shërbimeve), si dhe qëndrueshmëri të shërbimeve aktuale sipas nevojave të specifikuar në Planin Social të çdo bashkie. Sfidë shumë e rëndësishme mbetet aftësia e pushtetit vendor për të planifikuar dhe menaxhuar fondet.

Ngritja dhe funksionimi i sistemeve kombëtare elektronike për NE-në për familjet në nevojë, për

personat me aftësi të kufizuara, si dhe për shërbimet shoqërore lehtëson gërvetimin/ndërthurjen i/e përfitimit të NE-së në para, pagesës së aftësisë së kufizuar dhe përfitimin e shërbimeve shoqërore në familje duke plotësuar tërësinë e nevojave, si dhe duke maksimizuar masat mbrojtëse sociale për një jetë më të mirë. Strategjia nxit ofrimin e shërbimit të integruar të mbështetjes duke bashkërenduar ndihmën në natyrë me atë në pagesa dhe shërbime shoqërore. Është politikë kyçe për përmirësimin e cilësisë së jetës, pasi nuk kufizohet vetëm në ciklin e jetës, por përfshin gjerësisht familjen, fëmijët dhe individin në nevojë.

Kjo strategji garanton mbrojtje sociale sa më të plotë për familjen dhe individin në nevojë.

Strategjia është projektuar drejt maksimizimit të përfitimeve sociale dhe shmangien ose minimizimin e rreziqeve sociale, veçanërisht për grupet vulnerabël dhe të marginalizuara. Ajo përfshin njerëzit dhe komunitetet e tyre, organizatat, institucionet, shoqëritë dhe qeveritë në të gjitha aktivitetet për lehtësimin e varfërisë.

Krijimi i një mjedisi mundësues për organizatat e shoqërisë civile është një nga parakushtet dhe masat për një demokraci të qëndrueshme. Shërbimet shoqërore të ofruara përmes sektorit jo-publik -kryesisht të financuara nga partnerët zhvillimorë ndërkombëtarë, OJF-të ndërkombëtare dhe organizatat lokale janë përpjekur të mbushin boshllëqet në ofrimin e shërbimeve publike. Bashkëpunimi i mirë midis një qeverie me mendësi të orientuar drejt shërbimit dhe një shoqërie civile aktive, kritike dhe konstruktive përbën një element të domosdoshëm për rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe për garantimin e mbrojtjes sociale për të gjitha grupet. Dialogu dhe bashkëpunimi mes institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile janë në interesin e drejtpërdrejtë të çdo individi për mirëfunksionimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse.

Strategjia përcakton role, përgjegjësi, si dhe një kornizë monitorimi e cila orienton të gjithë aktorët e përfshirë në zbatimin me korrektësi dhe respektimin e standardeve të miratuara, duke garantuar një cilësi më të mirë për fëmijët, individin dhe familjen në nevojë.

Referenca me dokumentet strategjike dhe dokumente të BE-së

Legjislacioni i mbrojtjes shoqërore (NE, PAK dhe shërbime shoqërore) në Republikën e Shqipërisë është hartuar/mbështetur në disa



parime, që burojnë nga aktet kombëtare dhe ndërkombëtare, si:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë,
- Konventa për të Drejtat e Njeriut,
- Konventa për të Drejtat e Fëmijëve,
- Konventa e të Drejtave të Personave me

Aftësi të Kufizuara,

- Karta Sociale Evropiane (e rishikuar),
- Karta Evropiane e Autonomisë Lokale etj.
- Standardet e Organizatës Botërore të Shëndetit (OBSH),
- Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit,
- CEDAW

Dokumentet strategjike mbi të cilat është ndërtuar legjislacioni janë:

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020 (SKZHI),
- Strategjia Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore për 2015–2020,
- Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014–2020,
- Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014–2020,
- Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara (2016–2020),
- Strategjitë e Evropës 2020 dhe Evropës Juglindore 2020, si dhe Shtyllën Evropiane të të Drejtave Sociale,
- Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike (SNRAP) 2015–2020,
- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit 2016–2020,
- Politikat dhe objektivat specifike të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2020–2023 dhe Plani i Veprimit, janë, gjithashtu, në linjë me disa prej Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ/SDG):

- Synimi 1: Zhdukja e varfërisë kudo dhe në të gjitha format.

- Synimi 3: Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë në të gjitha moshat.

- Synimi 4: Sigurimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe krijimi i mundësive për të mësuarit gjatë gjithë jetës, për të gjithë.

- Synimi 5: Arritje e barazisë gjinore dhe fuqizim i grave.

- Synimi 8: Promovim i rritjes së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse ekonomike, punësim dhe punë për të gjithë.

- Synimi 11: Qytete për të gjithë, të sigurta, reziliente dhe të qëndrueshme.

KUADRI INSTITUCIONAL

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është institucioni kryesor, përgjegjës për hartimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave të mbrojtjes, kujdesit dhe integritit të individëve dhe grupeve në nevojë.

Shërbimi Social Shtetëror institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është përgjegjës për zbatimin e politikave të ministrisë përgjegjëse për çështjet e ndihmës ekonomike, të aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor është institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin e politikave kombëtare të kontributit dhe përfitimit të kujdesit shëndetësor, për të gjitha grupet përfituese.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, është institucioni përgjegjës për zbatimin e politikave kombëtare të kontributeve dhe përfitimeve.

Sipas Reformës Territoriale të miratuar nëpërmjet ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë dhe bazuar në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, sigurimi dhe funksionimi i shërbimeve shoqërore për kategoritë në nevojë, përfshirë të moshuarit, është përgjegjësi e njërive të vetëqeverisjes vendore, përkatësisht për:

- Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale komunitare, në nivel lokal,

- Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore,

- Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

PJESA I

ANALIZA E SITUATËS

1.1 NDIHMA EKONOMIKE

Në kushtet kur SILK nuk është prodhuar për vitet 2016–2017–2018, nuk kemi bazë krahasimi për nivelin e varfërisë. Duke pranuar faktin se ndihma ekonomike lehtëson varfërinë nëpërmjet skemës së NE-së do të bëjmë një analizë të detajuar të reformës së NE-së.



Skema e re në janar 2018 u shtri në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe numri i aplikuesve për vitin 2018 ka qenë dinamik. Familjet e varfra, jo përfituese, nga sistemi i pikëzimit u trajtuan nga këshillat bashkiakë nëpërmjet përdorimit të fondit 6% të bashkive.

Skema e NE-së është një skemë *transparente*, e cila shënjestron familjet më të varfra dhe në nevojë. Për shkak të heqjes së kriterëve përjashtues 18730 familje aplikuan për herë të parë për Ndihmë Ekonomike, pra, iu dha mundësia të përfshihen në skemë.

Skema e re shmangu përfitimet e padrejta, duke mos favorizuar dhe duke përjashtuar abuzuesit, të cilët nuk deklarojnë apo bëjnë deklarime të rreme lidhur me situatën e tyre social ekonomike. Në muajin e parë të shtrirjes së NE-së u përjashtuan/refuzuan nga skema, për shkak të abuzimeve dhe deklarimeve të rreme, rreth 20.000 aplikues.

Përgjatë vitit 2018 numri i përfituesve ka qenë në rritje me 16% krahasuar me muajin e parë të shtrirjes së skemës (janar 2018). Është shënuar ulje gjatë tremujorit të dytë dhe ka pësuar rritje me 7% të numrit të aplikantëve në tremujorin e katërt. Në muajin janar 2018 numri i aplikimeve ishte 96.872, kurse numri i familjeve përfituese ishte 51.703. Në muajin dhjetor 2018 numri i aplikimeve ishte 64.705, kurse numri i familjeve përfituese ishte 60.052 dhe 3.608 familje përfituan nga fondi 6%.

Sa më sipër, evidentohet reduktimi i hendekut/zbutje ndërmjet numrit të familjeve aplikuese dhe atyre përfituese nga skema e NE-së, duke bërë të mundur që 93% e aplikuesve të rezultojnë përfitues në këtë skemë.

Me skemën e re të NE-së nuk ka më pagesa të pjesshme të NE-së. Është rritur me 50% masa mesatare e NE-së për familje, nga 3.500 deri në 5.600 lekë në muaj, ku familjet me shumë anëtarë përfitojnë deri në 10.000 lekë duke pasur përfitime shtesë. Subvencionet shtesë të NE-së për familjet me fëmijë të vegjël për vaksinimin dhe arsimimin e tyre në masën deri në 400 lekë shtesë aplikohen çdo muaj.

Rezultatet tregojnë se sistemi i ri i përzgjedhjes në përgjithësi, shënjestron familjet më të varfra. Gjithashtu nga kjo skemë ka rezultuar se 14.086 familje, kanë përfituar për herë të parë NE. Familjet përfituese kanë qenë përgjithësisht ato më të mëdha, me shumë fëmijë, me kushte më të

këqija strehimi dhe me shpenzime familjare më të ulëta sesa ato të përjashtuara nga skema e re. 6.493 gra k/familjare trajtohen me NE-në në muajin dhjetor 2018, kundrejt 4.277 në muajin Janar 2018. Kanë përfituar NE nga skema e re 652 jetimë; 340 fëmijë me aftësi të kufizuar, familjet e të cilëve përfitojnë NE); 416 viktima dhune dhe trafikimi; 103 familje me 3- 4- 5-njakë; 93.226 fëmijë nën 18 vjeç; 3.313 invalidë mbi moshën 60 vjeç, familjet e të cilëve përfitojnë NE; 9.410 familje që kanë në përbërje të tyre persona me aftësi të kufizuara dhe 9.527 familje rome dhe egjiptiane.

Ndihma Ekonomike krahas kategorive ekzistuese përfituese të transfertës së NE-së (familjeve në nevojë edhe jetimëve) mbështet edhe familjet me trinjakë, katërnjakë e pesënjakë; viktimat e trafikimit¹ dhe viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare.

Duke filluar nga Janari 2019, qeveria shqiptare, nëpërmjet politikave të reja sociale, mbështet drejtpërdrejt fëmijët, familjen dhe zhvillimin e shoqërisë, duke garantuar shpërblimin (bonus) për çdo të porsalindur, 40 mijë lekë për fëmijën e parë, 80 mijë lekë për fëmijën e dytë dhe 120 mijë lekë për fëmijën e tretë.

Reforma e re e skemës së NE, është realizuar nga MSHMS me mbështetjen e Projektit për Modernizimin e Asistencës Sociale (PMAS) të Bankës Botërore. Në 31.12.2018 përfundoi marrëveshja e parë me PMAS, e cila u fokusua në rritjen e efikasitetit, barazinë në akses dhe transparencë të skemave të NE-së dhe PAK. Po me mbështetjen e Bankës Botërore nënshkruhet marrëveshja e financimit shtesë për Reformën e Programit të Mbrojtjes Sociale, komponent i së cilës është hartimi i “Programit të daljes” për përfituesit e skemës së NE-së të cilët kanë kohë të kufizuar qëndrimi në këtë skemë.

Dy ndër elementet kryesorë të Reformës së Mbrojtjes Sociale janë përdorimi me efikasitet i Regjistrit Kombëtar Elektronik të NE-së, nëpërmjet 2 moduleve të ngritura nga Ministria për monitorimin dhe vlerësimin e skemës së NE-së dhe lidhjen me sistemin e thesarit për administrimin më të mirë të fondeve të ndihmës ekonomike.

Regjistri Kombëtar Elektronik i NE-së është duke u përdorur për procesin e aplikimit për

¹Neni 1, i ligjit nr. 10 252, datë 11.3.2010.



ndihmë ekonomike, kontrollin e kryqëzuar të informacionit, për zgjedhjen dhe hartimin e vendimeve të shoqëruara me urdhërpagesat e përfituesve, identifikon, verifikon, raporton, kontrollon kur dyshohet për parregullsi/shkelje rast pas rasti.

Vazhdon verifikimi i kryqëzuar i deklarimeve të familjeve aplikuese me sistemet e informacionit të institucioneve dhe mbetet domosdoshmëri rritja e numrit të institucioneve që ofrojnë informacione *online*.

MSHMS mbështeti gjithashtu përmirësimet dhe rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve, në procesin e aplikimit dhe ndërveprimin aplikues-administrator shoqëror, si dhe në raportimin dhe informimin në kohë reale të institucioneve përgjegjëse, për tregues të caktuar që shërbejnë në procesin e vendimarrjes dhe zhvillimit të politikave.

Familjet me të ardhura të ulëta dhe grupet në rrezik janë përfituesit kryesorë të reformave të mbështetura nga MSHMS-ja. Ministria i dha mundësinë këshillave bashkiakë që të trajtojnë me ndihmë ekonomike familjet në nevojë të cilat nuk mund të përfitojnë NE nga skema e pikëzimit, duke iu dhënë mundësinë pushtetit vendor që me kriteret e veta të trajtojnë familje që ato gjykojnë se janë të varfra, duke i dhënë një fond shtesë në masën 6 për qind² mbi fondin për bllok-ndihmën ekonomike për atë Bashki.

Kjo strategji konsolidon monitorimin dhe kontrollin e proceseve të aplikimit, vendimarrjen dhe përfitimin e NE, bazuar në Metodologjinë e Kontrollit të NE-së të miratuar nga Ministria mbi vlerësimin e riskut. Për herë të parë në Regjistrin e NE-së është parashikuar vlerësimi i profilit të riskut dhe përdorimi i tij në kontrollet e ushtruara nga SHSSH-ja dhe Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Ligji gjithashtu parashikon edhe procedurën e ankimit³, duke i dhënë të drejtën aplikuesit që për mospërfitimin e ndihmës ekonomike, të ankimohet në tri shkallë: pranë Bashkisë, Drejtorive Rajonale të SHSSH-së dhe Gjykatës Administrative.

Aktualisht ka disa lidhje mes skemës së NE-së dhe politikave aktive të punësimit. Këto të fundit

janë të kufizuara në Shqipëri dhe rrjedhimisht kanë ndikim të kufizuar. SHSSH-ja, si agjencia implementuese e politikave të ministrisë për programet e mbrojtjes sociale, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me SHKP-në për punësimin e personave në moshë aktive pune, familjet e të cilëve përfitojnë NE.

Strategjia synon integrimin në jetën shoqërore të familjeve të skemës së NE-së nëpërmjet programeve të tilla si: nxitja e punësimit, orientimi në tregun e punës nëpërmjet kurseve të formimit profesional dhe programeve të ngjashme që kanë çuar në përfshirjen në tregun e punës të anëtarëve në moshë aktive pune. Për vitin 2018, 15000 persona janë trajtuar nga zyrat e punësimit, 4266 janë punësuar dhe 681 persona janë regjistruar në programet e formimit profesional. Të gjithë aplikantët e NE-së duhet të regjistrohen çdo muaj si punëkërkuar të papunë. Kjo praktikë duket se ka sjellë rezultate në punësimin e anëtarëve në moshë punë të familjeve të skemës së NE.

Bazuar në programin e Qeverisë Shqiptare, me mbështetjen e Bankës Botërore, MSHMS do të hartojë “Programin e daljes”, si një program i cili ka si qëllim ndërlidhjen e programeve të mbrojtjes sociale me skema të tjera nxitëse punësimi, duke u krijuar mundësinë e integritit në tregun e punës të anëtarëve në moshë pune në skemën e NE. Këtë qëllim programi i daljes synon ta realizojë nëpërmjet ndërthurjes/gërshetimit/integritit të paketës së plotë ligjore për ngritjen dhe funksionimin e ndërmarrjeve sociale me programet e nxitjes së punësimit dhe formimit profesional, si dhe përfshirjen e përfituesve të NE-së në politika zhvillimore territoriale (si zhvillimi rural, zhvillimi infrastrukturës apo shfrytëzimi i pyjeve dhe kullotave etj.).

Programi synon/krijon një mjedis miqësor për ndërthurjen e përfitimit të pagesave në para të NE-së me shërbime të tjera, drejt strukturimit të një pakete të plotë shërbimesh ndaj familjes/individit siç janë; i. shërbimet shoqërore për individin dhe familjen duke ofruar asistencë/shërbime në shtëpi për të moshuar, personat me aftësi të kufizuara etj.; ii. ndihmën në natyrë për familjet/individët ekstremisht të varfër; iii. arsimimi dhe kujdesi shëndetësor.

² Udhëzimi nr.5, datë 17.2.2017, “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind”.

³ Neni 41/1, i ligjit nr. 44/2016.



1.2 SFIDAT LIDHUR ME NDIHMËN EKONOMIKE

Sfidat e mëtejshme të politikave të mbrojtjes sociale në lidhje me zbatimin e skemës së përfitimit të transfertave të NE-së lidhen me rritjen e eficiencës së skemës së ndihmës ekonomike nëpërmjet:

- Konsolidimit të skemës së NE-së në të gjithë territorin nëpërmjet përmirësimit të Regjistrat Kombëtar Elektronik, monitorimit dhe vlerësimit të riskut të skemës së NE-së.

- Monitorimit dhe vlerësimit mbi bazën e riskut të zbatimit të legjislacionit të NE-së dhe administrimit të buxhetit në kohë reale nëpërmjet sistemit elektronik dhe ndërthurjes së tij me thesarin.

- Rritjes së kapaciteteve të strukturave qendrore, rajonale dhe vendore, në fusha që përfshijnë administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e skemës së Ndihmës Ekonomike.

- Hartimin dhe zbatimin e “Programit të Daljes”, si një program i veçantë për përfituesit e skemës së NE-së, të cilët kanë qëndrim të kufizuar në këtë skemë, duke i integruar ato në tregun e punës dhe jetën shoqërore.

- Bashkëpunimit me institucionet e tjera përgjegjëse, përfituesit e Ndihmës Ekonomike do të përfshihen në politikat zhvillimore të territorit, si zhvillimi rural, zhvillimi i infrastrukturës, apo shfrytëzimi i pyjeve dhe kullotave.

- Ndërmarrjeve sociale të cilat janë të rregulluara me ligj të veçantë, por sfida mbetet, nxitja reale e këtij modeli drejt skemave të financimit të aktiviteteve që synojnë integrimin në punë të anëtarëve në moshë pune të familjeve përfituese të NE-së.

- Ndërlidhjes së shërbimeve ndaj përfituesve të Ndihmës Ekonomike me shërbime shoqërore, ndihma ekonomike në natyrë (bonuse), arsim, strehim apo tjetër, parë në këndvështrimin e familjes, si shërbim i integruar, bazuar në qasjen e ciklit të jetës (fëmijë/të rinjtë/të moshuar).

- Ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit të opinionit publik dhe grupeve të interesit, për të komunikuar në mënyrë të shënjestruar, se kush janë qëllimet reale dhe rezultatet e pritshme të reformës.

2.1 AFTËSIA E KUFIZUAR

Sipas statistikave të fundit nga Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH) në gusht 2018, numri i personave që janë njohur zyrtarisht që kanë një

aftësi të kufizuar në Shqipëri është 141 740 (4.8 % e popullsisë së vendit). Nga këta, 73 425 persona janë invalidë pune që përfitojnë si nga pagesat e sigurimeve shoqërore ashtu edhe nga pagesat shtesë të skemës së mbrojtjes sociale dhe 68 315 fëmijë e të rritur, që marrin pagesat e aftësisë së kufizuar dhe përfitime të tjera në sistemin e mbrojtjes sociale. Nga këta të fundit, 19 060 persona (28%) marrin edhe pagesë për të mbuluar shërbimin e ndihmës personal që më parë është quajtur shërbimi i kujdestarisë.

Reformimi i sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar është i nevojshëm për disa arsye si: (a) reflektimi i praktikës bashkëkohore ndërkombëtare të shndërrimit të vlerësimit mjekësor, në vlerësim biopsikosocial, për të reflektuar konceptin e ri të aftësisë së kufizuar, si një ndërveprim të dëmtimeve funksionale të shkaktuara nga një sëmundje me faktorë psikologjikë e socialë; (b) rritja e eficiencës së vlerësimit, duke krijuar mekanizmat administrativë që reduktojnë ndjeshëm shkallën e abuzimit, rrisin besueshmërinë dhe ulin koston e vlerësimit dhe (c) përmirësimi i shërbimit për qytetarët. Për më tepër, ky reformim është një domosdoshmëri për të unifikuar qasjen e vlerësimit me parimet e shprehura në Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara, si dhe me nenin përkatës të Ligjit nr.93/2014, datë 24.7.2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara (Kapitulli III, neni 10).

Pas një vlerësimi të kujdesshëm të nevojave, për të arritur rezultatet e dëshiruara për reformimin e vlerësimit të aftësisë së kufizuar në Shqipëri, rezulton se janë shtatë aspekte të ndërthurura, të cilat janë të rëndësishme të merren në konsideratë si pjesë e një vizioni të ri. Ato përfshijnë: 1. kriteret e reja biopsikosociale për vlerësimin e aftësisë së kufizuar; 2. krijimin e një procesi të ri multidisiplinor për vlerësim; 3. ngritjen e administratës së vlerësimit nëpërmjet strukturave të vlerësimit dhe përcaktimit të aftësisë së kufizuar në drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror; 4. krijimin e një sistemi të informatizuar për të dhënat dhe përlllogaritjen automatike të përfitimeve; 5. rishikimin e përfitimeve të aftësisë së kufizuar, të administruara nga sistemi i mbrojtjes sociale; 6. nxitjen e punësimit për personat me aftësi të kufizuara si edhe zgjerimin e shërbimeve dhe 7. ngritjen e një strukture për aftësinë e kufizuar në



Ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale.

Që nga viti 2018 procesi i vlerësimit të aftësisë së kufizuar ka pësuar përmirësime, të cilat kanë pasur në fokus qytetarin. Përmirësimet konsistojnë në lidhje me: i. lehtësimin dhe reduktimin e dokumentacionit të tepërt që duhet të përgatisë individit që kërkon të vlerësohet / rivlerësohet për aftësinë e kufizuar; ii. shmangien e burokracive, vonesave të panevojshme dhe vajtje - ardhjeve të individëve nga një institucion në tjetrin për plotësimin dhe dorëzimin e dokumentacionit; iii. institucionet publike kryejnë jo vetëm procesin e diagnostikimit dhe të referimit të rasteve për vlerësim, por janë gjithashtu përgjegjëse për përcjelljen e dokumentacionit nga një institucion në tjetrin, gjë të cilën deri më parë e ka bërë qytetari; iv. individët me aftësi të kufizuara dhe të verbrit paraqiten për diagnostikim dhe ekzaminim vetëm në institucionet shëndetësore dhe vlerësimi kryhet në bazë të dokumentacionit mjekësor, duke shmangur paraqitjen e tij fizike.

E vështuar ndër vite, masa e përfitimit është rritur me 18 % nga viti 2005 në vitin 2006 dhe më pas me 9% nga viti 2007 në vitin 2008. Në vijim, është rritur me 2–4% në vit. Kostoja e pagesave e kësaj skeme për 6-mujorin e parë të vitit 2018 është 8,145,552,507 lek, pra 3.7% më e lartë se kostoja e 6-mujorit të vitit paraardhës (7,843,070,111). Kostoja është rritur ndër vite, si pasojë e dy faktorëve: a) rritjes së masës së përfitimit për t'iu përgjigjur rritjes së kostonë të jetesës dhe b) rritjes së numrit të përfituesve, veçanërisht të atyre që përfitojnë edhe nga sistemi i Sigurimeve Shoqërore. Kjo kosto përfshin përfitimin në pagesë edhe për shërbimin e ndihmës personal, nevojat higjieno-sanitare, përfitimin për nxitjen e shkollimit, si dhe masat e tjera për zbutjen e varfërisë si kompensimet e ndryshme.

Disa studime vlerësimi të kryera tregojnë që koncepti i sistemit të ri të vlerësimit, funksionon mirë. Vlerësimi i aftësive për të kryer detyrat bazë të jetës në përputhje me moshën, tregon qartë pranimin dhe shkallën e aftësisë së kufizuar, pavarësisht vlerësimeve të fryra, subjektive dhe abuzive të disa mjekëve. Totali i kursimit mujor për të rritur dhe fëmijë, për 725 përfituesit e vlerësuar deri në fundin e muajit korrik 2018, nëse do të vlerësohej aftësia e kufizuar sipas modelit biopsikosocial të OBSH-së, do të ishte 1.505.241 lekë/muaj si rezultat i përshkallëzimit të pagesave

ose 2.184.160 lekë/muaj, si rezultat i përshkallëzimit të pagesave edhe drejtimit të personave me aftësi të kufizuara të lehta drejt punësimit.

Pilotimi tregoi se realizimi me sukses i reformës kërkon shpenzime fillestare, kryesisht për ngritjen e rrjetit informatik, trajnimin e profesionistëve të ndryshëm të përfshirë në skemë, për ngritjen dhe përshtatjen e zyrave të reja dhe punësimin e personelit etj. Për këto arsye, reforma do të shtrihet me tri faza: në qarkun e Tiranës brenda vitit 2020, në qarqet e Durrësit dhe Elbasanit, gjatë periudhës 2020–2021 dhe në qarqet e tjera në periudhën 2022–2023. Në vitin 2024, reforma do të jetë e shtrirë në të gjithë vendin.

2.2 SFIDAT LIDHUR ME AFTËSINË E KUFIZUAR

Situata aktuale e sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar në Shqipëri paraqet sfida të shumta që lidhen me kriteret, procesin dhe administrimin⁴ e sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Një studim i hollësishëm i vlerësimit të aftësisë së kufizuar⁵, i kryer në vitin 2014, ka nxjerrë në pah sfida të shumta që lidhen me kriteret, procesin dhe administrimin⁶.

1. Pilotimi i skemës së re të vlerësimit biopsikosocial në qarkun Tiranë në vitin 2020, dhe në 2020/2021, në qarqet Durrës dhe Elbasan.

2. Përcaktimi i tiparit normativ për të përshkallëzuar dëmtimin funksional për kryerjen e veprimtarive bazë të jetës së përditshme⁷ (duke përfshirë edhe ato të aftësisë për punë për të rriturit).

3. Zbatimi i një modeli përfitimesh të aftësisë së kufizuar në sistemin e mbrojtjes sociale i cili shmang: a) trajtimin e privilegjuar e të pajustificuar të disa kategorive të aftësisë së kufizuar.

4. Vijimi i shpërndarjes së përfitimeve sipas statuseve dhe zbatimi i reformës së vlerësimit me

⁴ Duhet theksuar se shumë aspekte të praktikës së deritanishme të përshkruara në studim, bien ndesh me kapitullin III, neni 10, të ligjit nr. 93/2014, datë 24.7.2014, "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara".

⁵ Voko, K & Fortuzi, S. (2014). Një rishikim i sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar në Shqipëri. UNDP.

⁶ Duhet theksuar se shumë aspekte të praktikës së deritanishme të përshkruara në studim, bien ndesh me kapitullin III, neni 10, të ligjit nr. 93/2014, datë 24.7.2014, "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara".

⁷ Ky është përkufizimi aktual: "Personat, të cilëve u është kufizuar aftësia, si pasojë e dëmtimeve fizike, shqisore, të intelektit, psikiko/mendore, të lindura apo të fituara gjatë jetës nga aksidente, sëmundje, të përkohshme apo të përhershme, që nuk vijnë nga shkaqe, që lidhen me punësimin, e vërtetuar kjo nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), përfitojnë pagesë për shkak të aftësisë së kufizuar." (vendim i Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 7.9.2006).



përshkallëzim të pagesave sipas nevojave funksionale të individëve në këto kategori, nuk do të krijojë më pabarazi shoqërore në shpërndarjen e përfitimeve.

3.1 SHËRBIMET SHOQËRORE

Prioritet i tretë kryesor i strategjisë së Mbrojtjes Sociale është zhvillimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror të integruara pasi ato ndikojnë në mospërfashitim social, lehtësim aksesit në shërbimet sociale, të cilat ndikojnë në përmirësimin e jetesës së fëmijëve, individëve e familjeve, mirëqenien sociale të tyre. Aktualisht, shërbimet e kujdesit shoqëror të financuara nga fondet publike janë shumë të kufizuara në Shqipëri. Në 27 bashki nuk ka shërbime shoqërore në nivel vendor. Shumica e shërbimeve të kujdesit shoqëror ofrohen nga OJF të financuara në baza vullnetare ose nga partnerët tanë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Sipas të dhënave administrative dhe studimeve të UNICEF, shërbimet kryesisht gjenden në zonat më të mëdha urbane (90%), dhe 75% janë në zonat perëndimore dhe qendrore të vendit.

Ligji për Shërbimet shoqërore⁸, qartëson linjat e vendimmarrjes dhe funksionet e institucioneve qeverisëse vendore dhe qendrore. Ky ligj për herë të parë përcakton listën dhe llojet e shërbimeve shoqërore, mundëson përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndikojnë në përmirësimin e jetës së individëve dhe familjeve në nevojë. Shërbimet e kujdesit shoqëror janë të organizuara si shportë minimale e shërbimeve shoqërore me bazë komunitare, strehëza të përkujdesjes shoqërore, si dhe shërbimin e asistencës në familje për të gjitha kategoritë e identifikuar të përfituesve. Në kontekstin e ligjit të ri të decentralizimit fiskal dhe administrativ në Shqipëri, shërbimet e domosdoshme publike po delegohen tek qeveritë lokale (përfshirë dhe shërbimet e kujdesit social), ku lind si domosdoshmëri krijimi i mekanizmave të reja financimi dhe menaxhimi efektiv për ofrimin e shërbimeve, të koordinuara ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes. Krijimi i Fondit Social mundëson që çdo bashki të ngrejë shërbime të reja shoqërore në territor për grupet në nevojë, duke garantuar shërbimet shoqërore minimale, si dhe qëndrueshmëri të shërbimeve aktuale, sipas nevojave

të territorit, të specifikuara në Planin Social.

Ligji, por edhe vizioni afatgjatë i shprehur edhe në këtë dokument, synon të zhvillojë një sistem të integruar funksional të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe shëndetësor që promovojnë zgjedhjen, pavarësinë dhe inkurajojnë pjesëmarrje të plotë dhe efektive në shoqëri sipas një qasjeje të barabartë për të gjithë qytetarët që kërkojnë shërbime.

Prioritet dhe sfidë mbetet zhvillimi i përkujdesjes alternative, si një përgjigje ndaj institucionalizimit të fëmijëve, shërbimet e asistencës shtëpiake për të moshuar dhe personat me aftësi të kufizuara, shërbimet për familjen dhe prindërimin, transformimi i institucioneve të përkujdesjes sociale rezidenciale në qendra multidisiplinare dhe multifunksionale; Ofrimi i shërbimeve sociale të integruara nga figura profesionale (psikolog, punonjës social).

Shërbimet shoqërore publike ofrohen kryesisht përmes qendrave të kujdesit ditor dhe rezidencial dhe financohen nga buxheti i shtetit. Në nivel kombëtar funksionojnë 29 qendra publike shërbimi shoqëror nga të cilat 23 rezidenciale, 6 ditore, të kufizuara vetëm në 13 bashki.

Që nga viti 2005, qeveritë e njëpasnjëshme kanë hyrë në një proces të gjerë reformash të shërbimeve të kujdesit shoqëror, por procesi ka qenë i paqëndrueshëm pasi nuk është zbatuar një formulë e besueshme për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Shërbimet e kujdesit shoqëror publik përbëjnë një përqindje të vogël (më pak se 6.4%) të shpenzimeve të përgjithshme për mbrojtje shoqërore, ku shumica e shpenzimeve vjetore (93.6%) llogariten për transfertat e Ndihmës Ekonomike dhe Pagesën e Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK).

Shërbimet shoqërore të ofruara përmes sektorit jo-publik - kryesisht të financuara nga partnerët ndërkombëtarë, OJF-të ndërkombëtare dhe lokale, organizatat bamirëse, janë përpjekur të mbushin boshllëqet në ofrimin e shërbimeve publike. Modelet e tyre të shërbimeve shoqërore janë larg nga modeli tradicional i institucionalizimit të shërbimeve publike. Megjithatë, OJF-të varen nga financimi i donatorëve dhe agjendat e tyre politike; që nënkupton se ekzistojnë boshllëqe serioze në mbulimin e shërbimeve, si dhe paqëndrueshmëri të financimeve të tyre, financime të cilat po reduktohen me kalimin e kohës.

⁸ Ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.



Legjislacioni mbi të cilin janë ngritur dhe ofruar shërbimet shoqërore në Shqipëri para vitit 2016 ishte përfshirë në legjislacionin e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore, i cili ishte i orientuar më shumë drejt skemave të transfertave në para. Miratimi i legjislacionit të veçantë për shërbimet shoqërore në Shqipëri⁹ rriti shumëllojshmërinë e tipologjisë së shërbimeve; krijoi një profil shërbimesh me bazë komunitare; mundësoi procesin e deinstitutionalizimit të shërbimeve ekzistuese; transferoi përgjegjësitë dhe kompetencat drejt qeverisjes lokale; miratoi shportën bazë të shërbimeve shoqërore të detyrueshme për çdo bashki; krijoi Regjistrin Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror; kërkon një sistem të unifikuar të standardeve të shërbimeve shoqërore të reja; nxit zhvillimin e shërbimeve shoqërore në nivel vendor nëpërmjet hartimit dhe miratimit, në mënyrë detyruese, të planeve të kostuara të kujdesit shoqëror; përcakton strukturat monitoruese dhe kontrolluese të respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror; licencimin dhe akreditimin e ofruesve të shërbimeve shoqërore; rishikimin e kuadrit ligjor për prokurimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore dhe zbatimin e Fondit Social.

Një hap drejt deinstitutionalizimit është miratimi i planit të rrugëtimit të rivlerësimit dhe transformimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, hartimi i masave për parandalimin e institutionalizimit të fëmijëve të moshës 0-18 vjeç dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet e përkujdesjes shoqërore dhe promovimin e mbështetjes së tyre në familje¹⁰. Ky proces është realizuar nga MSHMS-ja në bashkëpunim me partnerë strategjikë ndërkombëtarë, UNICEF dhe *Save the Children*, grupet e interesit të shoqërisë civile, të kontraktuara nga këta të fundit.

Transferimi i përgjegjësiave dhe kompetencave drejt qeverisjes lokale në krijimin dhe menaxhimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror parashikohet/do të realizohet nëpërmjet:

a) Realizimit të procesit të deinstitutionalizimit,

nëpërmjet vlerësimit të institucioneve tona të përkujdesjes sociale dhe modelimit të shërbimeve të reja dhe alternative, transformimit të institucioneve aktuale në qendra multifunktionale (që ofrojnë shërbime komunitare, të emergjencës dhe rezidenciale), kalimi i tyre nga pushteti qendror në pushtetin vendor, si dhe sigurimi i burimeve të financimit.

b) Miratimit të shportës bazë të shërbimeve shoqërore të detyrueshme në nivel vendor, ku përfshihen: shërbime parashoqërore; informimi dhe këshillimi, ndërhyrja e hershme, këshillimi *online*, shërbime në komunitet; shërbimi në familje, alternativ, multifunksional, ditor dhe gjysmëditor, i emergjencës 72-orëshe, i strehimit të mbrojtur për të pastrehët; shërbime rezidenciale afatgjata dhe shërbime të specializuara.

Shërbimet e shportës bazë janë shërbime që synojnë mbulimin e nevojave bazë për individin/familjen dhe këto të fundit janë pjesë e vendimmarrjes për shërbimin që do të përfitojnë (një risi që duhet evidentuar).

Deri më sot numërohen 199 shërbime shoqërore publike dhe jopublike (respektivisht 119 dhe 80), të cilat, për herë të parë, kanë një qasje të bazuar në komunitet dhe kanë sjellë diversifikimin e ofrimit të shërbimeve, duke përfshirë fusha të tilla si mbështetja psikologjike, ndërgjegjësimi dhe advokimi. Këto shërbime për herë të parë rrisin gamën e ofrimit të shërbimit për përfitues të ndryshëm: fëmijët pa kujdes prindëror dhe ata me probleme sociale, rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuara dhe personave të moshuar, personat e trafikuar dhe këshillimin për gratë dhe vajzat. Aktualisht, duhet që stafet lokale të punojnë për një integrim të skemave të transfertave në para me shërbimet e kujdesit shoqëror, të bazuar në një vlerësim të nevojave të individit/familjes.

c) Mbështetjes së institucioneve vendore për monitorimin, hartimin dhe miratimin e planeve sociale rajonale dhe vendore që do të mundësojnë ngritjen dhe shpërndarjen e shportës së shërbimeve në nivel vendor bazuar në nevojat lokale. Ligji i ri i shërbimeve shoqërore ngarkon qeveritë vendore me përgjegjësinë për hartimin e Planit Social Vendor. Aktualisht, vetëm 24 bashki kanë hartuar plane sociale vendore, të kostuara dhe të miratuara nga këshillat bashkiakë.

Shërbimet shoqërore, me ligjin e ri të shërbimeve, ofrohen në nivel komunitar në nivel

⁹ Ligji dhe aktet nënligjore.

¹⁰ Gjatë vitit 2018 është ndërmarrë nisma #fëmijëtTëparët, në kuadër të deinstitutionalizimit të fëmijëve, për të cilën po punojnë 8 skuadra terreni ose 20 profesionistë të fushës, ekspertë të kualifikuar në bashkëpunim me *Unicef* dhe *Save the Children*, për të vlerësuar 2010 fëmijët e institucioneve.



vendor, bazuar në planet sociale vendore, të miratuara nga këshillat bashkiakë. Shërbimet në nivel qarku bazohen në planet sociale rajonale, pasi janë bashkërenduar me planet sociale të njërive të qeverisjes vendore, dhe miratohen nga Këshilli i Qarkut. Shërbimet e specializuara të ofruara në nivel rajonal përfitojnë financim, nëpërmjet transfertave të kushtëzuara, nga buxheti qendror.

Numri i njërive të qeverisjes vendore të mbuluara nga shërbimet e kujdesit shoqëror ka ardhur në rritje/është rritur. Kryesisht shërbimet e ofruara në njësitë vendore, janë shërbime të bazuara në komunitet, që menaxhohen nga OJF-të, të cilat financohen nga donatorë të huaj. 27 bashki (nga 61 bashki në nivel kombëtar) nuk ofrojnë shërbime shoqërore, ndërsa 44 bashkitë e tjera përballen me sfida në lidhje: a) me ofrimin e shërbimeve për të gjitha grupet në nevojë; b) shpërndarjen dhe mbulimin territorial me shërbime; c) garantimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së shërbimeve; d) alokimin e burimeve financiare dhe prokurimin e tyre; e) mungesën e strukturave dhe kapaciteteve lokale për vlerësimin e nevojave, planifikimin e shërbimeve shoqërore, ofrimin dhe monitorimin e tyre në nivel lokal.

Pushteti vendor duhet të fillojë të parashikojë fonde të vetat për ngritjen, mbështetjen dhe zgjerimin e shërbimeve shoqërore në territorin e tij.

Për herë të parë në nivel vendor parashikohet ngritja e një strukture të posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe/ose njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit, përgjegjëse për identifikimin dhe menaxhimin e rastit. Roli dhe përgjegjësitë e këtyre strukturave përcaktohen më së miri në ligjin 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”.

Hartimi i standardeve dhe zbatimi i tyre në ofrimin e shërbimeve dhe funksionimit të qendrave që ofrojnë shërbime, është garanci në ofrimin e një shërbimi cilësor të trajtimit të kategorive në nevojë, pavarësisht gjinisë, moshës, etnisë, nevojave të veçanta apo aftësive të kufizuara, përkatësisë fetare, identitetit gjinor apo orientimit seksual të tyre, si dhe për individët e tjerë, pjesëtarë të familjeve të tyre. MSHMS-ja ka hartuar dhe miratuar 4 standarde për 4 shërbime të reja respektivisht; asistencë në shtëpi për të moshuar, asistencë në shtëpi për persona me aftësi të kufizuar, shërbimi i emergjencës për viktimat e dhunës seksuale,

shërbimi multidisiplinar komunitar. Gjithashtu, për herë të parë ngrihet një shërbim publik për të rinjtë në nevojë. Ky shërbimi i ri zbatohet në Shtëpinë e fëmijës 16–18 vjeç në Shkodër. Për funksionimin e tij janë hartuar standardet, rregullorja e brendshme, janë përshtatur modulet dhe dokumentacioni bazë si dhe është trajnuar stafi i ri për këtë shërbim. Aktualisht marrin shërbim 10 fëmijë. Aktualisht janë në proces rishikimi të gjitha standardet ekzistuese të shërbimeve shoqërore, në përputhje me kërkesat që lindin nga zbatimi i kuadrit të ri ligjor.

Zhvillimi i kapaciteteve për profesionistët në shërbime do të realizohet nëpërmjet një programi të detyrueshëm për edukimin e vazhdueshëm profesional, të quajtur “Programi i certifikimit për profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror”. Ligji parashikon certifikimin dhe procesin e krediteve të edukimit të vazhdueshëm për: i. kushtet për punësimin në institucionet e kujdesit shoqëror, publike dhe jopublike, si dhe ii. detyron institucionet publike dhe jo publike të shërbimeve të kujdesit shoqëror të hartojnë dhe të zbatojnë programe të edukimit të vazhdueshëm për profesionistët e tyre. Sigurimi i cilësisë së aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm, do të realizohet nëpërmjet akreditimit. Të gjitha subjektet publike/jopublike, fitimprurëse ose jofitimprurëse, të huaja dhe vendase, që kanë ekspertizë dhe eksperiencë në organizimin e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të licencuara për ofrimin e trajnimeve e të kualifikimeve, akreditohen nga ministria, në mënyrë periodike.

MSHMS-ja, në bashkëpunim me strukturat akademike, është e angazhuar për hartimin e akteve nënligjore për proceset e certifikimit dhe akreditimit.

SHSSH-ja, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, është përgjegjëse për monitorimin e shërbimeve, ndërsa Inspektorati i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror ka përgjegjësi të kontrollojë dhe të verifikojë respektimin e kërkesave ligjore në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Monitorimi dhe inspektimi i zbatimit të standardeve të shërbimeve shoqërore kërkon konsolidimin e strukturave të MSHMS-së, SHSSH-së, Inspektoratit dhe Njërive Vendore. Vëmendje e veçantë do ti kushtohet ndarjes së funksioneve monitoruese të SHSSH-së nga funksionet



kontrolluese të Inspektoratit. Rolet dhe funksionet e reja është e domosdoshme të shoqërohen me rritje të kapaciteteve të stafeve, si dhe burimeve financiare shtesë. Aktualisht po punohet për plotësimin e akteve nënligjore për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe veprimtarisë së Inspektoratit.

Në zbatim të legjislacionit të shërbimeve shoqërore, në vitin 2018 është ngritur Regjistri Elektronik Kombëtar i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror¹¹. Shërbimi Social Shtetëror është struktura përgjegjëse për përditësimin dhe mirëmbajtjen e tij. Regjistri është baza elektronike e të dhënave të përfituesve, subjekteve ofruese, institucioneve përgjegjëse, llojit dhe kohëzgjatjes së shërbimeve të kujdesit shoqëror. Ai shërben për ndërtimin e një mekanizmi funksional të referimit, ndjekjes, monitorimit dhe vlerësimit të rastit; identifikimin e rasteve, këshillimin dhe hartimin e planeve individuale të përkujdesjes nga njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit, në përputhje me ligjin e shërbimeve të kujdesit shoqëror; referimin në shërbimet specifike shoqërore të nivelit vendor, rajonal apo kombëtar; lehtësimin e komunikimit, të verifikimit dhe bashkëpunimit me regjistrat e tjerë elektronikë; unifikimin e kompjuterizimin e të dhënave të rasteve dhe përmirësimin e cilësisë së statistikave të harmonizuara, të gjeneruara nga sistemi. Ky proces u ndesh me shumë vështirësi dhe nuk është shtrirë në të gjithë territorin e vendit.

Megjithatë koncepti i një fondi social kombëtar për mbështetjen e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel lokal u parashikua që në 2005, legjislacioni i ri i shërbimeve shoqërore krijoi një mjedis të përshtatshëm për ngritjen e tij. Fondi Social është mekanizmi financiar, nëpërmjet të cilit sigurohet mbështetje financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore, me qëllim, përmirësimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror; planifikimin e krijimit të shërbimeve të reja të munguara, si dhe zhvillimin e politikave sociale në nivel qendror dhe vendor.

Zbatimi i legjislacionit të ri të shërbimeve shoqërore kërkon role dhe përgjegjësi të reja dhe një angazhim të të gjithë aktorëve në nivel qendror

dhe lokal. Koordinimi i fuqishëm horizontal midis MSHMS-së dhe ministrive të tjera të linjës, dhe institucioneve në nivel vendor është i domosdoshëm për zbatimin e suksesshëm të reformës në shërbimet e kujdesit social.

3.2 SFIDAT LIDHUR ME SHËRBIMET SHOQËRORE

Sfidat e mëtejshme të politikës lidhen me krijimin e një sistemi funksional të integruar të kujdesit shoqëror të bazuar në parimin e decentralizimit dhe deinstitutionalizimit, për përfshirjen e grupeve vulnerabel në programet e mbrojtjes sociale. Konkretisht:

1. Shndërrimi i shërbimeve rezidenciale në shërbime të kujdesit shoqëror të integruara në komunitet, emergjence, me shërbime alternative etj., në masën më të madhe të mundshme, sipas modeleve të standardeve të reja.

2. Sfidë mbetet plotësimi i të gjitha njësive të vetëqeverisjes vendore me strukturat e shërbimeve sociale/Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit.

3. Aftësimi i strukturave të NJQV-ve për hartimin dhe miratimin e planeve sociale të shërbimeve shoqërore të kostuara në të gjithë njësitë e qeverisjes vendore përbën një tjetër sfidë.

4. Integrimi i shërbimeve në nivel vendor me programe të tjera mbështetëse në arsim, punësim dhe formim profesional për kategoritë në nevojë, duke trajtuar rastin nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Shërbimeve të Kujdesit Social, të integruar me sistemet e tjera kombëtare.

5. Administrimi i procesit të certifikimit të profesionistëve, që punojnë në shërbimet shoqërore, si dhe procesi i licencimit dhe akreditimit të institucioneve publike dhe jo publike, që ofrojnë trajnime dhe edukim të vazhdueshëm, për profesionistët e shërbimeve shoqërore.

6. Vënia në funksionim e një mekanizmi të standardizuar lidhur me prokurimin dhe kontraktimin e OJF-ve dhe sektorit privat për dhënie të shërbimeve.

7. Riorganizimi i shërbimeve inspektuese, si një strukturë e rëndësishme për sigurimin e ofrimit të shërbimeve sociale fëmijëve individëve/familje në nevojë.

¹¹ Vendimi nr. 136, datë 7.3.2018, “Për funksionimin dhe administrimin e regjistrat elektronik kombëtar të shërbimeve të kujdesit shoqëror”.



PJESA II VIZIONI, POLITIKAT DHE QËLLIMET STRATEGJIKE

Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2020–2023 është e ndërtuar mbi parimet që rrjedhin nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, Konventa për të Drejtën e Personave me Aftësi të Kufizuar, Karta Sociale Evropiane e rishikuar, Karta Evropiane e Autonomisë Lokale, Komunikata e Komisionit Evropian, datë 12 Mars 1997, “Mbi modernizimin dhe përmirësimin e Mbrojtjes Shoqërore”, Strategjinë Evropiane deri në 2020.

E drejta për mbrojtjen sociale është reflektuar në Kushtetutën e Shqipërisë. Neni 9 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore njeh të drejtën e secilit për të pasur mbrojtje sociale. Në mënyrë të ngjashme, në Konventat e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve dhe mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara njohin gjithashtu të drejtat e veçanta për mbrojtjen sociale. Zbatimi i suksesshëm i kësaj strategjie do të kontribuojë në përfundimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri.

Parimet janë:

Të drejtat civile, barazia dhe mosdiskriminimi: Mbrojtja sociale ofrohet për çdo individ në nevojë, pavarësisht nga gjinia, feja, mosha, aftësitë e kufizuara etj.

Mbrojtja: Grupe të veçanta, duke përfshirë fëmijët, duhet të jenë subjekt i mbrojtjes së veçantë, bazuar në nevojat dhe të drejtat e tyre.

E drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit: Një mjedis i përshtatshëm duhet të mbështesë zhvillimin maksimal të individëve.

Pavarësia, autonomia dhe respektimi i pikepamjeve: Individët janë përgjegjës për jetën e tyre. Ata duhet të inkurajohen që të marrin vendime për jetën e tyre brenda normave që shoqëria ka vendosur.

Përfshirja dhe integrimi.

Respektimi i të drejtave dhe nevojave.

Partneriteti: koordinimi i strukturave qendrore, qeverisjes rajonale dhe vendore, si dhe partnerë të tjerë në komunitet.

Cilësia e shërbimeve.

Standardet Kombëtare udhëbejnë vendimmarrjen në nivel vendor.

Strategjia ka, gjithashtu, synimin të shërbejë si bazë për dialog të mëtejshëm të strukturuar me Bashkimin Evropian (BE), agjencitë ndërkombëtare dhe partnerët socialë mbi çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes sociale. Një qëllim i rëndësishëm është përputhja me Agjendën Sociale të BE 2020, duke ndihmuar vendin në arritjen e synimeve të saj për integrimin në BE.

2.1 KUADRI LIGJOR NË LIDHJE ME MBROJTJEN SOCIALE

Korniza e përgjithshme ligjore, mbi bazën e të cilës organizohet dhe realizohet mbrojtja, kujdesi dhe integrimi social përbëhet nga:

- Ligji nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”,

- Ligji nr.121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

- Ligji nr. 104/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

- Ligji nr.10107/2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”.

- Ligji nr. 8137/1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (FZ 20-1996).

2.2 VIZIONI

Vizioni i strategjisë: Ndërtimi i një sistemi mbrojtje sociale që të luftojë pabarazitë social-ekonomike, parashikimi i një sistemi që ka politikën dhe mekanizmat për të mbrojtur të gjithë individët në nevojë, ose të përjashtuar nëpërmjet programeve parandaluese dhe riintegritit social alternuar me skemat e punësimit.

**“MBROJTJE SOCIALE NËPËRMJET NJË QASJEJE TË INTEGRUAR”
3 PRIORITETET STRATEGJIKE**



2.3 POLITIKAT DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2020–2023 identifikon qëllimet dhe objektivat e mëposhtëm për realizimin e politikave:

A. Zbutjen dhe lehtësimin e varfërisë, duke mundësuar mbulimin më të mirë të familjeve, fëmijëve dhe individëve të varfër dhe ekstremisht të varfër, duke përmirësuar shënjestrimin e tyre, rritjen e transparencës dhe shmangien e abuzivitetit në skemën e Ndihmës Ekonomike, si dhe lidhjen me skemat e punësimit, me shërbime të integruara me qëllim riintegrimin social të tyre në jetën shoqërore.

Qëllimi: Deri në vitin 2023, të ndikohet në zbutjen e varfërisë ekstreme duke rritur shënjestrimin e individëve, fëmijëve dhe familjeve ekstremisht të varfra, si dhe integrimin social të tyre, duke rritur në 10% pjesën e përfituesve të përfshirë në skemat e punësimit, duke e kthyer nga një skemë pasive në një skemë aktive.

Qëllimet e kësaj politike sektoriale do të synohen të realizohen nëpërmjet përmbushjes së këtyre objektivave:

A1. Rritja e efikasitetit dhe transparencës së skemës së Ndihmës Ekonomike

A2. Konsolidimi i skemës së Ndihmës Ekonomike me anë të miradministrit të regjistrat elektronik kombëtar dhe sistemit të pikëzimit.

A3. Rritja e kapaciteteve të strukturave qendrore, rajonale dhe vendore, në fusha që

përfshijnë administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e skemës së Ndihmës Ekonomike.

A4. Transformimi i programit të Ndihmës Ekonomike në skemë integrimi nëpërmjet krijimit të mundësive për punësim nëpërmjet zbatimit të Programit të daljes nga skema e NE.

B. Zhvillimi i Aftësisë së Kufizuar nëpërmjet vlerësimit biopsikosocial bazuar në standardet ndërkombëtare të klasifikimit të aftësisë së kufizuar, duke ndërthurur skemën e pagesave në para me shërbime të integruara, me qëllim integrimin në jetën shoqërore dhe ekonomike.

Qëllimi “Përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara përmes vlerësimit biopsikosocial, bazuar në standardet ndërkombëtare të klasifikimit të aftësisë së kufizuar, duke kombinuar skemën e përfitimeve në pagesa me shërbimet e integruara, për të arritur integrimin e tyre social dhe ekonomik”.

Qëllimet e kësaj politike sektoriale do të synohen të realizohen nëpërmjet përmbushjes së këtyre objektivave:

B1. Reformimi i sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar për të realizuar vlerësimin biopsikosocial duke ulur me 10% rastet abuzive të përfituesve që nuk shfaqin aftësi të kufizuara brenda viti 2020 dhe duke miradministruar fondin, që shkon për përfitimet në pagesa në masën 17% deri në vitin 2023.

B2. Ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve referuese, vlerësuese dhe monitoruese dhe



koordinimi ndërinstitucional i reformës së sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

B3. Përmirësimi i kuadrit ligjor të vlerësimit biopsikosocial të aftësisë së kufizuar dhe rishikimi i përfitimeve duke kombinuar përfitimet në pagesa me shërbimet e integruara.

B4. Ndërgjegjësimi i publikut, grupeve të interesit dhe aktorëve të përfshirë në zbatimin e reformës përmes fushatave të komunikimit dhe informimit.

B5. Krijimi i një sistemi shërbimesh integruese që kombinon shërbimet e kujdesit social me pagesat në para, duke ofruar një paketë të integruar shërbimesh për personat me aftësi të kufizuara deri në 2023.

C. Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror bazuar në parimet e decentralizimit, deinstitutionalizimit, për përfshirjen e grupeve vulnerabel në programet e mbrojtjes sociale.

Qëllimi: Deri në vitin 2023, çdo burrë, grua, djalë dhe vajzë do të ketë mundësi të barabartë të përfitojë nga një sistem funksional dhe i integruar i shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në parimet e decentralizimit, deinstitutionalizimit dhe diversifikimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Qëllimet e kësaj politike sektoriale do të synohen të realizohen nëpërmjet përmbushjes së këtyre objektivave:

C1. Ngritja e një sistemi të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel kombëtar deri në 2023.

C2. Zhvillimi i sistemit të integruar të informacionit në nivel rajonal dhe qendror, për të identifikuar, referuar nevojat për shërbime të përkujdesjes shoqërore deri në 2023.

C3. Ngritja dhe fuqizimi i sistemit të monitorimit dhe inspektimit të cilësisë së shërbimeve sociale në nivel lokal, rajonal dhe qendror deri në vitin 2023.

C4. Profesionalizimi i forcës së punës dhe ofruesve të shërbimeve shoqërore nëpërmjet krijimit të një sistemi të kualifikimit deri në vitin 2023.

C5. Rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimit publik për parandalimin e problemeve sociale dhe adresimin pranë shërbimeve sociale, nëpërmjet fushatave të komunikimit deri në 2023.

2.4 OBJEKTIVAT E POLITIKËS DHE PRODUKTET MADHORE

Në këtë kapitull bëhet një renditje e objektivave kryesorë të politikës së strategjisë së Mbrojtjes Sociale 2020–2023, sipas qëllimeve strategjike.

A. Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë

Në përputhje me qëllimin e parë strategjik, zbutja e varfërisë është një prioritet kyç i Strategjisë së re. Skema e reformuar e NE-së do të synojë të reduktojë varfërinë (sidomos varfërinë ekstreme), duke siguruar pagesa për ata që janë në nevojë dhe për atë që të jetë e mundur, mbështetjen e njerëzve për të dalë nga varfëria, duke siguruar terrenin për të gjetur mundësitë e riintegritit social dhe ekonomik. Kështu ajo do të synojë të sigurojë asistencë afat-shkurtër për personat në nevojë, ndërkohë që do t'i inkurajojë dhe mbështesë ata për daljen nga skema duke u punësuar etj., por edhe duke pranuar se një përqindje e aplikantëve do të kërkojnë mbështetje afatgjatë.

Produkti për politikën zbutja e varfërisë është transformimi i skemës së Ndihmës Ekonomike, në mënyrë që të shënjestrohen vetëm familjet e prekura nga varfëria dhe mbështetur ato më mirë, për t'u përballur me rreziqet duke hyrë në masat mbrojtëse sociale dhe mundësi më të mira jetese. Objektivat e kësaj politike janë si vijojnë:

A1. Rritja e efikasitetit dhe transparencës së skemës së Ndihmës Ekonomike

Rritja e efikasitetit dhe transparencës së skemës së Ndihmës Ekonomike, do të realizohet nëpërmjet: i. ndjekjes së zbatimit në nivel kombëtar i skemës dhe dinamikës së Ndihmës Ekonomike të reformuar; ii. Vlerësimit të ndikimit të skemës së NE-së dhe formulës së pikëzimit në nivel kombëtar; iii. Plotësimit të kuadrit nënligjor në zbatim të ligjit “Për asistencën sociale në RSH”; iv. Monitorimit financiar të përdorimit të fondit 6% nga ana e NJQV-ve.

Tregues të suksesit të këtij objekti do të jenë konsolidimi i skemës së re të NE-së në nivel kombëtar dhe konsolidimi i kritereve të përfitimit në nivel kombëtar duke rritur transparencën e skemës.

Zhvillimi i një studimi vlerësues mbi ndërthurjen e programit të NE-së me programe të tjera mbështetëse, do të shërbejë për llogaritjen e masës reale të përfitimeve, që familjet përfitojnë realisht nga të gjitha programet e tjera mbështetëse; do të prezantojnë për herë të parë mbështetjen reale që shteti u ofron familjeve përfituese të skemës së NE-së (përfitimet nga skema e NE,



bonueset e bebes, bonuset e qerasë, bursat për të rinjtë që vazhdojnë shkollën e mesme/ të lartë, ndihmat humanitare etj.)

Gjithashtu, hartimi i një raport vlerësimi (studimi) mbi ndikimin e masës së ndihmës ekonomike në përmirësimin e cilësisë së jetesës së familjeve përfituese nga skema e NE-së do të nxisë Ministrinë dhe qeveritë vendore dhe rajonale për identifikimin e masave praktike në mbështetje të familjeve dhe individëve përfitues të Ndihmës Ekonomike, duke garantuar qasje më të mirë të tyre ndaj skemave mbështetëse.

Plotësimi i kuadrit nënligjor në zbatim të ligjit “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” do të përfshijë hartimin, konsultimin e akteve nënligjore, ndjekjen e procedurave për miratim në KM sipas procedurave përkatëse (përfshirë edhe praktikën e përfitimit të ndihmës në natyrë).

Për informimin e komunitetit dhe grupeve të interesit mbi plotësimin e kuadrit nënligjor do të organizohen takime të ndryshme në nivel vendor dhe rajonal.

Një vëmendje më të shtuar strategjia i kushton monitorimit financiar të përdorimit të fondit 6% nga ana e NJQV-ve duke përgatitur raporte analitike mbi procedurën e aplikimit, vlerësimit dhe përfitimit të ndihmës nga ky fond.

A2. Konsolidimi i skemës së Ndihmës Ekonomike me anë të miradministrit të regjistrit elektronik kombëtar dhe sistemit të pikëzimit.

Ky objektivi do të realizohet nëpërmjet kualifikimit të vazhdueshëm të stafit në të gjitha nivelet për të përdorur dhe ushtruar detyrat funksionale me regjistrin elektronik të Ndihmës Ekonomike, si dhe përmirësimit dhe mirëmbajtjes së vazhdueshme të tij.

Regjistri elektronik i Ndihmës Ekonomike do të zhvillohet më tej, me zbatimin/konsolidimin e modulit të kontrollit dhe profilit të riskut, për të zbuluar raste të mundshme abuzimi. Regjistri gjithashtu do të mundësojë monitorimin në kohë reale të skemës dhe do të vlerësojë performancën e saj. Regjistri përfshin module për menaxhimin e integruar dhe një lidhje me sistemin e Thesarit për të mundësuar pagesën e drejtpërdrejtë të individëve dhe familjeve në nevojë. Regjistri do të mundësojë aksesin edhe të institucioneve të tjera sipas rastit.

Modernizimi i skemës është i lidhur me objektivin A1 edhe me realizimin e treguesve lidhur me shënjestrimin, mbulimin dhe transparencën.

A3. Rritja e kapaciteteve të strukturave qendrore, rajonale dhe vendore, në fusha që përfshijnë administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e skemës së Ndihmës Ekonomike.

Do të synohet krijimi dhe rritja e kapaciteteve të strukturave dhe mekanizmave monitorues, vlerësues dhe raportues në të gjitha nivelet. Brenda vitit 2023, institucionet përgjegjëse të skemës së Ndihmës Ekonomike, do të jenë të afta për të administruar, monitoruar dhe vlerësuar procesin, ku një ndër aspektet kryesore do të jetë aftësimi i personelit për instrumentet e reja të skemës së reformuar.

Regjistri elektronik do të mundësojë përmirësimin e sistemit të vlerësimit/monitorimit, raportimit në të gjitha nivelet, ndjekjen e ecurisë së pagesave lidhur me treguesit, si dhe përmirësimin e auditit dhe kontrollit për të reduktuar numrin e abuzimeve, nëpërmjet prodhimit të raporteve tremujore të performancës së skemës për politikbërësit.F

Forcimi i kapaciteteve dhe rritja e ndërgjegjësimit të zyrtarëve përgjegjës do të përmirësojë cilësinë e shërbimeve të kontrollit/auditit. Në mënyrë specifike, do të ndikojnë në zbatimin e metodologjisë së kontrollit të NE, mekanizmave standard të parandalimit dhe zbulimit të mashtrimit në NE, menaxhimin e informacionit dhe mekanizmat e pagesës, marrjen e masave për zhdëmtim dhe penalitetet sipas rastit.

A4. Transformimi i programit të Ndihmës Ekonomike në skemë integrimi nëpërmjet krijimit të mundësive për punësim nëpërmjet zbatimit të programit të daljes nga skema e Ndihmës Ekonomike.

Transformimi i programit të Ndihmës Ekonomike në skemë integrimi do të realizohet nëpërmjet: i. zhvillimit të politikave për Programin e Integritit Social; ii. nxitjes dhe promovimit të Ndërmarrjeve Sociale; iii. vlerësimit të impaktit për familjet e skemës së NE-së nga skema të tjera mbështetëse.

Hartimi, miratimi dhe zbatimi i programit të daljes synon krijimin e lidhjes së qëndrueshme midis skemës së Ndihmës Ekonomike dhe skemave të arsimit profesional dhe programeve të përgatitjes për punësim, ndërmarrjeve sociale,



skemave zhvillimore territoriale, me synim fuqizimin dhe aktivizimin e familjes dhe individit. Programi i daljes dhe ndërthurja me programet e nxitjes së punësimit përbën një tjetër risi, duke lehtësuar procesin e integritit të familjeve dhe individëve të saj drejt tregut të punës.

Forcimi i kapaciteteve në nivelet përgjegjëse drejt qasjeve që nxisin përfituesit e Ndihmës Ekonomike drejt mundësive për punësim dhe integrim përbën një tjetër tregues për realizimin e këtij objekti.

Hartimi dhe miratimi i udhëzuesit për aplikimin për të përfituar statusin e Ndërmarrjes Sociale, sensibilizimi i grupeve të interesit nëpërmjet fushatave informuese mbi risinë “Ndërmarrje Sociale”, asistimi i organizatave që kërkojnë të aplikojnë për të fituar statusin e Ndërmarrjeve Sociale, respektimi i kriterit të punësimit të kategorive në nevojë në ndërmarrjet sociale, ngritja e komisionit të vlerësimit të aplikimeve për njohjen e statusit të ndërmarrjes sociale, dhe procesi i vlerësimit deri në nënshkrimin e kontratave me OJF-të dhe garantimi nga qeveria i kontributit për ndërmarrjet sociale, përbën garanci për mirëfunksionimin e ndërmarrjeve sociale dhe shtimin e vendeve të reja për punësim.

Vlerësimi i impaktit për familjet e skemës së NE-së nga skema të tjera mbështetëse si: bonuse (për kategori të veçanta dhe fëmijët), përfitime nga shërbimet shoqërore (publike dhe jopublike), strehimi (qira, banesa sociale), donacione (pagesa për fëmijët jetimë, mbështetje nga institucionet fetare dhe OJF) etj., do të realizohet nëpërmjet hartimit të një studim vlerësimi, rekomandimet e të cilit do të shërbejnë për përmirësimin e programeve mbështetëse për familjet në nevojë.

B. Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara

Deri më 2022, çdo fëmijë dhe/ose i rritur me aftësi të kufizuara në mënyrë progresive do të kenë qasje dhe do të përfitojnë nga pagesat dhe shërbimet sociale, të cilat janë të një cilësie më të lartë dhe të integruara përmes skemave të Programit të Mbrojtjes Sociale.

Qëllimi i krijimit të një procesi të ri për përcaktimin e aftësisë së kufizuar është: a) të zbatojë një metodologji biopsikosociale për vlerësimin dhe përcaktimin e aftësisë së kufizuar; b) të krijojë një proces të përshtatshëm për çdo moshë; c) të krijojë një proces transparent dhe të

besueshëm; dhe d) të krijojë një proces me kosto efektive. Objektivat e kësaj politike janë si vijojnë:

B1. Reformimi i sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar për të realizuar vlerësimin biopsikosocial duke ulur me 10% rastet abuzive të përfituesve që nuk shfaqin aftësi të kufizuara brenda vitit 2020 dhe duke miradministruar fondin, që shkon për përfitimet në pagesa në masën 17% deri në vitin 2022.

Reformimi i sistemit të vlerësimit përmban këto komponentë a) rishkrimin e kriterëve për vlerësimin e aftësisë për realizimin e detyrave bazë të jetës në përputhje me moshën, b) krijimin e një procesi të ri vlerësimi shumëdisiplinor me disa hallka informacioni e pika verifikimi, c) përdorimin e regjistrat elektronik kombëtar, d) rishikimin e procesit të ankimimit, e) përmirësimin e procesit administrativ për të parandaluar e shmangur abuzimin.

Përfituesit përzgjidhen në bazë të kriterëve të rishikuara të vlerësimit të aftësisë së kufizuar të cilat përfshijnë 2 manuale (një manual për të rritur dhe një manual për fëmijë) që përshkruajnë në mënyrë më të detajuar gjendjet mjekësore që sjellin aftësi të kufizuara, duke mundësuar statistika të hollësishme e të krahasueshme për gjendjen e aftësisë së kufizuar në rang kombëtar dhe përdorimin e sistemit të kodifikimit dhe të cilësorëve të Klasifikimit Ndërkombëtar të Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit për të Rritur dhe Fëmijë.

Procesi i vlerësimit të aftësisë së kufizuar do të realizohet nga komisionet shumëdisiplinore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Fillimisht komisionet u ngritën në Tiranë dhe gradualisht do të ngrihen dhe funksionojnë në të gjithë territorin e vendit.

Skema e aftësisë së kufizuar është më transparente nëpërmjet përdorimit të SMI në qarqet në të cilat do të shtrihet kjo reformë në mënyrë progresive. Regjistri Elektronik i Aftësisë së Kufizuar do të përmirësohet nëpërmjet zgjerimit të funksioneve të monitorimit dhe vlerësimit nga operatori ekonomik.

Ngritja dhe funksionimi paralelisht i komisioneve të vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe komisioneve të shqyrtimit të ankesave do të ndikojë në eliminimin e rasteve abuzive gjatë procesit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, si dhe



do të ofrojë mundësi personave për ankimimin e procesit të vlerësimit dhe rivlerësimit.

Miratimi nga ministri përgjegjës i udhëzimit së bashku me metodologjinë e kontrollit të skemës së reformuar të vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe trajnimi i stafëve të strukturave kontrolluese në nivel qendror e rajonal mbi përdorimin e metodologjisë së re të kontrollit do të rrisë efikasitetin e kontrollit për zbulimin e rasteve abuzive. Nga ana tjetër, e gërshtuar kjo me përdorimin e SMI synohet të ulen rastet e abuzimeve nga përfituesit që nuk shfaqin aftësi të kufizuar.

Si pjesë e përpjekjeve për mirëmenaxhimin e fondeve publike dhe për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të skemës, do të realizohet ristrukturimi i disa pagesave, përfitimeve dhe shërbimeve të aftësisë së kufizuar në përputhje me nevojat e përfituesve. Ky ristrukturim përfshin: a) ristrukturimin e përfitimeve në pagesë; b) ristrukturimin e përfitimit të ndihmës personal; dhe c) kthimin e përfitimeve në përfitime në natyrë.

Masa bazë e përfitimit të aftësisë së kufizuar në pagesë do të lidhet me pensionin social¹². Duke pasur parasysh nevojat e këtij grupi të popullsisë, masa e përfitimit do të jetë 1.5 herë më e lartë se pensioni social (d.m.th. 50% më i lartë se ky i fundit). Do të ketë katër nivele të masës së përfitimeve në para, që lidhen me kategoritë përkatëse të vlerësimit biopsikosocial.

Në përputhje me praktikën bashkëkohore ndërkombëtare dhe kulturën kombëtare shqiptare të përkujdesjes ekonomike për fëmijën nga familja, masa e përfitimit për fëmijët do të jetë 75% e masës së përfitimit përkatës për të rriturit. Familjeve do t'u rekomandohet që kjo pagesë të shkojë kryesisht për mbulimin e kostos së shërbimeve aftësuese. Reduktimi i pagesës, do të shoqërohet me krijimin e shportës së shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara, në kuadrin e reformës së shërbimeve sociale¹³ dhe me masat e marra nga Ministria e

Arsimit, Sportit dhe Rinisë për integrimin e mbështetur të fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha shkollat e vendit, në zbatim të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” (kreu XI- Arsimitimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara).

Rritja e bashkëpunimit me strukturat e Shërbimit Social Shtetëror dhe strukturat e formimit profesional dhe punësimit, është veçanërisht e rëndësishme për të siguruar punësimin me kohë të plotë apo të pjesshme të personave me aftësi të kufizuara. Në këtë kontekst, marrëdhëniet e komisionit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar pranë Shërbimit Social Shtetëror në nivel rajonal me Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit e Formimit Profesional do të fokusohen në shkëmbimin reciprok të informacionit për kërkuesit dhe përfituesit e moshës aktive për punë.

Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit e Formimit Profesional, do të kenë punonjës të veçantë të trajnuar posaçërisht, të cilët do të kenë detyrë bazë, punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë është në procesin e përgatitjes së kuadrit ligjor dhe nënligjor për realizimin e këtyre veprimtarive.

Krahas bashkëpunimit me strukturat publike të punësimit, drejtoritë rajonale të SHSSH/komisionet e vlerësimit të aftësisë së kufizuar do të bashkëpunojnë me strukturat jo publike (p.sh. organizatat jofitimprurëse etj.) të cilat zhvillojnë/ofrojnë hallka të ndryshme të procesit të punësimit si: këshillim profesional, vlerësim të aftësive dhe shprehive për punës, sigurim të vendit të punës, ndihma për punëdhënësin për të punësuar persona me aftësi të kufizuara, trajnim për vendin e punës dhe bashkëpunimin me kolegët etj.

Rritja e bashkëpunimit me strukturat arsimore do të ketë si qëllim shkëmbimin reciprok të informacionit për fëmijët e moshës parashkollore dhe shkollorë, për të realizuar vlerësimin e drejtë të aftësive për kryerjen e veprimtarive bazë të jetës, në përputhje me grup-moshat, si edhe për të siguruar identifikimin dhe plotësimin e nevojave aftësuese të këtyre fëmijëve në kuadrin e sistemit arsimor gjithëpërfshirës e special. Vlerësimi multidisiplinar i fëmijëve për pagesat dhe përfitimet e aftësisë së kufizuar që realizohet nga komisioni, do të jetë i ndryshëm nga vlerësimi për nevojat arsimore, por

¹²Në praktikën bashkëkohore ndërkombëtare, masa e këtij përfitimi varet edhe nga të ardhurat e individit. Kjo nuk mund të realizohet në këtë kohë në kushtet e vendit.

¹³Bazuar në materialin e Dokumentit Fillestar mbi: Paketën Standarde të Shërbimeve të Kujdesit Social, përgatitur në kuadrin e projektit të përbashkët mes UNICEF-SDC-MMSR “Dizenjimi i sistemit qeverisës për planifikim dhe shpërndarje efektive dhe eficiente të shërbimeve të kujdesit social”, zbatuar nga Instituti i Studimeve Bashkëkohore.



me bashkërendim të punës ndërmjet institucioneve, ato do të shndërrohen në vlerësime plotësuese reciproke që do të evitojnë përsëritjet.

Objekti synon që personat përfitues të aftësisë së kufizuar të përfitojnë shërbimin e koordinatorit të mbështetjes nga njësia e vetëqeverisjes vendore, në mënyrë graduale. Në të njëjtën kohë ngritja e funksionimi i shërbimeve të asistencës shtëpiake nga njësia e vetëqeverisjes vendore përbën një mundësi/suport/oportunitet shtesë për individët, fëmijët dhe familjet e tyre.

B2. Ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve referuese, vlerësuese dhe monitoruese dhe koordinimi ndërinstitucional i reformës së sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

Do të ngrihen dhe funksionojnë: i. grupi ndërinstitucional i punës për zbatimin e reformës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar; dhe ii. grupi institucional i miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës, mbi vlerësimin, monitorimin dhe koordinimin e reformës.

Do të synohet fuqizimi i kapaciteteve të strukturave referuese (mjekë familje, mjekë specialist, strukturave vlerësuese (komisioneve shumëdisiplinore të vlerësimit dhe ankimimit) dhe mekanizmave monitorues, vlerësues dhe raportues, përmes trajnimeve të vazhdueshme, trajnimeve në vendin e punës dhe trajnimeve *online* përmes SMI-së, me qëllim që të aftësohen për të realizuar procesin e administrimit, monitorimit dhe vlerësimit. Aspekti kryesor do të jetë aftësimi i personelit për instrumentet e reja të skemës së reformuar.

Do të rriten kapacitetet profesionale të punonjësve që punojnë drejtpërsëdrejti me personat me aftësi të kufizuar, nëpërmjet programeve të edukimit në vazhdim dhe masave të tjera që do të merren si vijon:

- Zhvillimi i përshkrimeve të punës;
- Vlerësimi i kapaciteteve të stafit ekzistues;
- Zhvillimi i kualifikimeve, duke përfshirë module të akredituara;
- Certifikimi i kualifikimeve, duke përfshirë edhe mundësinë e njohjes së atyre të marra paraprakisht.

B3. Vlerësimi i skemës së reformuar të aftësisë së kufizuar

Vlerësimi i pilotimit të aftësisë së kufizuar do të realizohet përmes një studimi të ecurisë së pilotimit të realizuar në njësitë administrative nr. 6 dhe 7 të Bashkisë Tiranë, i cili do të ndihmojë në testimin e

zbatimit të reformës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar sipas modelit biopsikosocial dhe do të ndikojë në vendimarrjen për shtrirjen progresive të skemës së reformuar në nivel kombëtar.

Gjithashtu, vlerësime do të realizohen lidhur me ndërthurjen e programeve të sigurimeve shoqërore me ato të mbrojtjes sociale në fushën e aftësisë së kufizuar, si dhe anketimin e përfituesve të skemës së reformuar të vlerësimit të aftësisë së kufizuar mbi mënyrën se si ka ndikuar skema e re në përmirësimin e cilësisë së jetesës së tyre, si dhe matjen e gjurmimit të gabimeve në përfshirjen dhe përjashtimin nga skema e reformuar.

B4. Ndërgjegjësimi i publikut, grupeve të interesit dhe aktorëve të përfshirë në zbatimin e reformës përmes fushatave të komunikimit dhe informimit.

Do të synohet zhvillimi i fushatave ndërgjegjëse të komunikimit mbi rëndësinë dhe mundësitë e programit të reformuar të aftësisë së kufizuar. Në fushatën e ndërgjegjësimit do të përfshihen edhe referuesit e vlerësuesit e aftësisë së kufizuar, duke përdorur platforma të ndryshme mediatike, si media e shkruar, apo mënyrave të tjera të shpërndarjes së informacionit, për rastet ku individët dhe familjet nuk kanë akses në mediat elektronike apo interneti. Do të përdoren platforma elektronike, ku nëpërmjet internetit do të krijohen portale të posaçme, ose do të përdoren rrjetet sociale me qëllim promovimin e sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Do të realizohen takime me qytetarë, grupe të interesit dhe organizata të shoqërisë civile për të komunikuar vizionin, qëllimin dhe efektet e pritshme të reformës. Do të shpërndahen informacione edhe përmes posterave, broshurave, fletëpalosjeve, spoteve etj.

B5. Përmirësimi i kuadrit ligjor të vlerësimit biopsikosocial të aftësisë së kufizuar dhe rishikimi i përfitimeve duke kombinuar përfitimet në pagesa me shërbimet e integruara.

Ndryshimet në legjislacionin në fuqi do të realizohen fillimisht përmes amendimit të kuadrit ligjor ekzistues, deri në vitin 2021, për të krijuar hapësirat ligjore për zbatimin e skemës së reformuar dhe paralelisht duke lejuar hapësirat e zbatimit të skemës ekzistuese në qarqet ku nuk do të implementohet kjo reformë, duke bërë kujdes që të mos krijohet mbivendosje në legjislacion.



Paketa e re ligjore për zbatimin e vlerësimit biopsikosocial të aftësisë së kufizuar, që do të zbatohet në rang vendi, kur të jetë realizuar shtrirja progresive deri në vitin 2024, do të reflektojë kombinimin e përfitimeve të pagesave me shërbimet e integruara.

Forcimi i bashkëpunimit me strukturat e arsimit, formimit profesional, punësimit, si dhe me shërbimet shëndetësore, psikosociale, integruese, rehabilituese etj. do të koordinojë përpjekjet për të krijuar një rrjet mbështetjeje për personat me aftësi të kufizuara. Po ashtu, bashkëpunimi me organizatat që ofrojnë shërbime psikosociale do të ketë të bëjë me rekomandime për shërbime për individët pranë këtyre organizatave, shkëmbimin e informacionit lidhur me vlerësimin, si edhe marrjen e informacionit nga këto ofrues shërbimesh për përfituesit.

C. Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror

Nëpërmjet politikave të mëposhtme dhe objektivave strategjikë për zhvillimin e shërbimeve të kujdesit social, produkti që synohet deri më 2023 është që çdo burrë, grua, djalë dhe vajzë do të ketë mundësi të barabartë të përfitojë nga një sistem funksional dhe i integruar i shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në parimet e decentralizimit, deinstitutionalizimit dhe diversifikimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Objektivat e kësaj politike janë si vijojnë:

C1. Ngritja e një sistemi të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel kombëtar deri në 2023

Objektivi do të realizohet nëpërmjet: i. Plotësimit dhe qartësimit të politikave që përcaktojnë reformën e programit të shërbimeve të kujdesit shoqëror; ii. Plotësimit të akteve nënligjore që do të hapin rrugën për zbatimin e reformës; iii. Përmirësimit të kuadrit institucional për strukturat përgjegjëse për programin e kujdesit shoqëror; iv. Krijimit të instrumenteve për hartimin dhe monitorimin e Planeve sociale vendore; v) Hartimit të instrumenteve si pjesë e kuadrit rregullator në ndihmë të autoriteteve rajonale/vendore; vi. Zbatimit të Fondit Social për të mbështetur kujdesin shoqëror përmes shërbimeve të reja dhe novatore; vii. Miratimit dhe zbatimit të Planit të deinstitutionalizimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror; viii. Krijimit të një rrjeti të kujdesit alternativ; ix. Shërbimeve të integruara në nivel

vendor me programe të tjera mbështetëse në shëndetësi, arsim, punësim dhe formim profesional në përputhje me planet sociale vendore.

Sa më sipër synohet të ngrihen sisteme funksionale të integruara të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe shëndetësorë në njësitë e qeverisjes vendore. Pranë çdo njësie të qeverisjes vendore do të ngrihen strukturat/njësitë e vlerësimit të nevojave dhe referimit për shërbime shoqërore në nivel vendor, si pjesë qendrore e drejtorive të mbrojtjes sociale, të cilat kanë detyrimin ligjor të hartojnë planet sociale vendore. Tërësia e planeve sociale vendore të zhvilluara në nivel lokal sipas përcaktimeve të ligjit të ri të shërbimeve sociale dhe integrimi i tyre do të përbëjë bazën për hartimin e hartës së shërbimeve shoqërore në shkallë kombëtare.

Përmirësimi i kuadrit institucional për strukturat përgjegjëse për programet e kujdesit shoqëror do të fokusohet në forcimin e strukturave përgjegjëse për kujdesin shoqëror në nivel kombëtar dhe rajonal, në monitorimin e ngritjes dhe fuqizimit të strukturave përgjegjëse në nivel vendor, hartimin e protokolleve të punës dhe ndjekja e zbatimit të tyre, si dhe hartimin e programeve afatgjata për ngritjen e kapaciteteve.

Aktualisht, MSHMS-ja ka miratuar Shportën Bazë të Shërbimeve Shoqërore, shërbime të cilat duhen kostuar. Vëmendje do t'i kushtohet analizës së standardeve ekzistuese të shërbimeve të kujdesit social, si dhe do të hartohen standardet e reja për shërbimet e reja.

Plotësimi i kuadrit ligjor për zbatimin e Fondit Social nëpërmjet mekanizmave të financimit, vetë financimi dhe mbështetja e NJQV për t'i përthithur dhe përfituar nga këto fonde do të garantojnë funksionimin e procesit të deinstitutionalizimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Financimi i shërbimeve të kujdesit social mund të përfshijnë fonde nga buxheti qendror i shtetit, fondet e planifikuara nga taksat dhe tarifat vendore, të ardhurat nga pronat dhe aktivitetet e tjera të bashkive, dhurimet, sponsorizimet dhe financime të tjera nga partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë, organizata, persona fizikë ose juridikë apo individë.

Miratimi i mekanizmave të financimit të Fondit Social bën të mundur, që çdo bashki të ngrejë shërbime shoqërore në territor për grupet në nevojë, duke u mbështetur financiarisht nga ky



fond në mënyrë të vazhdueshme gjatë tri vjetëve të parë për shërbimet e reja të ngritura (në vitin e parë me 90% të financimit, në vitin e dytë me 60% të financimit dhe në vitin e tretë 30% të financimit).

Shërbimet do të mund të kontraktohen nga organizatat jo-fitimprurëse apo ofrues të tjerë të shërbimeve. Kjo do të zvogëlonte kostot e ngritjes dhe do të lejonte fleksibilitet në ofrimin e shërbimit.

Ndërthurja e ofrimit të shërbimeve shoqërore me skema alternative punësimi, do të mundësohet nëpërmjet zhvillimit të dialogut dhe bashkëpunimit midis agjencive dhe aktorëve në nivel vendor për përfshirjen e kategorive në nevojë në skemat e punësimit, formimit profesional dhe ngritjen e ndërmarrjeve sociale.

C2. Zhvillimi i sistemit të integruar të informacionit në nivel rajonal dhe qendror, për të identifikuar, referuar nevojat për shërbime të përkujdesjes shoqërore deri në vitin 2023

Për arritjen e këtij objekti, strategjia përcakton ngritjen dhe mirëfunksionimin e Sistemit MIS të shërbimeve sociale, si pjesë e sistemit të integruar MIS të mbrojtjes sociale, duke e shtrirë atë në të 61 bashkitë.

Në nivel vendor do të ngrihet dhe funksionojë një strukturë e posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe/ose njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit. Struktura/Njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit janë përgjegjëse për: a) identifikimin e nevojave për shërbime shoqërore; b) vlerësojë nevojat në bazë të hartës së vulnerabilitetit; c) hartimin e planit social vendor të kostuar; d) planifikimin e shportës bazë të shërbimeve shoqërore; e) kontraktimin e ofruesit të shërbimeve të kujdesit shoqëror me anë të procedurave të prokurimit, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik; f) grumbullimin dhe hartimin e informacioneve, statistikave dhe mbajnë regjistrin e përfituesve; g) grumbullimin e informacioneve për rrjetet e shërbimeve publike dhe jopublike që veprojnë në territorin e bashkisë.

Ngritja e kapaciteteve për personelin përgjegjës vendor dhe atë të SHSSH-së rajonal, për përdorimin e sistemit të integruar të informacionit dhe asistimin e NJQV-ve nga SHSSH rajonal, do të përmirësojë koordinimin midis aktorëve të ndryshëm në nivel lokal dhe qendror, si dhe do të mundësojë monitorimin e shërbimeve të

përkujdesjes shoqërore që ofrohen për kategoritë në nevojë.

Strategjia parashikon edhe kryerjen e një studimi fizibiliteti, që sistemet specifike ekzistuese të informacionit në nivel vendor/rajonal (baza e të dhënave të CPU-ve, baza e të dhënave të dhunës në familje, Romalb etj.) të integrohen me MIS.

E gjithë kjo do t'i shërbejë konsolidimit dhe zhvillimit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit dhe i një baze të dhënash të integruara për përfituesit e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore dhe integrimi i tij me sistemet e tjera të menaxhimit të informacionit për përfituesit e NE, PAK, në të gjitha nivelet.

C3. Ngritja dhe fuqizimi i sistemit të monitorimit dhe inspektimit të cilësisë së shërbimeve sociale në nivel lokal, rajonal dhe qendror deri në vitin 2023.

Do të analizohet mundësia për riorganizimin e strukturave të reja të inspektimit, duke qartësuar varësinë funksionale, rritjen në numër të burimeve njerëzore, si dhe rritjen e kapaciteteve të këtyre të fundit. Do të synohet përmirësimi dhe forcimi i mekanizmave të monitorimit dhe inspektimit për rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara në nivel vendor, rajonal dhe qendror nëpërmjet zhvillimit të një metodologjie të re të inspektimit.

Prioritet përbën forcimi i kapaciteteve profesionale për rritjen e efikasitetit të inspektimeve duke përcaktuar role qartësisht të ndara midis SHSSH-së dhe inspektoratit.

C4. Profesionalizimi i forcës së punës dhe ofruesve të shërbimeve shoqërore nëpërmjet krijimit të një sistemi të kualifikimit deri në vitin 2023.

Krijimi i një force pune për një sistem të shërbimeve sociale është sfida kryesore e kësaj strategjie. Ndërkohë që vizioni afatgjatë është forcimi i të gjitha institucioneve që merren me trajnimin dhe përgatitjen e forcës së punës, fokusi në harkun kohor të kësaj strategjie do të jetë:

- Krijimi i “Programit të certifikimit për profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror, ngritja e Bordit të Edukimit të Vazhdueshëm, hartimi i programeve të edukimit dhe monitorimi i tyre përbëjnë garancinë që propozon strategjia për realizimin e objektivit.

Rritja e kapaciteteve profesionale të punonjësve që punojnë drejtpërsëdrejti në shërbimet shoqërore nëpërmjet programeve të edukimit në vazhdim dhe



masave të tjera përfshin: i. hartimin e instrumenteve përkatës që lidhen me detyrimet dhe përshtatjen e punës sipas shërbimit dhe rolit; ii. Zhvillimin e kualifikimeve, duke përfshirë module në nivel universitar; iii. Certifikimin e kualifikimeve, duke përfshirë edhe mundësinë e njohjes së atyre të marra paraprakisht.

MSHMS gjithashtu angazhohet për të ngritur urdhrin e punonjësit social.

C5. Rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimit publik për parandalimin e problemeve sociale dhe adresimin pranë shërbimeve sociale, nëpërmjet fushatave të komunikimit deri në 2023.

Do të synohet zhvillimi i fushatave ndërgjegjëse mbi rëndësinë dhe mundësitë e programit të mbrojtjes shoqërore. Në fushatën e ndërgjegjësimit do të përfshihen edhe ofruesit e shërbimeve, duke përdorur platforma të ndryshme mediatike, si media e shkruar apo mënyrave të tjera të shpërndarjes së informacionit, për rastet ku individët dhe familjet nuk kanë akses në mediat elektronike apo interneti. Do të përdoren platforma elektronike, ku nëpërmjet internetit do të krijohen portale të posaçme ose do të përdoren rrjetet sociale me qëllim promovimin e sistemit të shërbimeve shoqërore. Synimi kryesor do të jetë të rrisë besimin e familjeve, fëmijëve dhe komuniteteve tek roli i punonjësit social dhe shërbimeve shoqërore.

PJESA III

MONITORIMI DHE LLOGARIDHËNIA

Monitorimi i Planit të Veprimit mbi Moshimin do të drejtohet nga grupi tematik për përfshirjen sociale, brenda strukturës së grupit për menaxhimin e integruar të politikave (GMIP) të miratuar me urdhrin e kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”.

Grupi i Treguesve dhe Integritetit të Statistikave (GTIS), do të bashkërendojë aktivitetin monitorues me Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

I gjithë procesi do të kryhet me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga institucionet kryesore kombëtare

përgjegjëse për mbrojtjen sociale (përfshirë Shërbimin Social Shtetëror), arsimin, strehimin, të drejtat e njeriut, institucionet e qeverisjes vendore, INSTAT, shoqëria civile, (përfaqësues të organizatave joqeveritare).

Draftet e raporteve, çdo dyvjeçar të monitorimit, do të përgatiten në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe do të miratohen nga GMIP.

Për garantimin e zhvillimit dhe zbatimit të objektivave strategjikë të mbrojtjes sociale (referuar në këtë strategji) do të:

- monitorohen treguesit e përcaktuar në strategji;

- rekomandohen ndryshime në programet sektoriale, duke pasur parasysh arritjet, rrethanat (të kihet parasysh këtu risqe dhe rreziqe) dhe eksperiencat e mëparshme, si dhe në përputhje me rekomandimet e progres raporteve të Bashkimit Evropian;

- sigurohen konsultime me palët e interesit, përfshirë shpërndarjen sistematike të informacionit për publikun;

- jepet kontribut në rritjen e konsistencës dhe integritetit të politikave dhe masave të mbrojtjes sociale në të gjitha nivelet e administrimit, si dhe në përdorimin më të mirë të burimeve.

Monitorimi do të kryhet çdo vit dhe raportet e monitorimit dhe vlerësimit do të hartohen dhe miratohen në afate 1-vjeçare.

Përmirësimet në sistemin e monitorimit dhe vlerësimit synojnë të lehtësojnë/ndihmojnë në përafrimin e kuadrit strategjik dhe prioritetëve në fusha të ndryshme dhe të informojnë për politikat e vendit të lidhura me mbrojtjen sociale.

Fuqizimi dhe zgjerimi i kuadrit statistikor do të lehtësojë hartimin e politikave bazuar në evidenca/ të dhëna, si dhe do të mundësojë vlerësimin objektiv për përmbushjen e objektivave.

Përveç këtij monitorimi të vazhdueshëm, progresi në arritjen e qëllimeve të Strategjisë së Mbrojtjes Sociale do të matet nëpërmjet dy ushtrimeve të vlerësimit, si më poshtë:

- Një vlerësim afatmesëm, që do të zhvillohet në fund të vitit 2021, do të analizojë rezultatet e arritura, menaxhimin e burimeve dhe cilësinë e zbatimit. Kjo analizë do të tregojë për ndryshimet në kontekstin e përgjithshëm ekonomik dhe social, do të vlerësojë nëse qëllimet janë të qenësishme,



duke krahasuar kontekstin fillestar dhe do të identifikojë veprimet e nevojshme. Bazuar në këtë vlerësim, mund të rishikohen një herë në dy vjet aktivitetet e planit të veprimit për të arritur objektivat e vendosur në strategji, proces i cili do të sjellë dhe rishikimin e strategjisë.

Grupi Ndërmnistror i punës për zbatimin e reformës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar, dhe grupi institucional i miratuar me Urdhër të Ministrisë përgjegjës për çështjet sociale, mbi vlerësimin, monitorimin dhe koordinimin e reformës do të raportojë periodikisht sipas afateve të përcaktuara më sipër, lidhur me zbatimin e reformës së aftësisë së kufizuar.

- Një vlerësim përfundimtar, pas përfundimit të periudhës së zbatimit, do të analizojë të gjithë strategjinë dhe ndikimin e saj të përgjithshëm. Do të vlerësohen rezultatet e masave të ndërmarra, burimeve të investuara dhe masën në të cilën janë arritur efektet e pritura. Vlerësimi përfundimtar do të kryhet duke analizuar të dhënat nga burime të ndryshme, duke përfshirë edhe gjetjet e monitorimit të performancës dhe vlerësimit të ndikimit të programeve aktive të tregut të punës.

Të dhënat administrative për ndihmën ekonomike, aftësinë e kufizuar dhe shërbimet e përkujdesjes shoqërore, do të gjenerohen nga regjistrat përkatës elektronikë (ose informacion në rrugë administrative), si për numrin e përfituesve, ashtu dhe për rastet abuzive të evidentuara. Po në këtë kuadër do të shërbejnë edhe raportet e vlerësimit të impaktit.

PJESA IV BURIMET FINANCIARE

Kostoja e përgjithshme e përlogaritur për zbatimin e masave administrative të kësaj strategjie dhe të planit të veprimit është rreth 24,840,407,000 lekë. Burimet e përcaktuara për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për programin buxhetor “Përkujdesjes Sociale” mbulojnë rreth

91% të koston së përlogaritur për këtë strategji. Kostoja financiare e mbuluar nga buxheti i miratuar i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për çdo vit buxhetor përkatës, është e përfshirë brenda parashikimeve të tavanave të shpenzimeve buxhetore për periudhën afatmesme e më tej. Nevojat për fonde për periudhën 2020–2023 janë programuar në përputhje me kuotat tavan të projektbuxhetit afatmesëm (PBA 2020–2022). Burimet financiare nga donatorët mbulojnë rreth 0,31% të koston së strategjisë, përkatësisht rreth 78,228,000 lekë nga Banka Botërore dhe nga donatorë. Hendeku financiar i pambuluar në buxhet prej 8,6 %, është pjesë e bisedimeve me donatorët dhe përbëhet kryesisht nga kosto për aktivitete plotësuese.

Kostimi i Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë është realizuar bazuar në metodologjitë dhe praktikën e planifikimit buxhetor, më konkretisht duke konsideruar shpenzimet e projekteve të trupëzuara në produkte dhe ato jashtë projekteve. Një metodologji e tillë është në përputhje me sistemin e planifikimit buxhetor afatmesëm në Republikën e Shqipërisë sikurse parashikohet në ligjin organik të buxhetit të shtetit dhe në udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Kostimi dhe buxhetimi i planit të veprimit të kësaj strategjie është mbështetur në elementet si më poshtë vijon:

- Kostot për zbatimin e strategjisë konsiderojnë jo vetëm shpenzimet kapitale, por edhe ato korente të cilat, edhe pse janë me peshë të ulët, janë konsideruar për garantimin e kapaciteteve të nevojshme për implementimin e strategjisë.

- Kostot e financuara nga donatorët janë konsideruar si shpenzime kapitale edhe për rastet (kualifikime, fushata komunikimi, seminare dhe konferenca etj.), në përputhje me udhëzimet përkatëse të MFE.



Politikat sektoriale Objektivat	A. Buxheti nevojshëm (në mijë lek)	B. Buxheti Shtetit i planifikuar (në mijë lek)	C. Donatorë (në mijë lek)	D. Hendek financiar (në mijë lek) D=A-(B+C)
A. Zbutjen dhe lehtësimin e varfërisë	17,050,668	17,001,041	7,128	42,500
A1. Rritja e efikasitetit dhe transparencës së skemës së Ndhmës Ekonomike	16,335,518	16,309,758	1,760	24,000
A2. Konsolidimi i skemës së Ndhmës Ekonomike me anë të mirad Ministrimit të regjistrat elektronik kombëtar dhe sistemit të pikëzimit	41,174	41,174		
A3. Rritja e kapaciteteve të strukturave qendrore, rajonale dhe vendore, në fusha që përfshijnë administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e skemës së Ndhmës Ekonomike.	37,811	37,811		
A4. Transformimi i programit të Ndhmës Ekonomike në skemë integrimi nëpërmjet krijimit të mundësive për punësim nëpërmjet zbatimit të Programit të daljes nga skema e NE.	636,164	612,297	5,368	18,500
B. Zhvillimi i aftësisë së kufizuar nëpërmjet vlerësimit biopsikosocial bazuar në standardet ndërkombëtare të klasifikimit të aftësisë së kufizuar, duke ndërthurur skemën e pagesave në para me shërbime të integruara, me qëllim integrimin në jetën shoqërore dhe ekonomike.	1,935,788	1,687,598	31,910	216,280
B1. Reformimi i sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar për të realizuar vlerësimin biopsikosocial duke ulur me 10% rastet abuzive të përfituesve që nuk shfaqin aftësi të kufizuara deri në vitin 2020, dhe duke mirad Ministruar fondin që shkon për përfitimet në pagesa në masën 17% deri në vitin 2022.	1,903,678	1,687,498	-	216,180
B2. Ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve referuese, vlerësuese dhe monitoruese dhe koordinimi ndërinstitucional i reformës së sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar.	2,010	100	1,910	-
B3. Vlerësimi i skemës së reformuar të aftësisë së kufizuar.	23,600		23,500	100
B4. Ndërgjegjësimi i publikut, grupeve të interesit dhe aktorëve të përfshirë në zbatimin e reformës përmes fushatave të komunikimit dhe informimit.	6,500		6,500	



B5. Përmirësimi i kuadrit ligjor të vlerësimit biopsikosocial të aftësisë së kufizuar dhe rishikimi i përfitimeve duke kombinuar përfitimet në pagesa me shërbimet e integruara.	18,650	3,472	15,178	
C. Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në parimet e decentralizimit, deinstitutionalizimit, për përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet e mbrojtjes sociale	5,853,951	3,945,207	39,190	1,869,554
C1. Ngritja e një sistemi të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel kombëtar deri në 2023.	2,474,769	1,010,524	13,390	1,450,854
C2. Zhvillimi i sistemit të integruar të informacionit në nivel rajonal dhe qendror, për të identifikuar, referuar nevojat për shërbime të përkujdesjes shoqërore deri në 2023.	2,825,800	2,422,900	12,900	390,000
C3. Ngritja dhe fuqizimi i sistemit të monitorimit dhe inspektimit të cilësisë së shërbimeve sociale në nivel lokal, rajonal dhe qendror deri në vitin 2023.	407,595	406,695		900
C4. Profesionalizimi i forcës së punës dhe ofruesve të shërbimeve shoqërore nëpërmjet krijimit të një sistemi të kualifikimit deri në vitin 2023.	75,155	56,355		18,800
C5. Rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimit publik për parandalimin e problemeve sociale dhe adresimin pranë shërbimeve sociale, nëpërmjet fushatave të komunikimit deri në 2023.	70,632	48,732	12,900	9,000
Totali	24,840,407	22,633,846	78,228	2,128,334



TABELA 2

PLANI I VEPRIMIT NË ZBATIM TË DOKUMENTIT STRATEGJIK (2020–2023)
I. Qëllimi strategjik "Konsolidimi i mbrojtjes shoqërore"
I. Qëllimi i Politikës: "Deri në vitin 2023, të ndikohet në zbatimin e varfërisë ekstreme duke rritur shënjestrimin e individëve dhe familjeve ekstremisht të varfra, ashtu si dhe rintegrimin social të tyre duke rritur në 10% pjesën e përfutësve të përfshirë në skemat e punësimit, duke e kthyer nga një skemë pasive në një skemë aktive"
III. Programi buxhetor: Programi buxhetor i MSHMS-së "Përkujdesja Sociale"

Nr.		Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		TOTAL 2020–2023			VITI 2020			VITI 2021			VITI 2022			VITI 2023			Hende ku financohet (në mijë lekë)				
						Kosto indikative (në mijë lekë)	Burimi i mbulimit		Hende ku financohet (në mijë lekë)	Kosto indikative (në mijë lekë)	Burimi i mbulimit		Hende ku financohet (në mijë lekë)	Kosto indikative (në mijë lekë)	Burimi i mbulimit		Hende ku financohet (në mijë lekë)	Kosto indikative (në mijë lekë)	Burimi i mbulimit						
		Institucionin përgjegjës (Udhëheqës)	Institucion kontribues	Afati Fillimit	Afati Mbarimit		Buxhet Shteti (në mijë lekë)	Financimi i Huaj (në mijë lekë)			Buxhet Shteti (në mijë lekë)	Financimi i Huaj (në mijë lekë)			Buxhet Shteti (në mijë lekë)	Financimi i Huaj (në mijë lekë)			Buxhet Shteti (në mijë lekë)	Financimi i Huaj (në mijë lekë)					
A.	OBJEKTIVI SPECIFIK A: ZBUTJA DHE LEHTËSIMI I VARFËRISË	MSHMS	MSHMS	3 Muji III , 2020	3 Muji IV, 2023	17,050,668	17,001,041	7,128	42,500	2,383,440	2,374,193	6,248	3,000	4,864,577	4,836,197	880	27,500	4,882,609	4,870,609	-	12,000	4,920,042	4,920,042	-	-
A.1	Rritja e efikasitetit dhe transparencës së skemës të Ndihmës Ekonomike	MSHMS/SHSH S/DRSHS	MSHMS/SHSHS/DRSHS	3 Muji III , 2020	3 Muji IV, 2023	16,335,518	16,309,758	1,760	24,000	2,355,119	2,354,239	880	-	4,682,170	4,669,290	880	12,000	4,655,398	4,643,398	-	12,000	4,642,830	4,642,830	-	-
	1.1 Zbatimi në nivel kombëtar i skemës dhe dinamika e Ndihmës Ekonomike të reformuar	MSHMS/SHSHS H.DRSHS	MSHMS/SHSSH.DRSHS	3 Muji III , 2020	3 Muji IV, 2023	16,216,357	16,216,357	-	-	2,331,899	2,331,899	-	-	4,628,152	4,628,152	-	-	4,628,152	4,628,152	-	-	4,628,152	4,628,152	-	-
	1.2 Vlerësimi i ndikimit të skemës së NE dhe formulës së pikëzimit në nivel kombëtar	MSHMS	MSHMS	3 Muji III , 2020	3 Muji IV, 2023	30,369	4,609	1,760	24,000	880	-	880	-	12,880	-	880	12,000	14,304	2,304	-	12,000	2,304	2,304	-	-
	1.3 Përgatitja e kuadrit nënligjor në zbatim të ligjit "Për asistencën Sociale në RSH"	MSHMS/SHSHS H.DRSHS	MSHMS/SHSSH.DRSHS	3 Muji III , 2020	3 Muji IV, 2023	76,894	76,894	-	0	19,365	19,365	-	-	38,163	38,163	-	0	9,966	9,966	-	-	9,399	9,399	-	-
	1.4 Monitorimi financiar i përdorimit të fondit 6% nga ana e NJV .	MSHMS/SHSHS H.DRSHS	MSHMS/SHSSH.DRSHS	3 Muji III , 2020	3 Muji IV, 2023	11,898	11,898	-	-	2,975	2,975	-	-	2,975	2,975	-	-	2,975	2,975	-	-	2,975	2,975	-	-
A.2	Konsolidimi i skemës së Ndihmës Ekonomike me anë të mirëadministrimit të regjistrit elektronik kombëtar dhe sistemit të pikëzimit	MSHMS/DRSHS	MSHMS/DRSHS	3 Muji III , 2020	3 Muji IV, 2023	41,174	41,174	-	-	6,139	6,139	-	-	11,678	11,678	-	-	11,678	11,678	-	-	11,678	11,678	-	-
	A.2.1 Mirëmbajtja dhe përmirësimi i regjistrit elektronik kombëtar	MSHMS/DRSHS	MSHMS/DRSHS	3 Muji III , 2020	3 Muji IV, 2023	41,174	41,174	-	-	6,139	6,139	-	-	11,678	11,678	-	-	11,678	11,678	-	-	11,678	11,678	-	-
A.3	Rritja e kapaciteteve të strukturave qendrore, rajonale dhe vendore, në	MSHMS/SHSHS H.DRSHS	MSHMS/SHSSH.DRSHS	3 Muji II , 2020	3 Muji IV, 2023	37,811	37,811	-	-	4,225	4,225	-	-	4,225	4,225	-	-	14,680	14,680	-	-	14,680	14,680	-	-



	fusha që përfshijnë administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e skemës së Ndihmës Ekonomike																								
	A.3.1 Krijimi dhe rritja e kapaciteteve të strukturave dhe mekanizmave monitorues, vlerësues dhe raportues në të gjitha nivelet (MSHMS, SHSSH rajonale).	MSHMS/SHSS H.DRSHS	MSHMS/SH SSH.DRSH S	3 Mujori II , 2020	3 Mujori IV, 2023	20,910	20,910	-	-	-	-	-	-	-	-	-	10,455	10,455	-	-	10,455	10,455	-	-	
	A.3.2 Përmirësimi i sistemit të vlerësimit/monit orimit, raportimit në të gjitha nivelet dhe përmirësimin e auditit dhe kontrollit për të reduktuar numrin e abuzimeve	MSHMS/SHSS H.DRSHS	MSHMS/SH SSH.DRSH S	3 Mujori II , 2020	3 Mujori IV, 2023	16,902	16,902	-	-	4,225	4,225	-	-	4,225	4,225	-	-	4,225	4,225	-	-	4,225	4,225	-	-
A.4	Transformimi i programit të Ndihmës Ekonomike në skemë integrimi nëpërmjet krijimit të mundësive për punësim nëpërmjet zbatimit të Programit të daljes nga skema e NE	MSHMS	SHSSH/DR SHS	3 Mujori III , 2020	3 Mujori IV, 2023	636,164	612,297	5,368	18,500	17,957	9,589	5,368	3,000	166,503	151,003	-	15,500	200,853	200,853	-	-	250,853	250,853	-	-
	A.4.1 Zhvillimi i politikave për Programin e Integritimit Social.	MSHMS/SHSS H.DRSHS	MSHMS/SH SSH.DRSH S	3 Mujori III , 2020	3 Mujori IV, 2023	7,070	1,702	5,368	-	5,368	-	5,368	-	567	567	-	-	567	567	-	-	567	567	-	-
	A.4.2 Ndërmarrjet sociale	MSHMS	MSHMS	3 Mujori III , 2020	3 Mujori IV, 2023	616,444	610,444	-	6,000	12,589	9,589	-	3,000	153,285	150,285	-	3,000	200,285	200,285	-	-	250,285	250,285	-	-
	A.4.3 Vlerësimi i impaktit për familjet e skemës së NE nga skema të tjera mbështetëse si: bonuse(për kategori të veçanta dhe fëmijët), përfitime nga shërbimet shoqërore (publike dhe jopublike), strehimi (qira, banesa sociale), donacione (pagesa për fëmijët jetimë, mbështetje nga institucionet fetare dhe OJF) etj.	MSHMS/SHSS H.	DRSHSSH	3 Mujori III , 2020	3 Mujori IV, 2023	12,650	150	-	12,500	-	-	-	-	12,650	150	-	12,500	-	-	-	-	-	-	-	-



TABELA 1

PLANI I VEPRIMIT NË ZBATIM TË DOKUMENTIT STRATEGJIK (2020–2023)																									
i. Qëllimi strategjik: “Konsolidimi i mbrojtjes shoqërore”																									
ii. Qëllimi i Përfundimtar: “Përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara përmes vlerësimit biopsikosocial, bazuar në standardet ndërkombëtare të klasifikimit të aftësisë së kufizuar, duke kombinuar shërbimet e përfundimtare të pagesave me shërbimet e integruara, për të arritur integritetin e tyre social dhe ekonomik”																									
iii. Programi buxhetor: Programi buxhetor i MSHMS-së “Përkrahja Sociale”																									
Nr.		Institucionet përkrahëse		Aftësi i zbatimit		Kosto indikative (në mijë lek)	Burimi i rrobullimit		Hendeku financiar (në mijë lek)	VITI 2020			VITI 2021			VITI 2022			VITI 2023						
		Shërbim institucionel përkrahës (Udhëheqës)	Institucion korrumbas (nëse ka)	Aftësi i fillimit	Aftësi i mbarimit		Buxhet Shërb (në mijë lek)	Financi m i Huaj (në mijë lek)		Kosto indikative (në mijë lek) VITI 2020	Buxhet Shërb (në mijë lek)	Financi m i Huaj (në mijë lek)	Hendeku financiar (në mijë lek)	Kosto indikative (në mijë lek) VITI 2021	Buxhet Shërb (në mijë lek)	Financi m i Huaj (në mijë lek)	Hendeku financiar (në mijë lek)	Kosto indikative (në mijë lek) VITI 2022	Buxhet Shërb (në mijë lek)	Financi m i Huaj (në mijë lek)	Hendeku financiar (në mijë lek)	Kosto indikative (në mijë lek) VITI 2023	Buxhet Shërb (në mijë lek)	Financi m i Huaj (në mijë lek)	Hendeku financiar (në mijë lek)
Totali Objektivi B						1,935,788	1,687,598	31,910	216,280	495,984	489,262	542	6,180	490,707	423,391	4,217	63,100	498,649	386,644	23,805	88,200	450,447	388,301	3,347	58,800
B.1	OBJEKTIVI SPECIFIK: Reformimi i sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar për të realizuar vlerësimin biopsikosocial duke ulur me 10% numrin absolut të përfundimeve që nuk shfaqin aftësi të kufizuara deri në vitin 2020, dhe duke miratuar/ndërtuar fondin që shkon për përfundimet në pagesa në masën 17% deri në vitin 2023.	MSHMS	SHSSH, AKSHI, SHRP, FSDKSHI, NJQV, AFP, DAR, DAP	3-majori IV, 2020	3-majori IV, 2022	1,903,678	1,687,498	-	216,180	495,442	489,262	-	6,180	486,356	423,356	-	63,000	474,809	386,609	-	88,200	447,071	388,271	-	58,800
1.1	Përfundimtar përparësia në bazë të lartësive të ndaluar të vlerësimit të aftësisë së kufizuar të cilat përshpesh 2 muajve (në manual për të mirë dhe në manual për formë) që përkrahësit në mënyrë të shpejtë gjenden meqenëse që qyteti aftësi të kufizuar, duke marrë parasysh statistika të bërësishme e të bërësishme për gjendjen e aftësisë së kufizuar në rang kombëtar dhe përdorimin e sistemit të lartësimit dhe të cilësive të klasifikimit Ndërkombëtar të Aftësisë së Kufizuar dhe Shërbimit për të Batur dhe Formë	MSHMS	SHSSH	3-majori IV, 2020	3-majori IV, 2020	200	-	-	200	200	-	-	200	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
1.2	Deri në dhjetor të vitit 2020 janë ngritur i. 5 komisionet shpërndarëse të vlerësimit të aftësisë së kufizuar në qytet e Tiranë; Deri në Qershor 2020 janë ngritur 6 komisionet të tjera për Qafë Deris dhe Elbasan; dhe ii. deri në Dhjetor 2022 udhë 3 komisionet të tjera.	MSHMS	SHSSH	3-majori IV, 2020	3-majori IV, 2020	280,000	280,000	-	-	280,000	280,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
1.3	Edhe miratuar në skemën e aftësisë së kufizuar nëpërmjet përdorimit të SMI në qytet në të cilat do të shërbej nga reformë në mënyrë progresive (deri 2020 në Tiranë, Durrës dhe Elbasan dhe deri në Dhjetor 2022 në 9 qytet të tjera të vendit).	MSHMS	AKSHI	3-majori IV, 2020	3-majori IV, 2023	81,500	81,500	-	-	20,375	20,375	-	-	20,375	20,375	-	-	20,375	20,375	-	-	20,375	20,375	-	-
1.4	Regjistri Elektronik i Aftësisë së Kufizuar është përmirësuar nëpërmjet zgjerimit të funksioneve të monitorimit dhe vlerësimit nga operacioni elektronik.	MSHMS	AKSHI	3-majori I, 2023	3-majori IV, 2023	0	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
1.5	Edhe ngritur komisioni i shërbimit të ankësve deri në 2020 dhe i komisionit tjetër deri në vitin 2021.	MSHMS	SHSSH, DAP	3-majori IV, 2020	3-majori IV, 2021	75,000	75,000	-	-	37,500	37,500	-	-	37,500	37,500	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
1.6	Edhe miratuar nga Ministri përkrahës për çështjet sociale Udhëzime të bashkuar me metodologjinë e kontrollit të skemës së reformuar të vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe janë trajtuar studiet e analizave kontrolluese në nivel qytetor e regional mbi përdorimin e metodologjisë së re të kontrollit.	MSHMS	SHSSH	3-majori IV, 2020	3-majori IV, 2020	155,980	150,000	-	5,980	155,980	150,000	-	5,980	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
1.7	Jamë ulur me 10% numrin absolut nga përfundimet që nuk shfaqin aftësi të kufizuara deri në vitin 2020, si rezultat i përdorimit të SMI dhe procedurave të reja të kontrollit.	MSHMS	SHSSH	3-majori IV, 2020	3-majori IV, 2021	0	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
1.8	Ritrahësimi i pagesave dhe përfundimeve të aftësisë së kufizuar, pagesat e ndihmës personale, përfundimet në raport dhe ndihmën me shërbime të cilat në mënyrë progresive të fondeve publike, duke ulur fondin e pagesave në masën 17% deri në vitin 2022 dhe ka siguruar qëndrueshmëri financiare në skemën e aftësisë së kufizuar.	MSHMS	SHSSH	3-majori I, 2020	3-majori II, 2022	1,087,948	1,087,948	-	-	-	-	-	-	362,640	362,640	-	-	362,640	362,640	-	-	362,640	362,640	-	-
1.9	Jamë kështu 5 muajve bashkëpunimi në fushën e asistimit, formimit profesional, punësimit, në fushën e shërbimeve dhe atë sociale dhe janë nënshtruar nga Shërbimi Social Shërbimet me institucionet e përfundimit si: a) Drejtoritë Rajonale Arsimore; b) Fondi i Sigurimit të Kujdesit të Detyrueshëm Shërbimet; c) Shërbimi Kombëtar i Punësimit; d) Drejtoritë Rajonale të Asistimit dhe Formimit Profesional; f) Bashkia.	MSHMS	SHSSH, SHRP, FSDKSHI, NJQV, AFP, DAR	3-majori IV, 2020	3-majori IV, 2020	0	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
1.11	Kanë përfunduar nga shërbimet e asistimit, formimit profesional dhe punësimit, në vitin e parë 25% e personave të referuar nga komisioni, në vitin e dytë 50% në vitin e tretë 75% dhe 80% në vitin e katërt.	MSHMS	DAR, AFP, SHRP	3-majori IV, 2020	3-majori IV 2023	5,550	5,550	-	-	1,367	1,367	-	-	2,082	2,082	-	-	1,560	1,560	-	-	522	522	-	-
1.11	Kanë përfunduar shërbimet e koordinimit të mbledhjes nga njësitë e vetëqeverisjes vendore 30% e përfundimeve në vitin e parë, 60% në vitin e dytë dhe 100% në vitin e tretë.	MSHMS	NJQV	3-majori IV, 2020	3-majori IV 2023	210,000	-	-	210,000	-	-	-	-	63,000	-	-	63,000	88,200	-	-	88,200	58,800	-	-	58,800
1.12	Kanë përfunduar shërbimet të asistimit shpejtë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore 10% e përfundimeve të referuar nga komisioni në vitin e parë, 30% e	MSHMS	NJQV	3-majori IV	3-majori IV 2022	7,500	7,500	-	-	-	-	-	-	750	750	-	-	2,025	2,025	-	-	4,725	4,725	-	-

[illegible]

Page | 15078

Fletorja Zyrtare



Viti 2019 – Numri 184

[illegible]



Emërtimi i Indikatorit	INDIKATORI 1	INDIKATORI 2	INDIKATORI 3	INDIKATORI 4	INDIKATORI 5	INDIKATORI 6	INDIKATORI 7	INDIKATORI 8	INDIKATORI 9	INDIKATORI 10	INDIKATORI 11	INDIKATORI 12
	Rritja mbulimit me shërbime shoqërore për individët dhe familjet në nevojë	Numri i bashkëve që sigurojnë shërbime sociale komunitare për të paktën tri kategori (PAK, fëmijët vulnerabël dhe të moshuar)	Numri i fëmijëve që përfitojnë nga planet e deinstitutionalizimit	Fondi Social operacional dhe me kritere dhe procedura të mirëpërcaktuara	Numri i shërbimeve rehabilituese për personat me aftësi të kufizuara të integruara me programe të tjera mbështetëse në shëndetësi, arsim, punësim dhe formim profesional	Numri i njësive të qeverisjes vendore që referojnë dhe vlerësojnë rastet mbi shërbimet shoqërore nëpërmjet Regjistrat Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror.	Numri i njësive të qeverisjes vendore që referojnë dhe vlerësojnë rastet mbi shërbimet shoqërore sipas metodologjisë së re të inspektimit	Numri i punonjësve sociale të shërbimit të kujdesit shoqëror të trajnuar	Numri i qeverive lokale që ndihmojnë dhe prokurojnë shërbime të kujdesit shoqëror	Numri i eventeve sensibilizuese	Numri i institucioneve publike dhe jopublike të licencuara që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror	Numri i psikologëve dhe punonjësve socialë (shërbimi psikosocial) në arsimin publik parauniversitar-Strategjia e Arsimit Parauniversitar
Lloji i indikatorit	Niveli i lartë/impakti/rezultati	Rezultati	Rezultati	Rezultati	Rezultati	Rezultati	Rezultati	Rezultati	Rezultati	Rezultati	Rezultati	Rezultati
Nr., datë..., emërtimi i dokumentit	Dokumenti strategjik ku është krijuar indikator	Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2020-2023	Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2020-2023	Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2020-2023	Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2020-2023	Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2020-2023	Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2020-2023	Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2020-2023	Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2020-2023	Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2020-2023	Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2020-2023	Strategjia e Arsimit Parauniversitar
Lidhja me SKZHI-në (nr. i shyllës)	1. Anëtarësimi në BE-së 2. Qeverisja e mirë, demokracia dhe shteti i drejtë 3. Rritja përmes stabilitetit makro-ekonomik dhe fiskal 4. Rritja ekonomike përmes rritjes së konsumeshmërisë dhe novacionit 5. Investimi në kapital njerëzor dhe kohëzotim social 6. Rritja përmes përdorimit të qëndrueshëm të burimeve dhe zhvillimit të territorit	5. Investimi në kapital njerëzor dhe social	5. Investimi në kapital njerëzor dhe social	5. Investimi në kapital njerëzor dhe social	5. Investimi në kapital njerëzor dhe social	5. Investimi në kapital njerëzor dhe social	5. Investimi në kapital njerëzor dhe social	5. Investimi në kapital njerëzor dhe social	5. Investimi në kapital njerëzor dhe social	5. Investimi në kapital njerëzor dhe social	5. Investimi në kapital njerëzor dhe social	5. Investimi në kapital njerëzor dhe social
Qëllimi/Objektivi Strategjik në SKZHI	Emërtimi sipë është në SKZHI, Referohu <i>exat</i> "Mapping NSDL_MITBP for IPSIS", kolona 4	Konsolidimi i mbrojtjes shoqërore	Konsolidimi i mbrojtjes shoqërore	Konsolidimi i mbrojtjes shoqërore	Konsolidimi i mbrojtjes shoqërore	Konsolidimi i mbrojtjes shoqërore	Konsolidimi i mbrojtjes shoqërore	Konsolidimi i mbrojtjes shoqërore	Konsolidimi i mbrojtjes shoqërore	Konsolidimi i mbrojtjes shoqërore	Konsolidimi i mbrojtjes shoqërore	Përmirësimi i shërbimit "Arsim cilësor për të gjithë"
b) lista e investimeve publike sipas sektorëve në nivel qendror e lokal;

c) parashikimi për numrin e përfituesve të ndihmës ekonomike që mund të punësohen dhe të dalin nga skema e ndihmës ekonomike gjatë vitit përkatës, sipas sektorëve.

7. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale drejton grupin ndërmintor dhe siguron hartimin e dokumentit indikativ vjetor të integritit të përfituesve të ndihmës ekonomike në tregun e punës dhe ia drejton Kryeministrit.

8. Dokumenti indikativ vjetor i integritit të përfituesve të ndihmës ekonomike në tregun e punës publikohet në faqen zyrtare të ministrisë që mbulon çështjet sociale dhe të ministrisë që mbulon çështjet e punësimit, si dhe në faqet zyrtare të strukturave në varësi të tyre në nivel qendror e rajonal.

9. Dokumenti indikativ vjetor i integritit të përfituesve të ndihmës ekonomike në tregun e punës u shpërndahet të gjitha bashkive, zyrave të punësimit dhe zyrave të shërbimit social shtetëror e shërbën si dokument pune për këto institucione në zbatim të programit kombëtar të daljes nga skema e ndihmës ekonomike.



10. Zbatimi i veprimtarisë së mekanizmit zbatohet sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për shërbimet sociale dhe të punësimit në përputhje me fushën e përgjegjësisë shtetërore të institucioneve respektive, si më poshtë vijon:

- a) Shërbimi Social Shtetëror;
- b) Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive;
- c) Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore;
- ç) Njësitë e vetëqeverisjes vendore.

11. Mekanizmi në nivel qendror ka këtë përbërje:

- a) Drejtuesin e Shërbimit Social Shtetëror dhe përfaqësues të tjerë përgjegjës për çështjet e ndihmës ekonomike;
- b) Drejtuesin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe përfaqësues të tjerë përgjegjës për çështjet e aftësimit e të punësimit;
- c) Drejtuesin e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe përfaqësues të tjerë përgjegjës për çështjet vendore.

12. Veprimtaria e mekanizmit në nivel qendror konsiston në:

- a) identifikimin e problematikave lidhur me vështirësitë e integritimit në tregun e punës të anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike;
- b) ngritjen e mekanizmave bashkërendues rajonalë të përhershëm dhe përcaktimin e përbërjes së tyre;
- c) përcaktimin e mënyrës së bashkëpunimit e të bashkërendimit ndërinstitucional ndërmjet strukturave rajonale e vendore të punësimit, strukturave rajonale të shërbimit social shtetëror dhe njërive të vetëqeverisjes vendore;
- ç) bashkërendimin e programeve sipas fushave të përgjegjësisë shtetërore, me qëllim riintegrimin social të anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, si edhe integrimin e veprimtarive në pagesa e shërbime për fuqizimin ekonomik e social të përfituesve të ndihmës ekonomike nëpërmjet punësimit;
- d) përcaktimin e rregullave e të procedurave të funksionimit, si dhe detajimin e detyrave të autoriteteve përgjegjëse të bashkërendimit në nivel rajonal, në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara në këtë vendim;
- dh) përcaktimin e mënyrës dhe të formateve standarde të monitorimit e të raportimit, të

frekuencës së raportimit për personat në moshë aktive pune të referuar dhe të trajtuar me shërbime të punësimit e të aftësimit pranë ministrisë përkatëse, si edhe për situatën e punësimit sipas rajoneve;

e) vlerësimin e punës së ekipeve të ngritura në nivel rajonal e vendor si pjesë e mekanizmit, mbështetur në informacionet dhe raportet periodike të paraqitura prej tyre, si dhe marrjen e vendimeve për përmirësimin e funksionimit të tyre;

ë) marrjen e masave për ngritjen e kapaciteteve dhe përditësimin e njohurive të ekipeve të ngritura në nivel rajonal e vendor për zhvillimin e legjislacionit në fushën sociale, të punësimit dhe të aftësimit, si dhe sigurimin për njohjen e qytetarëve me funksionet e mekanizmit dhe të strukturave të tjera rajonale të këtij rrjeti, si edhe me mënyrat e kontaktimit të tyre;

ë) dakordësimin e miratimin e formateve standarde të planit individual të shërbimeve sociale, të planit individual të punësimit dhe të planit individual të veprimit për daljen nga skema e ndihmës ekonomike, i cili integron planin e shërbimeve sociale me atë të punësimit;

f) sigurimin e ndërveprimit të sistemeve të informacionit për shkëmbimin e të dhënave në kohë reale.

13. Mekanizmi në nivel qendror mblidhet jo më pak se 4 (katër) herë në vit dhe raporton çdo 3 (tre) muaj pranë ministrit përgjegjës për çështjet sociale dhe ministrit përgjegjës për punësimin për veprimtarinë e tij, të dhënat e problematikave lidhur me referimin, aftësimin dhe punësimin e anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, bazuar në informacionet e marra nga strukturat rajonale e vendore, duke paraqitur në këtë raport edhe propozime konkrete për mbështetjen që kërkohet nga institucionet qendrore.

14. Drejtuesit e institucioneve të përcaktuara në pikën 10, të këtij vendimi, përcaktojnë ekipet teknike, me përfaqësues teknikë të institucioneve që janë pjesë e mekanizmit, si në nivel qendror, ashtu edhe në nivel rajonal e vendor.

15. Ekipet e punës në nivel rajonal e vendor përbëhen nga përfaqësues në nivel teknik, që kanë në fushën e përgjegjësisë çështjet e punësimit dhe ato sociale.

16. Njësitë e vetëqeverisjes vendore të përcaktuara në shkronjën “ç”, të pikës 10, të këtij



vendimi, përfaqësohen nga drejtues dhe/ose përfaqësues në nivel teknik, që kanë në fushën e përgjegjësisë punësimin e çështjet sociale, të caktuar zyrtarisht nga kryetari i bashkisë, nën juridiksionin e rajonit në të cilin është bashkia, si autoritet përgjegjës në ekipet në nivel rajonal e vendor të mekanizmit.

17. Pjesë e ekipeve në nivel rajonal e vendor janë edhe përfaqësuesit e njërive të vetëqeverisjes vendore të caktuar zyrtarisht nga kryetarët e bashkive nën juridiksionin e rajonit në të cilin janë këto bashki.

18. Autoritetet përgjegjëse për çështjet sociale, të aftësimin dhe të punësimin në nivel rajonal e vendor, të përfaqësuara nëpërmjet ekipeve të punës si pjesë e mekanizmit, janë përgjegjës për:

a) identifikimin dhe referimin e qytetarëve që përfitojnë ndihmë ekonomike për t'u trajtuar me programe të aftësimin dhe të formimit profesional;

b) plotësimin e planeve individuale të shërbimeve sociale, i cili, ndër të tjera, përmban të dhëna për individin dhe nevojat për shërbime sociale që përbëjnë pengesë për punësim, duke përfshirë ato shëndetësore, sociale e të strehimit;

c) plotësimin e planeve individuale të punësimin bazuar në mundësitë aktuale të masave aktive të tregut të punës (punë publike, subvencion page, internship etj.) në aftësitë dhe në eksperiencën e përfituesit të ndihmës ekonomike që është në moshë aktive pune;

ç) integrimin e planeve të përcaktuara në shkronjat “b” dhe “c”, të kësaj pike, në planin individual të veprimit për daljen nga skema e ndihmës ekonomike;

d) asistimin dhe ndjekjen e rasteve, duke siguruar edhe lidhjen e tyre me shërbimet e përshtatshme;

dh) ndjekjen e protokolleve të trajtimit me programe të këshillimit, të aftësimin, të ndërmjetësimit dhe të punësimin;

e) referimin dhe trajtimin me programe sociale, përfshirë ato të strehimit, social-shëndetësore, si edhe programe të tjera që kanë në fokus fuqizimin e individit e të familjeve;

ë) identifikimin e individëve që nuk janë regjistruar si punëkërkues të papunë, informimin e tyre për procedurën që duhet të ndjekin dhe orientimin e referimin e tyre;

f) identifikimin e raportimin e rasteve që janë çregjistruar për arsye punësimi, përfshirë

pjesëmarrjen në programet e nxitjes së punësimin apo kanë humbur statusin e punëkërkuesit të papunë për arsye të refuzimit të shërbimeve dhe të programeve të ofruara nga zyra e punësimin;

g) identifikimin e raportimin e rasteve që nuk janë regjistruar në zyrat e punës si punëkërkues të papunë apo që nuk paraqiten në takimin e përcaktuar;

gj) shkëmbimin e informacionit me të dhënat e anëtarëve aktivë në moshë pune të familjeve nga skema e ndihmës ekonomike të regjistruar pranë zyrave të punësimin që janë ndërmjetësuar për punë dhe s'kanë përfituar nga programet aktive të tregut të punës;

h) përcaktimin e një punonjësi përgjegjës në çdo strukturë rajonale/bashki, si pjesë e mekanizmit për referimin, asistimin dhe ndjekjen deri në punësim të qëndrueshëm të anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike;

i) raportimin periodik lidhur me mbarëvajtjen e procesit pranë mekanizmit qendror;

j) raportimin për fillimin e zbatimit të planit individual të veprimit për personat në moshë aktive pune, përfitues të ndihmës ekonomike, e cila do të konsiderohet si çasti i daljes nga skema e ndihmës ekonomike dhe e përfundimit të së drejtës së përfitimit nga kjo skemë;

k) shkëmbimin e të dhënave në kohë reale nëpërmjet përdorimit të sistemeve të informacionit dhe/ose në mënyrë shkresore;

l) detyra të tjera të përcaktuara nga mekanizmi qendror, sipas përcaktimeve të shkronjës “c”, të pikës 12, të këtij vendimi.

19. Ekipet e punës të ngritura në nivel rajonal e vendor, si pjesë e mekanizmit, raportojnë periodikisht në institucionet e tyre respektive dhe pranë institucioneve qendrore të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, për veprimtarinë e kryer në kuadër të mekanizmit për referimin dhe trajtimin me pagesa e shërbime të aftësimin e të punësimin të anëtarëve në moshë aktive pune.

20. Institucionet e përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, raportojnë çdo 3 (tre) muaj pranë ministrit përgjegjës për çështjet sociale dhe ministrit përgjegjës për punësimin, sipas përcaktimeve në pikën 13, të këtij vendimi, për bashkërendimin e veprimtarisë ndërinstitucionale.

21. Ministri përgjegjës për çështjet sociale dhe ministri përgjegjës për çështjet e punësimin raportojnë pranë Kryeministrit për zbatimin e



dokumentit indikativ vjetor të integrimit të përfituesve të ndihmës ekonomike në tregun e punës, si dhe ecurinë e mekanizmit për riintegrimin social të përfituesve të ndihmës ekonomike, përmes zbatimit të programit kombëtar të daljes nga skema e ndihmës ekonomike.

22. Në raportimet periodike mekanizmi garanton ruajtjen e të dhënave personale të individëve, sipas përcaktimeve të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

23. Ngarkohen ministri përgjegjës për çështjet sociale dhe ministri përgjegjës për punësimin të miratojnë planin e masave dhe formatet e planeve individuale, në zbatim të programit kombëtar të daljes nga skema e ndihmës ekonomike.

24. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Shërbimi Social Shtetëror, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**PROGRAMI KOMBËTAR I DALJES PËR
PËRFTUESIT E NDIHMËS EKONOMIKE
Dhjetor 2019
PËRMBAJTJA**

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. PROFILI I PËRFTUESVE TË NDIHMËS EKONOMIKE

2. DOKUMENTE POLITIKE DHE KUADRI LEGJISLATIV

2.1 Kuadri ligjor për ndihmën ekonomike

2.2 Kuadri ligjor për programet e punësimit

2.3 Marrëveshja ndërmjet SHSSH-së dhe zyrave të punësimit

2.4 Legjislacion në mbështetje të integrimit ekonomik dhe social të grupeve në nevojë

3. KUADRI INSTITUCIONAL

4. EKSPERIENCAT NDËRKOMBËTARE RRETH PROGRAMEVE TË DALJES NGA SKEMA E NE-së

5. PROGRAMI I DALJES NGA NE-ja

5.1 Qëllimi dhe objektiva

5.2 Masat e politikave aktive të tregut të punës për përfituesit e NE-së

5.3 Procesi i përgatitjes së Planit Individual të Veprimt dhe institucionet përgjegjëse.

5.4 Përfshirja e përfituesve të NE-së në masat aktive të tregut të punës në 2020–2022 dhe institucionet përgjegjëse

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Objekti i këtij Programi të Daljes nga Ndihmës Ekonomike (NE) është shndërrimi i skemës ekzistuese të ndihmës sociale, në një skemë tranzicioni të përfituesve të NE-së - në punësim përmes përfshirjes prioritare të përfituesve të aftë për punë që përfitojnë NE, në programet e politikave aktive të tregut të punës (PATP) bazuar në modele inovative dhe përvojën ndërkombëtare. PATP-të synojnë shfrytëzimin e të gjitha mundësive të krijuara nga ekzekutimi i punëve publike në nivelin qendror dhe lokal, subvencionet e punësimit, trajnimet, praktikat e punës dhe arsimi profesional, si masa që do të synojnë integrimin e suksesshëm dhe riintegrimin në tregun e punës të përfituesve të aftë për punë që përfitojnë NE, me qëllimin përfundimtar dalja e tyre nga skema e NE-së. PATP-i do të mbështesë punësimin dhe rritjen ekonomike përmes zvogëlimit të papunësisë dhe zbutjes së varfërisë nga përfitimet e NE-së.

Përfituesit e NE-së, që merren parasysh për Programin e Daljes nga NE-ja janë individë që mund të punësohen në grup-moshën 15–64 vjeç; ky grup përfshin një pjesë të madhe të të rinjve që nuk ndjekin shkollën, që i përkasin grup-moshës 15–29 vjeç dhe që përbëjnë rreth 30.5% të totalit. Vetëm 12.9% e përfituesve të NE-së kërkojnë punë, ata i përkasin kryesisht grup-moshës 50 vjeç e më të vjetër, që përbëjnë 14.5% të përfituesve të NE-së. Përfituesit e NE-së dominohen nga familje me 4 anëtarë dhe më shumë. Kryefamiljarët femra përbëjnë 10% të familjeve me përfitim të përgjithshëm. Shumica e përfituesve të NE-së janë kanë nivel të ulët arsimor dhe kanë aftësi të ulëta. Shumica e përfituesve të NE-së ndodhen në pjesën lindore të Shqipërisë, kryesisht në zonat të cilat në 3 dekadat e fundit nuk arritën të shndërrojnë mbylljen e industrive të mëparshme ose aktivitetete të tjera ekonomike, në aktivitete të reja. Përfituesit e NE-së kanë një



përqendrim më të lartë në rajonet e Elbasanit, Kukësit, Dibrës dhe Korçës; së bashku me bashkitë e Peshkopisë, Kukësit dhe Elbasanit.

Si Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2015–2020 dhe Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2014–2020 adresojnë çështje që lidhen me zbutjen sociale dhe punësimin e përfituesve të NE, por janë jo të plota për sa i përket vendosjes së një lidhje të qëndrueshme midis skemës së ndihmës ekonomike dhe objektivit të tyre për t'u riintegruar përmes programeve të punësimit, përmes programeve të arsimit profesional dhe trajnimit për punësim, ndërmarrje sociale, skemave të zhvillimi të territorit etj. Aktualisht, sistemi ka një hendek midis skemave të krijuara të mbrojtjes sociale dhe atyre që promovojnë punësimin – edhe pse kategoritë e cënueshme janë me përparësi për punësim, përsëri këto dy sisteme “funksionojnë paralel” me njëri-tjetrin, duke mos qenë në gjendje të ndërliken.

Koordinimi ndërinstytucional në politikat dhe përpjekjet e përfshirjes sociale mbetet sfidues, kryesisht për shkak të ndryshimit të strukturave qeverisëse të Strategjisë së Mbrojtjes Sociale 2015–2020, si dhe roleve dhe përgjegjësi të institucioneve. Thelbësore për suksesin e masave të punësimit në nxitjen e përfshirjes sociale, është koordinimi dhe bashkëpunimi midis SHKP-së dhe institucioneve që reformojnë sistemin e mbrojtjes sociale. Forcimi i institucioneve, përmirësimi i kornizës ligjore dhe shkëmbimi i informacionit përmes sistemeve të shëndosha të monitorimit ndërinstytucional mbeten thelbësore për përmirësimin e efikasitetit të masave të punësimit për të ndikuar në përjashtimin social dhe marginalizimin e individëve dhe familjeve.

Programi i Daljes nga NE-ja bazohet në politikat aktive të tregut të punës që i japin përparësi punësimit të përfituesve të NE-së. Integrimi i tyre social dhe në tregun e punës do të arrihet përmes politikave aktive të tregut të punës, siç janë punimet publike, subvencionet e punësimit, dhe trajnimet dhe praktikrat. Programi i punëve publike do të garantohet me investime publike të parashikuara çdo vit nga buxhetet e shtetit dhe bashkisë, si dhe në ato raste kur palët e treta implementojnë projekte të financuara nga fonde publike. Investimet publike në nivelin qendror dhe lokal që veprojnë si PATP-ja, janë përqendruar në

disa sektorë kryesorë, si: bujqësia, infrastruktura, turizmi, arsimi dhe shëndetësia.

Dalja nga skema e NE-së dhe integrimi i përfituesve të punësueshëm të NE-së në tregun e punës do të bëhet përmes një mekanizmi ndërinstytucional i cili është Plani i Veprimit Individual (PIV). PIV harton profilin shoqëror dhe profesional të individëve që përfitojnë nga NE, duke zgjedhur dhe kombinuar masën aktive të tregut të punës dhe shërbimeve sociale, të personalizuar për secilin përfitues individual të NE-së. PIV-i përgatitet me kontributin e Zyrës së Shërbimit Social në Bashki, Shërbimin Social Shtetëror dhe Agjencisë Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive. PIV-i paraqet një zinxhir të thjeshtë vendimmarrjeje i cili garanton ofrimin e shërbimeve dhe përfitimeve sipas nevojave të individëve që është në procesin e kalimit nga NE-ja në punësim.

1. PROFILI I PËRFITUESVE TË NDIHMËS EKONOMIKE

Qëllimi i punës dhe metodologjia

Profilin e përfituesve të Ndihmës Ekonomike (NE) i shërben hartimi i politikave të daljes nga skema e NE-së apo aktivizimit të programeve të punësimit duke ndihmuar përfitues të NE-së që të kapërcejnë kufizimet dhe pengesat që ata hasin në procesin e riintegrit, punësimit dhe pjesëmarrjes në tregun e punës.

Përcaktimi i disa elementeve të metodologjisë dhe kategorive që do të merren në shqyrtim, u dakordësua me stafin drejtues i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), të cilat janë si më poshtë:

- Analiza e të dhënave për familjet dhe individët përfitues do të bazohet në vitet 2018 dhe 2019;

- Analiza do të bazohet vetëm në familjet përfituese nga skema e NE-së (familje në nevojë), duke mos përfshirë familjet dhe individët që i përkasin fondit 6% të bashkive, si dhe kategoritë e veçanta: viktimat e dhunës, viktimat trafikimi, jetim etj.

- Si bazë mesatare vjetore, do të shërbejë muaji që ka numrin më të lartë të përfituesve në vitin përkatës, ku kemi: për vitin 2018 është marrë muaji dhjetor (12) dhe për vitin 2019 është bazuar në muajin maj (5).

- Në këtë analizë janë përjashtuar personat PAK, që janë pjesë e familjeve përfituese nga skema e NE-së.



- Në lidhje me nivelin arsimor, të dhënat e analizuara nuk përmbajnë individë fëmijë 0–6 vjeç, duke qenë se në sistem klasifikohen si “asnjë” kur prodhohen të dhënat në lidhje me nivelin arsimor.

Të dhënat u vunë në dispozicion nga MSHMS-ja dhe Ministria e Financave dhe e Ekonomisë. Në tërësi dhe sipas secilës kategori, ato kanë diskrepanca serioze, si në nivel qarku ashtu dhe bashkie, të cilat do të duhet të adresohen në vijim për të rritur saktësinë e politikave dhe eficiencën e burimeve që angazhohen në procesin e riintegrit, punësimit dhe pjesëmarrjes në tregun e punës të përfituesve të NE-së.

Karakteristikat kryesore të përfituesve të NE-së

Përkufizimi


Profili i përfituesve të NE-së, i ndërtuar me të dhënat e vëna në dispozicion, përmbledh individët të cilët mund të punojnë brenda segmentit 15–64 vjeç. Këta individë përkufizohen si përfitues të NE-së të punësueshëm. Brenda këtij numri gjenden edhe individë të cilët janë duke u trajnuar apo që janë duke ndjekur arsimin sekondar dhe terciar. Nga ky numër janë përjashtuar personat të cilët

përfitojnë pagesa për aftësi të kufizuar. Kjo bëhet pa paragjykuar aftësinë për të punuar të personave me aftësi të kufizuar, duke mbajtur parasysh se nuk pritët që këta persona të jenë të detyruar të kërkojnë apo gjejnë punë, si kusht që të mund të përfitojnë asistencë sociale.

Përfituesit e NE-së

Numri total i përfituesve të NE-së të punësueshëm, në Shqipëri për vitin 2018 është 231,556 persona, ndërsa shënon një rritje prej 5%, ose 243,077 persona në vitin 2019. Femrat përbëjnë rreth 49%, ndërsa meshkujt janë 51% e totalit të përfituesve të NE-së të punësueshëm. Ky raport nuk regjistron ndryshime nga viti në vit, pavarësisht rritjes së lehtë të regjistruar në vitin 2019 përkundrejt një viti më parë. Raportet femra–meshkuj në vitet 2018–2019 janë thuajse të pandryshuara për sa u përket grup-moshave 15–54; por dominimi i meshkujve thellohet në grup-moshat 55–59 dhe 60–64 vjeç; ai qëndron respektivisht në meshkuj 58.2% dhe femra 41.8%, dhe meshkuj 73% dhe femra 27% për këto grup-mosha.


Figura 1. Përfituesit e NE-së sipas gjinisë dhe grup-moshave



Numri i familjeve dhe gratë kryefamiljare përfituese të NE-së

Numri i familjeve përfituese të NE-së në vitin 2018 është 58,570 dhe në vitin 2019 është 61,541 duke shënuar një rritje të lehtë prej rreth 5%. Kompozimi i familjeve përfituese të NE-së dominohet nga familje me 4 anëtarë dhe më shumë se 4 anëtarë. Këto dy grupe së bashku përfaqësojnë 71.2% të familjeve në 2018, dhe 70.2% të familjeve në vitin 2019. Familjet që përfitojnë NE dominohen nga kryefamiljarë meshkuj. Numri i familjeve me kryefamiljar gra përbën vetëm 11% të totalit në 2018, dhe regjistron një rënie të lehtë në 10.3% të totalit në vitin 2019. Numri i familjeve me 1 anëtar, me gra kryefamiljare, përbën 2.3% të totalit në vitin 2018 ndërsa raportohet të jetë vetëm 0.7% e totalit në vitin 2019. Numri i familjeve me 2 anëtarë me gra kryefamiljare është 1.7% të totalit në 2018, ndërsa regjistron një rritje në 2.1% të totalit në vitin 2019. Për familjet me nga 3 anëtarë me gra kryefamiljare

ky numër varion nga 2.76% të totalit më 2018-n në 3% në vitin 2019. Numri i familjeve, me gra kryefamiljare, me 4, dhe më shumë se 4 anëtarë përbën rreth 4.3% të totalit të familjeve, si në 2018 ashtu dhe në vitin 2019.



Përfituesit e NE-së sipas grup-moshave

Grup-mosha 15–19 vjeç përfaqëson grupin më të rëndësishëm të përfituesve të NE-së të punësueshëm me rreth 18.1% të totalit, e ndjekur nga grup-mosha 20–24 vjeç që përbën 12.5% të totalit të përfituesve. Grup-mosha 15–24 përbën 30.5% të totalit të përfituesve të NE-së. Grup-moshat e tjera regjistrojnë pesha thuajse të njëjta, në një vlerë mesatare prej 9.4%. Pesha ndaj totalit, fillon dhe bie te grup-mosha 55–59, që përfaqëson rreth 7% të totalit të përfituesve, ndërsa grup-mosha e fundit 60–64 vjeç përfaqëson rreth 3.2% të totalit të përfituesve të NE-së të punësueshëm.

Përfituesit e NE-së si punëkërkues të papunë

Numri i punëkërkuesve që janë përfitues të NE-së ka arritur në 22,167 persona të regjistruar në zyrat e punës në rang vendi për tremujorin e dytë të vitit 2019. Këta persona janë vetëm 12.9% e totalit të grup-moshës 15–64 vjeç, që janë përfitues të NE-së të punësueshëm në vitin 2019. Gjithashtu, ky numër përfaqëson rreth 13.5%, të totalit të punëkërkuesve të papunë në rang vendi që raportohet të jetë 164,704 persona, për të njëjtën periudhë. Pjesa më e madhe, ose 34% e totalit të punëkërkuesve të papunë përfitues të NE-së që janë regjistruar në zyrat e punës i përkasin grup-moshës 50 vjeç e sipër. Rreth 14% i përkasin grup-moshës 45–50 vjeç, ndërsa 13% i përkasin grup-moshës 40–44 vjeç. Më pak se 40% e totalit të punëkërkuesve të papunë që përfitojnë NE të regjistruar në zyrat e punës, i përkasin grup-moshës 20–39 vjeç, që përbën forcën më të rëndësishme për tregun e punës. Vetëm 1% e totalit të përfituesve të NE-së të regjistruar në zyrat e punës si punëkërkues të papunë i përkasin grup-moshës 15–19 vjeç. Këto raporte që shohin grup-moshën 20–39 vjeç në nivelet e rreth 40% ndaj totalit dhe ata mbi 40 vjeç në rreth 60% të totalit, vërehen njëjloj edhe gjatë vitit 2018.

Figura 3. Kompozimi i përfituesve NE sipas grup-moshës





Figura 4. Kompozimi i punëkërkuesve NE sipas grup-moshës






Përfituesit e NE-së sipas nivelit arsimor

Niveli arsimor i përfituesve të NE-së dominohet – më shumë se 50% - nga individët që kanë mbaruar vetëm arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar, pavarësisht grup-moshave. Ata që kanë mbaruar vetëm arsimin 4 vjeçar përbëjnë rreth 14.8% të totalit të përfituesve të NE-së. Përfitues të NE-së që kanë mbaruar arsimin e mesëm të përgjithshëm përbëjnë 18.8% të totalit në vitin 2018, ndërsa regjistrojnë një rënie të lehtë në 17.8% të totalit në vitin 2019. Në totalin e përfituesve të NE-së, numri i individëve që kanë mbaruar ciklet e arsimit profesional përbën vetëm 1.18% dhe 1.15%, respektivisht për vitin 2018 dhe 2019. Po njësoj paraqitet situata edhe për përfituesit e NE-së që kanë mbaruar studimet universitare dhe pasuniversitare në Shqipëri, ose jashtë saj, numri i tyre kundrejt totalit përbën 1.23% dhe 1.24% respektivisht për vitet 2018 dhe 2019. Vlen të përmendet se brenda kësaj kategorie regjistrohet një rritje me 6.1% në këtë kategori, e cila në vitin 2019 numëronte 2,734 individë, kundrejt vitit të mëparshëm me 2,568 individë të regjistruar si përfitues të NE-së.

Figura 5. Përfituesit NE sipas nivelit të arsimimit



Shpërndarja e përfituesve të NE-së sipas qarkut

Nga të dhënat e disponueshme rezulton se numri i përfituesve të NE-së është më i larti në qarkun e Elbasanit duke përfaqësuar 26% të numrit total të përfituesve të NE-së. Pas tij renditet qarku Dibër me rreth 17.4% të totalit në 2018 dhe 18.2% të totalit në vitin 2019, i ndjekur nga qarku Kukës me rreth 15.3% për të njëjtën periudhë. Pas tyre renditen Korça me mesatarisht 11.7% të numrit total të përfituesve, e ndjekur nga Shkodra me rreth 8% të totalit të individëve përfitues të NE-së. Qarku i Tiranës renditet në vendin e 6-të për sa i përket numrit të përfituesve të NE-së me 6% të totalit në 2018 dhe 4.6% më 2019-n; e ndjekur nga qarku Lezhë dhe Fier, respektivisht në një mesatare prej 4.5% dhe 3.5% të totalit të përfituesve të NE-së. Qarku i Durrësit ka numrin më të vogël të përfituesve të NE-së me rreth 1%, ndërsa Vlora ka mesatarisht 2.3% dhe Gjirokastra rreth 1.5% të totalit të përfituesve të NE-së në shkallë vendi.






Figura 6. Shpërndarja e përfituesve NE sipas qarqeve në % ndaj totalit për vitet 2018 dhe 2019




Shpërndarja e përfituesve të NE-së sipas bashkive

Nga analiza e të dhënave në nivel bashkie, rezulton se bashkia Peshkopi ka nivelin më të lartë të përfituesve të NE-së, që përbëjnë rreth 9.8% të totalit e ndjekur nga bashkitë e Kukësit dhe Elbasanit, të cilat përbëjnë respektivisht rreth 8.8% dhe 8.7% të numrit total të përfituesve. Bashkia Pogradec rendit në vend të 4 për nga numri i përfituesve të NE-së me rreth 6.25% të totalit. Ndihet nga bashkitë e Librazhdit dhe Përrenjasit me respektivisht 4.8% dhe 4.1% të totalit. Ndërsa bashkitë Has, Tiranë, Gramsh dhe Shkodër kanë një numër përfituesish që varion nga 3.7% në 3.1%.



Figura 7. Bashkitë me më shumë përfitues të NE-së në % ndaj totalit për vitet 2018 dhe 2019



Përfundim

Të dhënat e analizuar për përgatitjen e profilit të përfituesve të NE-së në Shqipëri mund të sigurojnë vetëm një pamje fillestare të profilit të përgjithshëm të përfituesve. Nga analiza e të dhënave del në pah se përfituesit e NE-së dominohen nga meshkujt, janë përqendruar më së shumti në grup-moshën 15–29 vjeç që përbëjnë rreth 30.5% të totalit. Vetëm 12.9% e përfituesve të NE-së janë në kërkim të një pune, këta i përkasin kryesisht grup-moshës 50 plus vjeç që përbëjnë 14.5% të totalit të përfituesve të NE-së. Nga ana tjetër, më shumë se 50% e përfituesve të NE-së kanë mbaruar vetëm arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar; duke i shtuar edhe përfituesit e NE-së që kanë mbaruar arsimin e mesëm, këta përbëjnë 84% të totalit të përfituesve të NE-së në Shqipëri. Përfituesit e NE-së dominohen nga familje me 4 anëtarë dhe më shumë se 4 anëtarë. Këto dy grupe së bashku përfaqësojnë 71.2% të familjeve në 2018, dhe 70.2% të familjeve në vitin 2019. Gratë kryefamiljare përbëjnë rreth 10% të totalit të familjeve përfituese. Përfituesit e NE-së janë të përqendruar kryesisht në zonën lindore të Shqipërisë, kryesisht në zona që në këto 3 dekada nuk arritur të zëvendësojnë mbylljen e industrive dhe aktiviteteteve të tjera ekonomike të mëparshme. Përfituesit e NE-së kanë një shkallë të lartë përqendrimi në qarqet e Elbasanit, Kukësit, Dibrës dhe Korçës; dhe bashkitë e Peshkopisë, Kukësit dhe Elbasanit.

2. DOKUMENTE POLITIKE DHE KUADRI LEGJISLATIV

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020 (SKZHI) është dokumenti kryesor strategjik kombëtar që mbështet zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të vendit, duke siguruar përmbushjen e standardeve dhe progresin në procesin e integrimit evropian. Në lidhje me mbrojtjen sociale, vizioni i kësaj strategjie është ndërtimi i një sistemi të mbrojtjes shoqërore me

qëllim reduktimin e pabarazive ekonomiko-shoqërore, duke krijuar një sistem me politika dhe mekanizma për mbrojtjen e të gjithë individëve vulnerabël dhe të përjashtuar përmes programeve parandaluese dhe atyre të përfshirjes sociale, të kombinuar me skemat e punësimit.

SKZHI përmban objektivin strategjik që lidhet me ndihmën ekonomike, garantimi i së cilës synon zbutjen dhe uljen e varfërisë dhe varfërisë absolute, ndër të tjera, nëpërmjet transformimit të skemës së ndihmës ekonomike në një skemë aktive, përmes skemës së riintegritit shoqëror. Përfituesit do të përfshihen në politika aktive të tregut të punës, duke krijuar paketa të shërbimeve të integruara dhe mundësi punësimi. SKZHI, po ashtu synon shtimin e mundësive për punësim dhe formim profesional përmes rritjes së aftësive profesionale dhe krijimit i vendeve më të mira të punës për të gjithë burrat dhe gratë, nëpërmjet: i) nxitjes së mundësive dinjitoze të punësimit përmes politikave më efikase të tregut të punës; ii) ofrimit të arsimit dhe formimit profesional cilësor (AFP) për të rinjtë dhe të rriturit; dhe iii) uljen e informalitetit të punësimit informal në sektorët jobujqësorë.

Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2015–2020 synon ndërtimin e një sistemi mbrojtjeje sociale që të luftojë pabarazitë social-ekonomike, një sistem që garanton politika dhe mekanizma për të mbrojtur të gjithë individët në nevojë, ose të përjashtuar nëpërmjet programeve parandaluese dhe riintegritit social alternuar me skemat e punësimit. Synimi i strategjisë është integrimi në jetën shoqërore të familjeve përfituese të NE-së nëpërmjet programeve, të tilla si: nxitja e punësimit, orientimi në tregun e punës nëpërmjet kurseve të formimit profesional dhe programeve të ngjashme që kanë çuar në përfshirjen në tregun e punës të anëtarëve në moshë aktive pune. Një nga objektivat e rëndësishëm të kësaj strategjie është *zbutja dhe lehtësimi i varfërisë*, e cila synohet të arrihet përmes transformimit të programit të ndihmës ekonomike



në skemë integrimi nëpërmjet krijimit të mundësive për punësim, parashikon rritjen e eficiencës së skemës së ndihmës ekonomike, kalimin e saj në një skemë integrimi duke e alternuar me skemat e tjera të punësimit.

Strategjia Kombëtare për Punësim e Aftësi 2014–2020 synon garantimin e një rritje të zgjuar, të qëndrueshme, në një ekonomi konkurruese dhe një shoqëri gjithëpërfshirëse bazuar në aftësi më të larta dhe punë më të mirë për të gjithë gratë dhe burrat. Ndër të tjera, kjo strategji synon reformimin e sistemit të ndihmës sociale për të shmangur rrjedhjet, gabimet dhe rritur mbulimin e personave që e meritojnë, si dhe për të lidhur ndihmën ekonomike me riintegrimin në tregun e punës. Kjo realizohet përmes: i) harmonizimit të shërbimeve të punësimit dhe shërbimeve sociale për të adresuar nevojat e individëve, që përballen me disavantazhe të shumta, për të maksimizuar ndërveprimin midis politikave pasive dhe aktive, për të identifikuar faktorët pengues për hyrjen në tregun e punës dhe për të reduktuar varësinë nga ndihma ekonomike; ii) ngritjes së një sistemi që kombinon ndihmën sociale dhe politikat aktive të tregut të punës (mundësisht duke përfshirë një program për punët komunitare) për të mbështetur integrimin në tregun e punës të personave që marrin ndihmën ekonomike; dhe iii) ngritjes së një mekanizmi monitorues, i cili ndjek situatën e femrave dhe meshkujve në nevojë në Shqipëri, duke përfshirë ato që janë prekur nga emigracioni.

Si Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2015–2020, ashtu dhe Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim 2014–2020 janë të paplota për sa i përket krijimit të lidhjes së qëndrueshme midis skemës së ndihmës ekonomike (NE) dhe objektivit të tyre në lidhje me riintegrimin alternuar me skemat e punësimit, nëpërmjet arsimit profesional dhe programeve të përgatitjes për punësim, ndërmarrjeve sociale, skemave zhvillimore territoriale etj. Currentlly, sistemi aktual ka një hendek mes skemave të ngritura të mbrojtjes sociale dhe skemave të nxitjes së punësimit – edhe pse priorizohen kategoritë vulnerabël në punësim, përsëri këto dy sisteme shkojnë në “vija paralele” dhe nuk kryqëzohen.

Vërehet se niveli i koordinimit institucional në politikat dhe ndërhyrjet e përfshirjes sociale, mbetet sfidues, kryesisht për shkak të ndryshimeve në strukturat qeverisëse të NESS 2014–2020, si edhe të roleve dhe përgjegjësi të institucioneve.

Koordinimi dhe bashkëpunimi ndërmjet NES dhe institucioneve që po reformojnë sistemin e mbrojtjes sociale, do të ishin faktorë kyç për suksesin që masat e punësimit, të mund të krijojnë përfshirje sociale.

Me efektive në rritjen e punësimit janë deri tashmë ato programe të zbatuara nga stafe të specializuar në ndërmjetësimin dhe targetimin e nevojave specifike dhe hartimin e planeve të punësimit për njerëz me nevoja specifike. Nga ana tjetër, punësimi i individëve në nevojë përmes programeve të përgjithshme të punësimit nuk ka prodhuar efekte të dëshiruara dhe të qëndrueshme, çështje që duhet trajtuar me më tepër vëmendje për të rritur efektivitetin e këtyre programeve.

2.1 Kuadri ligjor për ndihmën ekonomike

Ndihma ekonomike në Republikën e Shqipërisë rregullohet nga ligji nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, i miratuar në datën 18.7.2019. Ky ligj përcakton rregullat dhe mekanizmat për përfitimin e asistencës sociale, kriteret dhe procedurat e përfitimit/përfshimit nga ndihma ekonomike, llojet e pagesave të ndihmës, autoritetet përgjegjëse për garantimin e kësaj të drejte, si dhe marrëdhëniet e financimit të ofrimit dhe përfitimit të asistencës sociale. Qëllimi i këtij ligji është të garantojë dhe rregullojë tri programe të mbrojtjes sociale: ndihmën ekonomike, pagesat për aftësinë së kufizuar, dhe bonusit të bebeve. Ky ligj zbatohet për individët, familjet në nevojë, personat me aftësi të kufizuara në Republikën e Shqipërisë dhe nënat me foshnja të porsalindura, për ofrimin dhe garantimin e asistencës sociale, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj. Ky ligj i miratuar rishtazi ka shfuqizuar ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” dhe çdo akt tjetër që bie në kundërshtim me të.

Ligji i ri përcakton se autoriteti përgjegjës për hartimin e politikave, të programeve dhe legjislacionit, programimin e fondeve për programet e asistencës sociale, si dhe kontrollin e zbatimit të tyre në të gjitha nivelet e strukturave qendrore dhe vendore, është Ministria përgjegjëse për Çështjet Sociale, aktualisht Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Sipas ligjit kjo ministri propozon mekanizmin e bashkërendimit ndërinstitucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të ndihmës



ekonomike, për të siguruar riintegrimin social të tyre, nëpërmjet një programi daljeje nga skema e ndihmës ekonomike, e cila përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ky ligj përcakton se NE-ja do të jetë e kufizuar në kohë. Kohëzgjatja e përfitimit të NE-së përcaktohet me akte nënligjore. Aktualisht, periudha e qëndrimit në skemën e përfitimi të NE-së është 5 vjet. Kufizimi kohor synon të nxisë integrimin në jetën shoqërore të familjeve në skemën e ndihmës nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit, me qëllim që kjo skemë të mos përdoret si mekanizëm përfitimi që mund të çojë në papunësi të zgjatur të anëtarëve të familjeve në skemën e ndihmës ekonomike dhe për ta kthyer këtë në një skemë aktive.

Për të garantuar nxitjen e punësimit dhe përfshirjen e personave në moshë aktive pune përfitues të ndihmës ekonomike në programet aktive të punësimit dhe formimit profesional ligji ka parashikuar në mënyrë specifike disa masa shtrënguese të përcaktuara në nenin 15 për përjashtimin nga ndihma ekonomike.

Ligji i aprovuar se fundmi është i paplotë nga pikëpamja e akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin e tij.

Aktet nënligjore në fuqi i referohen ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar (tashmë i shfuqizuar), i cili parashikonte përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit që duhet të plotësojnë personat që do të përfshihen në programe të ri/integritimit social. Nga shqyrtimi i këtyre akteve rezulton se ende nuk është miratuar asnjë vendim nga ana e Këshillit të Ministrave që të bëjë këto përcaktime.

Kutia 1: Neni 15, i ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, i miratuar në datë 18.7.2019

Ky nen parashikon rastet kur ndodh:

Përjashtimi nga ndihma ekonomike

1. Përjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë gjashtëmujore familjet, të cilat kanë në përbërje të tyre edhe një anëtar të vetëm, që plotëson kushtet e mëposhtme:

- kryen ndarje të qëllimshme të anëtarëve të familjes që jetojnë në të njëjtën shtëpi, kur nuk krijohet një kaurorë e re, me përjashtim të rastit vajzë-nënë;

- nuk tërbeq ndihmën ekonomike brenda afateve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, me

përjashtim të rasteve kur kjo ka ndodhur për shkaqe të arsyeshme, si shëndetësore apo fatkeqësi;

- refuzon verifikimin e situatës social-ekonomike në familje;

- fsheh informacionin apo kryen deklaram të rremë;

- nuk paraqiten për deklaram dhe/ose nuk deklarojnë ndryshimet e situatës social-ekonomike çdo tre muaj pranë administratorit shoqëror, me përjashtim të rasteve kur kjo ka ndodhur për shkaqe të arsyeshme, si shëndetësore apo fatkeqësi, dhe të anëtarëve të familjes, të cilët janë persona me aftësi të kufizuara, invalidë pune ose të moshuar, të cilët janë në pamundësi lëvizjeje;

- refuzojnë përfshirjen në kurset e formimit profesional për anëtarët në moshë aktive pune të familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nxitjen e punësimit;

- kanë anëtarët në moshë aktive pune të aftë për punë, që nuk rezultojnë punëkërkuar të papunë pranë zyrave të punës apo të vetëpunësuar pranë strukturave të tatimeve, me përjashtim të rasteve të familjeve që zotërojnë tokë bujqësore në pronësi/përdorim dhe banojnë në fshat;

- anëtarët në moshë aktive pune, të aftë për punë, që nuk rezultojnë punëkërkuar të papunë pranë zyrave të punës apo të vetëpunësuar pranë strukturave të tatimeve, me përjashtim të familjeve që kanë anëtarë, që ndjekin arsimin e mesëm të lartë apo të lartë, por jo më shumë se deri në moshën 25 vjeç.

2. Përjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë njëvjeçare familjet, të cilat kanë në përbërje të tyre qoftë edhe një anëtar të vetëm që plotëson kushtet e mëposhtme:

- është në moshë aktive pune dhe refuzon ofertat e përshtatshme për punë të zyrave të punës, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nxitjen e punësimit;

- punësohen dhe ndërpresin marrëdhëniet e punës pa shkaqe të arsyeshme, me përjashtim të rasteve kur zgjidhja e kontratës bëhet nga ana e punëdhënësit;

- ka kryer më shumë se një deklaram të rremë;

- ato familje, të cilat rezultojnë me të ardhura dhe kushte të mira social-ekonomike.

2.2 Kuadri ligjor për programet e punësimit

Ligji nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit” i miratuar në mars të 2019-s përcakton rregullat dhe mënyrën e funksionimit të sistemit publik të shërbimeve të punësimit, të programeve aktive e pasive të tregut të punës, si dhe organet përgjegjëse për menaxhimin e tyre, me përjashtim të rasteve kur rregullohen nga legjislacioni i posaçëm. Ky ligj ka për qëllim rritjen e punësueshmërisë së forcave të punës, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve dhe programeve publike të punësimit, të vetëpunësimit



dhe të kualifikimit profesional. Ligji parashikon dhe konceptin e aftësimit dhe rehabilitimit për punë për personat me aftësi të kufizuara përmes shërbimeve mbështetëse dhe asistencës për vlerësimin e aftësisë për punë të personit me aftësi të kufizuara, të cilat ofrohen nëpërmjet: a) informimit, këshillimit profesional, vlerësimit të aftësive profesionale dhe gjetjes së punës; b) vlerësimit të mundësisë për aftësim, dhe hartimit të programeve përkatëse; dhe c) aftësimit profesional, kualifikimit plotësues, rikualifikimit me programet e mbajtjes dhe përmirësimit të aftësive të punës deri në momentin e punësimit.

Gjithashtu, ligji parashikon edhe kategoritë që përfshihen në “grupet të veçanta” si punëkërkues të disavantazhuar në tregun e punës. Këto grupe përfshijnë: a) individët me statusin e jetimit që ndodhen në kushte të vështira ekonomike; b) kryefamiljarë të vetëm, me fëmijë në ngarkim; c) persona me aftësi të kufizuara, përfshirë personat që nuk dëgjojnë dhe invalidët e punës të vlerësuar pjesërisht të aftë për punë nga komisionet përkatëse; ç) prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuar; d) persona me moshë mbi 55 vjeç; dh) persona nga komuniteti rom dhe egjiptian; e) persona që kanë vuajtur dënimin me burgim, apo ndaj të cilëve është vendosur pezullimi i vendimit me burgim dhe zëvendësimi i tij me një dënim alternativ; ë) persona nga familje që përfitojnë nga programet e mbështetjes me të ardhura; f) punëkërkues të papunë afatgjatë (të regjistruar si punëkërkues të papunë prej më shumë se një viti); g) punëkërkues të papunë, të kthyer prej jo më shumë se dy vjetësh nga emigracioni; gj) të mitur dhe të rinj në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur; h) të rinjtë me moshë nën 29 vjeç; i) viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit; j) viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe viktimat e dhunës në familje; dhe k) nënat nën moshën 18 vjeç.

Ligji për punësimin përkufizon “politikat publike të punësimit”, ku përfshihen shërbimet e punësimit dhe programet aktive e pasive të tregut të punës. Këto programe synojnë nxitjen e punësimit të punëkërkuesve të papunë, si dhe integrimin dhe përfshirjen sociale të grupeve të veçanta.

Në programet aktive të tregut të punës përfshihen mekanizmat që synojnë të mbajnë të

punësuarit në tregun e punës, të mbështesin punëkërkuesit e papunë të hyjnë në tregun e punës, të rrisin produktivitetin dhe të ardhurat nga puna dhe të përmirësojnë funksionimin e tregut të punës. Këto programe përfshijnë:

a) *shërbimet e punësimit (informimi, ndërmjetësimi për punësim, si edhe këshillimi dhe orientimi për karrierë, punësim e profesion);*

b) *programet e nxitjes së punësimit* përfshijnë angazhimin e punëkërkuesve të papunë në programe të ndryshme punësimi, punësh publike, vetëpunësimi, praktikash profesionale apo trajnimi, për të cilat parashikohet subvencionim, në përqindje të caktuar për kosto si: sigurimet e detyrueshme shëndetësore dhe shoqërore; pagat; formimin profesional; formimin nëpërmjet punës; vetëpunësimin; mbështetjen për bizneset e reja dhe inkubatorët e biznesit; pajisjen e vendit të punës dhe përshtatjen e arsyeshme; zbatimin e programeve për mbështetjen e kualifikimit profesional; punësimin e të diplomuarve/certifikuarve në arsimin e formimin profesional; praktikat profesionale; programin e garancisë rinore; *programet e riintegritit social*; transport për në vendin e punës; ndjekjen e kopshteve dhe çerdheve për fëmijët në ngarkim etj.

Autoriteti që menaxhon këto programe për nxitjen e punësimit, më parë ka qenë Shërbimi Kombëtar i Punësimit, i cili kishte varësi institucionale nga Ministria Financave dhe Ekonomisë (MFE); tashmë kjo quhet Agjencisë Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, e cila është në varësi të MFE-së;

c) *programet e formimit profesional.*

Programet pasive të tregut të punës përfshijnë mbështetjen me të ardhura nga papunësia. Punëkërkuesit e papunë, të cilët plotësojnë kushtet për përfitimin e të ardhurave nga papunësia dhe regjistrohen në strukturën rajonale/vendore si punëkërkues të papunë në zbatim të legjislacionit për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, përfitojnë nga pagesa e të ardhurave nga papunësia.

Ligji për punësimin (neni 15) parashikon ngritjen e *Këshillit Konsultativ për Punësimin (KKP)*. KKP-ja është organ këshillimor që ngrihet pranë institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, me përfaqësimin e organizatave të punëdhënësve, organizatave sindikale, si dhe institucioneve shtetërore, i cili kryesohet nga ministri përgjegjës



për punësimin dhe përbëhet nga 11 anëtarë, një prej të cilëve është përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale. Ky Këshill Konsultativ i Punësimit është tashmë i ngritur dhe në varësi të MFE-së.

Ligji për punësimin themelon, gjithashtu, Fondin Social të Punësimit, i cili krijohet në formën e një fondi financiar publik. Ky fond krijohet nga:

- a) kontributet e derdhura në llogari të Fondit, sipas pikës 2, të nenit 20, të këtij ligji;
- b) të ardhura të tjera të krijuara nga burime të tjera të ligjshme, përfshirë:
 - i. financime dhe grante;
 - ii. fondet e përfituara nga marrëveshjet ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave dhe donatorëve të ndryshëm;
- c) buxheti i shtetit.

Fondi Social i Punësimit përdoret për programe që synojnë punësimin, vetëpunësimin, rehabilitim për punë, aftësimin dhe riaftësimin profesional, orientimin dhe këshillimin për punësim, shërbime mbështetëse, rikonstrukcion dhe përshtatje të vendit të punës të personave me aftësi të kufizuara, *programe riintegrimi social*, mbështetje për nxitjen e punësimit të familjarëve të personave me aftësi të kufizuara. Të ardhurat e Fondit Social të Punësimit, nuk mund të përdoren për qëllime të tjera, përveç atyre të parashikuara me këtë ligj. Ligji për punësimin parashikon që punëdhënësi, i cili nuk punëson numrin e përcaktuar të personave, nga grupet e disavantazhuara (persona me aftësi të kufizuara), derdh një kontribut për llogari të Fondit Social të Punësimit, në masën e 100 për qind të pagës minimale në shkallë vendi, për çdo muaj, për çdo person që i përket këtyre grupeve, që ai duhet të kishte punësuar, sipas këtij ligji.

Ligji nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit” nuk ka shfuqizuar aktet nënligjore të ligjit të mëparshëm nr. 7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”. I vetmi akt nënligjor në zbatim të këtij ligji të ri është vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, i Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA)”, i cili përcakton përgjegjësitë funksionale të AKPA-së, organizimin dhe funksionimin e saj, si dhe krijimin e këshillit konsultativ për punësimin dhe sekretariatit teknik. Në vijim paraqiten aktet nënligjore që i referohen ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar,

dhe vazhdojnë të jenë në fuqi deri në plotësimin e ligjit të ri me aktet nënligjore përkatëse në zbatim të tij.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 101, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, përcakton mënyrën e organizimit dhe funksionimit të agjencive private të punësimit. Këto agjenci private të punësimit janë private dhe punëkërkuesi aftësohet në profesionin e synuar dhe më pas është i gatshëm tashmë me një profesion për tregun e punës, ndërkohë që mund të punësohet po në subjektin në të cilin është formuar profesionalisht.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 16.1.2008, “Programi i nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit në punë”, i ndryshuar, synon të mbështesë punëkërkuesit e papunë në marrjen e një profesioni në vendin e punës. Përfitues të këtij programi janë punëkërkuesit e papunë që aftësohen përmes punës, ata ndërkohë që mund të punësohet po në subjektin në të cilin është formuar profesionalisht.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 16.1.2008, “Programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë në vështirësi”, parashikon punësimin e punëkërkuesve të papunë afatgjatë. Përfitues të këtij programi janë punëkërkues të papunë nga gupe të veçanta. Punësohen për 12 muaj, pra ky program siguron dhe mbështet punësimin e plotë të kësaj kategorie punëkërkuesish. Ky program është i fokusuar te një sërë grupesh vulnerabël për t’i integruar ato në tregun e punës – të papunët afatgjatë; personat, që përfitojnë ndihmë ekonomike; personat, që përfitojnë pagesë papunësie; personat, që hyjnë për herë të parë në tregun e punës, të moshës 18-25 vjeç; personat mbi 45 vjeç, që nuk kanë një arsimim më të lartë se arsimi i mesëm ose ekuivalent të tij; personat me aftësi të kufizuara; personat nga komuniteti rom; emigrantët e kthyer me probleme ekonomike; viktimat të trafikimit.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 27.12.2006, “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programeve të praktikave profesionale për punëkërkuesit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit”, siguron marrjen e praktikës profesionale e cila organizohet në ambientet e punës, si në ato private edhe në ato shtetërore ku studentët aftësohen dhe përfitojnë vetitë/aftësitë e profesionit të studiuar.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 27, datë



11.1.2012, “Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta”, mbështet punësimin e plotë të femrave për një periudhë 12 mujore. Kategoria e femrave pjesëmarrëse përcaktohet si: femra të papuna për një periudhë afatgjatë (më shumë se 1 vit); femra që përfitojnë nga programe të NE-së; femra të trafikuar; femra mbi 50 vjeç; femra romë; femra me aftësi të kufizuara; vajza nëna; femra të divorcuara me probleme sociale; femra që kthehen nga emigracioni me probleme ekonomike. Punësimi i kësaj kategorie është përmirësimi i jetës sociale dhe angazhimi i tyre në tregun e punës por që ka impakt në të gjithë mekanizmat e shoqërisë.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 30.4.2014 “Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara”, i ndryshuar, përcakton masën e financimit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara për punëdhënësin dhe punëmarrësin, si edhe masën e financimit për formimin në punë të personave me aftësi të kufizuara.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 64, datë 27.1.2016 “Për programin e nxitjes së punësimit të rinjve që kanë fituar statusin e jetimit”, i ndryshuar, mbështet punëkërkuarët e rinj, nën moshën 30 vjeç, të cilët kanë statusin e jetimit, përmes programit të formimit nëpërmjet punës dhe programit të punësimit, duke financuar punëdhënësin.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 11.1.2012, “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimit të punëkërkuarëve të papunë që hyjnë për herë të parë në punë”, mbështet punëkërkuarët e papunë të grup-moshës së re nga 16–25 vjeç duke i ndihmuar ata në gjetjen e një pune dhe në punësimin e tyre. Me anë të këtij vendimi, punëdhënësit të cilët punësojnë për herë të parë të rinj të cilët nuk kanë përvojë të mëparshme pune mund të përfitojnë një financim mujor në masën 100% të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore të pjesës së kontributit të punëdhënësit me kusht që kontrata e punës të jetë jo më e shkurtër se 6 muaj.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 162, datë 21.3.2018, “Për pagesën e pjesëmarrjes në kurset e formimit profesional”, nxit pjesëmarrjen në kurse të aftësimit profesional të punëkërkuarëve të papunë. Ky vendim parashikon që punëkërkuarët e

pa punë, të cilëve u është ofruar dhe kanë pranuar të marrin pjesë në një kurs të formimit profesional, mund të përfitojnë një pagesë pjesëmarrëse në kurs, në masën 50% të së ardhurës nga papunësia, me kusht që ata të mos përfitojnë gjatë kësaj periudhe ndihmën ekonomike ose gjithë pagesën e papunësisë. Pagesa jepet për ndjekjen vetëm të një kursi, gjatë gjithë kohëzgjatjes së tij dhe në rastet kur vendbanimi i punëkërkuarëve të papunë është mbi 2 km larg institucionit ofrues të kursit të formimit profesional, zyra e punësimit paguan një kosto mujore transporti, në masën e përcaktuar në kuadrin ligjor për tarifat e transportit të udhëtarëve.

2.3 Marrëveshja ndërmjet SHSSH-it dhe zyrave të punësimit

Shërbimit Kombëtar i Punësimit dhe Shërbimit Social Shtetëror kanë nënshkruar marrëveshjen nr. 308, datë 15.2.2018, “Për punësimin dhe integrimin në tregun e punës të anëtarëve në moshë aktive pune të cilët janë përfitues të skemës së ndihmës ekonomike”.

Kjo marrëveshje ka për qëllim integrimin në tregun e punës të personave në moshë aktive pune të cilët janë anëtarë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike apo familjeve që kanë dalë nga skema e ndihmës ekonomike dhe nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të siguruar plotësimin e nevojave bazë jetike, si edhe koordinimin e punës dhe bashkëpunimin e ndërsjellë mes Shërbimit Social Shtetëror dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit (sot e ashtuquajtur “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësisë”).

Objekt i kësaj marrëveshje është ndërtimi i një marrëdhënieje dypalëshe me qëllim shërbimin e institucionalizuar dhe ndihmën ndaj këtij kontingjenti për një jetë më të mirë dhe dinjitoze përmes bashkëpunimit institucional, për të bërë të mundur integrimin e tyre në shoqëri dhe në tregun e punës nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të punësimit dhe përfshirjes në programet aktive të tregut të punës.

Shërbimi Social Shtetëror i siguron Shërbimit Kombëtar të Punësimit të dhënat për anëtarët në moshë pune të familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike dhe të atyre që refuzohen nga skema e ndihmës ekonomike si edhe cakton pikat e kontaktit për SHKP-in.

Shërbimi Social Shtetëror nëpërmjet strukturave vartëse dhe administratorëve shoqërorë të bashkive/njësisë administrative angazhohen të



orientojnë personat e aftë për punë nga familjet e përjashtuara nga skema e ndihmës ekonomike, të regjistruhen pranë zyrave të punësimit për të mundësuar përfitimin nga shërbimet dhe programet që ato ofrojnë, këshillim, ndërmjetësim për punë, formim profesional apo pjesëmarrje në programet e nxitjes së punësimit.

Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP) i siguron Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH) informacion mujor lidhur me të dhënat mbi anëtarët në moshë pune të familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike të cilët janë punëkërkues aktivë dhe iu është ofruar shërbim në sportelet e zyrave të punësimit/janë pjesëmarrës në kurset e formimit profesional, janë çregjistruar për arsye punësimi/përfshirë pjesëmarrjen në programet e nxitjes së punësimit apo kanë humbur statusin e punëkërkuesit e të papunë për arsye të refuzimit të shërbimeve dhe programeve të ofruara nga zyra e punësimit.

SHKP-i i siguron informacion për personat e intervistuar dhe vlerësuar mbi aftësitë, njohuritë dhe pritshmëritë për punësim, mbi anëtarët në moshë pune të familjeve që refuzohen nga skema e ndihmës ekonomike të cilët janë paraqitur në sportelet e zyrave të punësimit dhe informacion mbi rastet që janë ndërmjetësuar për punë dhe sa kanë përfituar nga programet e formimit profesional.

SHKP-i cakton pikat e kontaktit në nivel rajonal e qendror për SHSSH-in dhe mban përgjegjësi për cilësinë e të dhënave të regjistrimit për çdo person, punëkërkues aktivë apo të çregjistruar për saktësinë dhe përditësimin e tyre në regjister rast pas rasti.

I gjithë informacioni i shkëmbyer mes palëve realizohet përmes sistemeve respektive të menaxhimit të informacionit, që nga viti 2018.

Përgjegjësitë ligjore për formulimin e politikave në lidhje me ndihmën ekonomike dhe nxitjen e punësimit kryhet nga dy institucione të veçanta, përkatësisht Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për NE-në dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për Nxitjen e Punësimit. Zbatimi i këtyre politikave kryhet nga institucione të veçanta në varësi nga ministritë përkatëse me rrjet në çdo qark të vendit, përkatësisht Shërbimi Social Shtetëror në varësi të MSHMS-së dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësisimit (AKPA) në varësi të MFE-së. Bashkëpunimi institucional ndërmjet këtyre institucioneve zbatuese, aktualisht kryhet përmes një instrumenti si marrëveshje

bashkëpunimi (e cila ka nevojë të përditësohet për të reflektuar ndryshimet e ndodhura kalimin nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit tek AKPA-ja), përmbushja e së cilës me shumë bazohet te vullneti i palëve sesa ndonjë detyrimi ligjor për zbatimin e saj, për shkak të hierarkisë së ulët ligjore që përfaqëson në vetvete marrëveshja ndërinstitucionale përkundër akteve të tjera nënligjore.

Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë dhe ligji nr. 157/2019 “Për nxitjen e punësimit” janë të pabarmonizuar dhe nuk sigurojnë lidhjen organike për arritjen e objektivit strategjik të riintegritimit social të përfituesve të ndihmës ekonomike të alternuar me skemat dhe programet e punësimit. Legjislacioni në lidhje me asistencën sociale është i paplotësuar me aktet nënligjore të nevojshme për zbatimin e tij. Ligji i ri i asistencës sociale ka shfuqizuar të gjitha aktet nënligjore që bien në kundërshtim me këtë ligj. Për më tepër ligji i ri për nxitjen e punësimit, gjithashtu, është i paplotësuar me aktet nënligjore, situatë e cila mund të çojë në pasiguri dhe boshllëqe në zbatimin e këtij legjislacioni, edhe pse ndryshe nga ligji për asistencën sociale, ky ligj nuk i ka shfuqizuar aktet nënligjore në zbatim të tij.

Ligji i ri për asistencën sociale parashikon kufizimin në kohë të përfitimit të asistencës sociale, por nuk përcakton afatin kohor për daljen nga skema ndihmës ekonomike (sipas këtij ligji kjo do të bëhet me VKM të veçantë) dhe as kriteret dhe procedurat për ata përfitues të cilët kalojnë afatin ekzistues prej 5 vjetësh si përfitues të NE-së dhe si riaplikojnë për të qenë përfitues.

Ligji për nxitjen e punësimit nuk parashikon një program të nxitjes së punësimit, i cili të targetojë specifikisht punëkërkuesit e papunë përfitues të ndihmës ekonomike. I vetmi program i cili adreson disi këtë target grup është ai i punëkërkuesve të papunë në vështirësi, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 48/2008, datë 16.1.2008, “Programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë në vështirësi”, i ndryshuar. Megjithatë, ky program mbulon një kategori të gjerë punëkërkuesish të papunë, pa u fokusuar te punësimi ekskluziv i kësaj kategorie që merr NE-ja.

Ligji për nxitjen e punësimit nuk parashikon kushte dhe kriteret që duhet të përmbushë një punëdhënës për punësimin e individëve përfitues të NE-së, sikundër parashikon kushte dhe kriteret që



punëdhënësi duhet të përmbushë në rastin e punësimit të kategorisë së personave me aftësi të kufizuara. Është i nevojshme plotësimi i legjislacionit në lidhje me vënien në funksionim të Fondit Social të Punësimit, i cili është një instrument i parashikuar në këtë, por ende i pazbatuar.

2.4 Legjislacion në mbështetje të integritetit ekonomik dhe social të grupeve në nevojë

Ndërmarrjet sociale

Ligji nr. 65/2016, “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij rregullojnë organizimin dhe funksionimin e ndërmarrjeve sociale dhe përcaktojnë kushtet e kriteret që një subjekt duhet të plotësojë që të përfitojë statusin e ndërmarrjes sociale.

Ligji ka për qëllim të rregullojë veprimtarinë e ndërmarrjeve sociale, për mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël, nëpërmjet: i) punësimit, ii) ofrimit të mundësive për punësim kur mosha, shëndeti dhe gjendja familjare nuk u lejon një disponueshmëri aktive në tregun e punës; iii) ofrimit të mallrave dhe shërbimeve; dhe iv) *integritetit ekonomik e social të grupeve në nevojë*, duke nxitur frymën e përgjegjshmërisë, solidaritetit dhe kohezionit shoqëror në komunitet.

Ky ligj zbatohet për personat juridikë që ushtrojnë veprimtarinë si ndërmarrje sociale, duke krijuar kushte të përshtatshme për punësim të individëve të pafavorizuar në tregun e punës.

Një ndër kriteret ekonomike që duhet të plotësojë një ndërmarrje sociale për të pasur këtë status është kriteri që përcakton se të paktën, 20 për qind e të ardhurave, pas vitit të dytë të aktivitetit dhe, të paktën, 30 për qind e të ardhurave, pas vitit të tretë e në vijim të aktivitetit, duhet të realizohen nga veprimtaritë që lidhen me ndërmjetësim për punësim, punësim, shërbime shoqërore, arsim etj. Ndërsa një ndër kriteret sociale ka të bëjë me kushtin që të paktën, 30 për qind e punonjësve të punësuar në ndërmarrjen sociale duhet t'i përkasin kategorisë së grupeve të pafavorizuara nga pikëpamja sociale dhe ekonomike, të tilla si grupet me probleme të varfërisë ekstreme, përjashtimit social për shkak të diskriminimit, papunësisë afatgjatë, vështirësive për shkak të të qenit i proceduar penalisht apo nën varësinë e drogës dhe alkoolit, dhe personat e shpërngulur.

Ndërmarrjet sociale kanë mundësinë të mbështeten nga shteti, nëpërmjet subvencionimit të ndërmarrjeve ose punonjësve në këto subjekte. Format e mbështetjes, nëpërmjet subvencionit, janë përcaktuar përkatësisht me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 789, datë 26.12.2018, “Për krijimin e fondit në mbështetje të ndërmarrjeve sociale dhe format e mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale”.

Ky vendim parashikon një fond mbështetës për ndërmarrjet sociale në masën 249,760,000 lekë, për periudhën 2019–2021, nga të cilat 37,000,000 lekë për krijimin e vendeve të reja të punës, 7,776,000 lekë për sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve të ndërmarrjeve sociale që i përkasin grupeve të pafavorizuara dhe pjesa tjetër për veprimtarinë e tyre, duke paraqitur një plan biznesi për ndërmarrjen sociale.

Subjekti duhet që të punësojë minimalisht 3 punonjës të rinj nga kategoritë e grupeve të pafavorizuara, brenda 12 muajve nga momenti i përfitimit të subvencionit për zhvillimin e veprimtarisë në ndërmarrjen sociale.

Subvencion për krijimin e vendeve të reja të punës, përfitojnë ato ndërmarrje sociale që paraqesin propozime që reflektojnë rritjen e numrit të të punësuarve me përfaqësues nga grupet e pafavorizuara. Dhënia e subvencionit kushtëzohet me punësimin e personave nga kategoritë e grupeve të pafavorizuara dhe kohëzgjatja e kontratës të jetë jo më pak se 2 vjet.

Krijimi i fondit në mbështetje të ndërmarrjeve sociale është konsideruar si skemë e ndihmës shtetërore dhe është përcaktuar si e tillë me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 85, datë 25.6.2018, të Komisionit të Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 10, germa “a” dhe “b”, 13 germa “c”, 22, pika 2, 30 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 16, datë 12.1.2018, “Për miratimin e listës së veprimtarive që ushtrojnë ndërmarrjet sociale”, përcakton llojet e veprimtarisë që mund të ushtrojë një ndërmarrje sociale, e cilat duhet të:

- kontribuojë në përmbushjen e objektivave sociale;

- krijojë mundësi të reja për punësim dhe një mjedis inkurajues për integrimin social e riintegrimin profesional të grupeve të pafavorizuara në tregun e punës;



- ofrojë mallra e shërbime në përputhje me nevojat e komunitetit;

- përfshijë fushën e shërbimeve shoqërore, shëndetësore, kulturore e arsimore, të promovimit të turizmit e mbrojtjes mjedisore, si dhe veprimtari të ndërmjetësimit e kualifikimit për punësim.

Ndërmarrjet sociale në fushën e kualifikimit dhe të ndërmjetësimit për punësim, duhet të ushtrojë veprimtari për promovimin e trajnimit profesional, veprimtari edukative e të ndërmjetësimit për punësim për personat që përfshihen në kategoritë e grupeve të pafavorizuara.

Ndërmarrjet sociale duhet të kryejnë edhe veprimtari tregtimi mallrash apo shërbimesh, të ofruara nga veprimtari të ndërmarrjeve të tjera sociale, produkte për personat e pafavorizuar, produkte të prodhuesve të vegjël nga zona të thella apo të pafavorshme nga ana mjedisore, si dhe të tjera veprimtari në mbështetje të ndërmarrjeve të tjera sociale.

Ndërmarrjet sociale në fushën e prodhimit, duhet të kryejnë veprimtari që lidhen me prodhimin artizanal të një game të gjerë mallrash e produkteve që i shërbejnë komunitetit dhe, veçanërisht, produkteve që kanë për qëllim krijimin e lehtësive për personat e pafavorizuar.

Grupet e pafavorizuara, subjekt i ligjit për ndërmarrjet sociale përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 56, datë 31.1.2018, “Për përcaktimin e kategorive konkrete të grupeve të pafavorizuara nëpërmjet punësimit dhe lehtësimit të aksesit në tregun e punës”. Ky vendim përcakton grupet e personave të pafavorizuara, të cilat përfshijnë persona në kushte të pafavorshme: i) përfituesit e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar në moshë aktive pune, ii) personat e ekspozuar ndaj një pune të pasigurt e të paqëndrueshme dhe që rrezikohen të përballen me vështirësi të shumta në integrimin e tyre në tregun e punës; iii) të papunët për një periudhë afatgjatë prej të paktën 12 muajsh; iv) personat që u përkasin pakicave kombëtare; v) persona që i përkasin moshës mbi 50 vjeç; vi) gratë dhe vajzat viktimë/viktima të mundshme të trafikimit, të shfrytëzimit dhe të dhunës në familje etj.

Biznesi social

Ligji nr. 10376, datë 10.2.2011 “Për krijimin e shoqërisë ‘Nxitja e Biznesit Social’ sh.a.” dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 391, datë 1.6.2011, “Për miratimin e statutit të shoqërisë

‘Nxitja e Biznesit Social’ sh.a.” (i ndryshuar) përbëjnë bazën ligjore për nxitjen dhe mbështetjen e biznesit social në Republikën e Shqipërisë. Biznes social është biznesi që adreson një problem social dhe mjedisor, ku fitimi i realizuar nuk shpërndahet, por rinvestohet në përmirësimin e veprimtarisë brenda biznesit social ose në biznese të tjera sociale fusha e veprimtarisë së shoqërisë “Nxitja e Biznesit Social” është zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe social nëpërmjet nxitjes së zhvillimit të biznesit social, të qëndrueshëm, të balancuar dhe koheziv, në nivel kombëtar.

3. KUADRI INSTITUCIONAL

Kryeministria

Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes dhe Njësia e Politikave për Zhvillim dhe Mirëqeverisjes, janë strukturat përgjegjëse pranë Kryeministrit që kanë në fokus të punës së tyre koordinimin e strategjive, politikave dhe projekteve në të gjitha fushat e veprimtarisë shtetërore.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave e të strategjive të zhvillimit në sektorin e kujdesit shëndetësor, është përgjegjëse për rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe për bashkërendimin e punës ndërmjet të gjithë aktorëve, brenda dhe jashtë sistemit të kujdesit shëndetësor, të cilët kontribuojnë dhe synojnë të garantojnë të drejtën kushtetuese, të përcaktuar në nenin 55 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ajo ka si mision, gjithashtu, garantimin e të drejtave kushtetuese për mbrojtje e përfshirje sociale dhe përkujdesje sociale e shanse të barabarta.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është autoriteti përgjegjës për hartimin e politikave, të programeve dhe legjislacionit, programimin e fondeve për programin e ndihmës ekonomike, si dhe kontrollin e zbatimit të tyre në të gjitha nivelet e strukturave qendrore dhe vendore.

Kjo ministri propozon mekanizmin e bashkërendimit ndër-institucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, për të siguruar riintegrimin social të tyre, nëpërmjet një programi daljeje nga skema e ndihmës ekonomike.

Grumbullimi i të dhënave statistikore për



ndihmën ekonomike ka për qëllim vlerësimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave të ndihmës ekonomike në vazhdimësi.

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, struktura që merret me hartimin dhe zhvillimin e politikave, programeve dhe legjislacionit për ndihmën ekonomike është Drejtoria e Programeve të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, e cila ka në varësi sektorin e programeve të zhvillimit të ndihmës ekonomike.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka për mision arritjen e stabilitetit ekonomik nëpërmjet drejtimit me eficiencë, efektivitet dhe transparencë të financave publike. Me riorganizimin e Qeverisë në vitin 2017, MFE-ja ka edhe kompetencat e hartimit të politikave të punësimit. MFE-ja në këtë aspekt kryen: i) analiza periodike tendencat e tregut të punës dhe parashikon zhvillimet e tij; ii) harton politika të reja për rritjen e punësimit dhe uljen e papunësisë; iii) harton programe dhe merr masa për nxitjen e punësimit e të vetëpunësimit; iv) harton programe për mbështetjen e ofruesve të arsimit e të formimit profesional, duke përfshirë ofrimin e kualifikimit fillestar dhe të vazhduar; v) zbaton marrëveshjet ndërkombëtare për punësimin.

Zbatimi i politikave publike të punësimit kryhet nëpërmjet institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, që ngrihet sipas parashikimeve të këtij ligji, dhe strukturave rajonale/vendore në varësi të saj. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Makroekonomisë, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit është atashuar Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional, e cila është struktura përgjegjëse për hartimin dhe zhvillimin e politikave dhe të legjislacionit në fushën e punësimit dhe të aftësimit profesional.

Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH)

Shërbimi Social Shtetëror është një institucion ligjzbatues në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i cili ka për mision zbatimin e politikave, legjislacionin e ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimeve shoqërore në të gjithë vendin.

Shërbimi Social Shtetëror është i organizuar në nivel qendror dhe rajonal dhe përgjigjet për zbatimin e politikave të asistencës sociale në ministri:

- për programimin dhe kontrollin e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për asistencën sociale;

- administrimin dhe përdorimin e të dhënave të Regjistrit Elektronik Kombëtar të ndihmës ekonomike;

- kontrollin dhe monitorimin e veprimtarisë e të zbatimit të legjislacionit të ndihmës ekonomike, në strukturat dhe institucionet në varësi të tij dhe pranë njësive të vetëqeverisjes vendore;

- grumbullimin dhe përpunimin e informacioneve dhe të statistikave;

- bashkëpunimin e vazhdueshëm me Shërbimin Kombëtar të Punësimit për riintegrimin social të anëtarëve të familjeve në nevojë, të cilët janë në moshë aktive pune;

- vendimmarrjen për dhënien ose jo të ndihmës ekonomike për familjet dhe individët në nevojë, si edhe për ndërprerjen e saj në rastet e konstatimit të abuzimeve.

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA)

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive është institucioni ligjzbatues në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Misioni i AKPA-së është të sigurojë përmbushjen e të drejtës së shtetasve shqiptarë, të huaj dhe pa shtetësi të huaj, që kanë përfituar statusin e refugjatit si dhe të azilkërkuesit në territorin e Republikës së Shqipërisë, për t'u trajtuar me shërbime dhe programe publike të punësimit, të vetëpunësimit dhe të kualifikimeve profesionale, me qëllim gjetjen e një pune të përshtatshme, brenda dhe jashtë vendit, si dhe ofrimin e këtyre shërbimeve.

AKPA-ja e shtrinë veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet, në nivel qendror, nëpërmjet drejtorisë qendrore, në nivel rajonal, nëpërmjet drejtorive rajonale dhe në nivel vendor, nëpërmjet zyrave vendore.

Disa nga përgjegjësitë e strukturave të AKPA-së në nivel qendror e rajonal, janë:

- të garantojë nivelin e cilësisë së shërbimeve të ofruara për punësimin, vetëpunësimin dhe arsimin e formimit profesional, nëpërmjet monitorimit dhe vlerësimit;

- administrimin dhe zbatimin e programeve aktive e pasive të tregut të punës;

- administrimin e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional (AFP);



- administrimin dhe monitorimin e zbatimit me cilësi të programeve të nxitjes së punësimit si dhe bashkëpunon me aktorë të tretë për ofrimin dhe zbatimin me cilësi e në kohë të programeve të nxitjes së punësimit; c) administron dhe monitoron procesin e zbatimit të programit të pagesës të të ardhurave nga papunësia, në zbatim të legjislacionit përkatës;

- kryen hulumtime periodike në tregun e punës për numrin e të punësuarve, për kushtet e punës, procesin e rekrutimit, mungesën e aftësive apo të nevojave për trajnim;

- monitoron zbatimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve të punësimit dhe të ofruesve të formimit e arsimit profesional;

- kryen studime periodike për tregun e punës apo të një pjese të tij, në nivel kombëtar dhe rajonal;

Në nivel rajonal e vendor, përgatitin planin e punësueshmërisë, në bazë të analizës së tregut rajonal dhe vendor të punës; zbatojnë programet aktive të tregut të punës; dhe të mbështetjes me të ardhura nga papunësia; sigurojnë dhe shpërndajnë informacionin mbi tregun rajonal të punës; si edhe bashkëpunojnë me institucione dhe organizma të tjerë, që zbatojnë programe të ndryshme punësimi apo mbrojtjeje sociale.

Pushteti vendor – bashkitë

Ndihma ekonomike për pushtetin vendor është një funksion i deleguar, strukturat përgjegjëse për ndihmën ekonomike në nivel bashkie janë drejtoritë e shërbimeve sociale, ndërsa në nivel njësie administrative janë sektorët e ndihmës ekonomike, pranë të cilave është atashuar administratori shoqëror i ndihmës ekonomike.

Në nivel bashkie drejtoritë e shërbimeve sociale kryejnë këto detyra:

- dërgon nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar listën e plotë të familjeve/individëve në nevojë nën juridiksionin e bashkisë pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror për trajtim me ndihmë ekonomike;

- harton kërkesën për buxhetin dhe projektbuxhetin për vitin pasardhës për ndihmën ekonomike;

- grumbullon dhe përgatit informacione e statistika, të cilat i dërgon pranë strukturave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, mban regjistrin e përfituesve dhe ndjek shpenzimet për ndihmën ekonomike;

- monitoron punën e administratorit shoqëror pranë njësisë administrative;

- bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me zyrat vendore të punësimit për riintegrimin social të anëtarëve të familjeve në nevojë, të cilët janë në moshë aktive pune.

Në nivel njësie administrative, administratorët shoqërorë kanë për detyrë të kryejnë këto detyra:

- të identifikojnë familjet dhe individët në nevojë dhe t'i ftojnë e t'i informojnë për aplikim për ndihmë ekonomike;

- të plotësojnë aplikimin për familjet dhe individët në nevojë në Regjistrin Elektronik Kombëtar;

- të verifikojnë nëpërmjet vizitave në familje dhe në terren gjendjen social-ekonomike për familjet që aplikojnë/trajtohen me ndihmë ekonomike;

- të paraqesin pranë drejtorisë së shërbimeve sociale në bashki, nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar, listën e familjeve/individëve në nevojë që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike;

- të evidentojnë dhe të verifikojnë rastet e personave që përfitojnë në kundërshtim legjislacionin në fuqi;

- të bashkërendojnë informacionin lidhur me familjet përfituese me administratorët e tjerë shoqërorë të njësisë të vetëqeverisjes vendore;

- të informojnë dhe të udhëzojnë komunitetet lidhur me skemën e ndihmës ekonomike, me anë të fushatave të ndryshme informuese;

- të bashkëpunojnë me punonjësit socialë dhe njësitë e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rasteve në njësinë e vetëqeverisjes vendore, për përfituesit e ndihmës ekonomike për ti trajtuar me shërbime sociale;

- të adresojnë rastet e individëve/familjeve në nevojë drejt programeve të tjera sociale, shëndetësore e të punësimit, me qëllim rehabilitimin dhe integrimin e tyre në jetën shoqërore;

- të referojë dhe ofrojë shërbime sociale, shërbime të specializuara në qendra multifunksionale, aksesin në kopshte, çerdhe, strehim social etj.

- të hartojnë kërkesa për fonde dhe statistika për ndihmën ekonomike.



4. EKSPERIENCAT NDËRKOMBËTARE RRETH PROGRAMEVE TË DALJES NGA SKEMA E NE-së

Ky seksion paraqet një përmbledhje të kontekstit ndërkombëtar të përshtatshëm për zhvillimin e një strategjie daljeje nga skema e NE-së për përfituesit bazuar në modelin inovativ dhe provat ndërkombëtare për sa i përket funksionimit të saj. Fokusi kryesor i tij është në programet e promovimit të punësimit që synojnë integrimin ose riintegrimin në forcën e punës të personave të varfër dhe personave të papunë.

Mbështetja e kalimit nga kujdesi social në punësim

Qeveritë që marrin iniciativë për mirëqenie për punë motivohen nga një spektër faktorësh. Fillimi i programeve të mirëqenies për punë në ditët moderne mund të vihen re në mes të Depresionit të Madh, kur në vitin 1935 marrëveshja e re e Presidentit të SHBA-së F. D. Ruzvelt prezantoi programin e parë federal të mirëqenies në vend, i cili përfshinte programe të punëve publike për burra të papunë. Sidoqoftë, rrallë ekziston një shtytës i vetëm ekonomik, shoqëror ose politik për një qeveri që fillon një program të mirëqenies për punë. Ndryshimet demografike, zhvendosjet e tregut të punës, varfëria, një predispozitë për indolencë, të gjithë mund të jenë nxitës të tillë.

Reformat ndërkombëtare të kujdesit social i kanë qëndruar gjerësisht një prirje e cila karakterizohet prej një ndryshimi nga politika social pasive që janë të kufizuara në përmbushjen e nevojave të përfituesve prezentë, në politika sociale aktive, të cilat i japin përparësi integritit të përfituesve socialë në tregun e rregullt të punës. Ndërsa ka formate të ndryshme, fusha të ndryshme dhe risi të politikave në të gjithë vendet; në thelb ka dy lloje kryesore të programeve të kalimit nga kujdesi social në punësim:

- Ata që ofrojnë shërbime për të inkurajuar punësimin e drejtpërdrejtë dhe për të hequr individët nga skemat e përfitimeve dhe përfshirja direkt në forcën e punës.

- Ata që synojnë të rrisin kapitalin njerëzor duke ofruar trajnime dhe arsimim në mënyrë që të rrisin punësueshmërinë e atyre që aktualisht kërkojnë përfitime.

Sot, praktikisht të gjitha regjimet e kalimit nga kujdesi social në punësim, nga marrësit e përfitimeve kërkojnë të plotësojnë disa kërkesa për

pjesëmarrje që të vazhdojnë të marrin përfitimet e tyre të mirëqenies. Këto kërkesa shpesh janë një kombinim i aktiviteteve që kanë për qëllim të përmirësojnë perspektivën e punës së marrësit (të tilla si: trajnime, rehabilitim dhe përvojë pune) dhe ato të përcaktuara si kontribuese në shoqëri (të tilla si punë e papaguar ose me pagë të ulët).

Mosarritja e kërkesave të regjimeve të kalimit nga kujdesi social në punësim shoqërohet me penalitete që synojnë dekurajimin e kulturës së varësisë nga kujdesi social dhe përtacisë. Penalitetet për pjesëmarrësit e programit që nuk përmbushin angazhimet e tyre mund të jenë të ashpra si në SHBA dhe në Mbretërinë e Bashkuar dhe mund të sjellin zvogëlimin ose heqjen e përfitimit. Të tjerë, siç është Irlanda, theksojnë mbështetjen për pjesëmarrësit; Irlanda është më tolerante në lidhje me sanksionet sesa shumica e vendeve të tjera. Duke marrë parasysh ndikimin e mundshëm negativ të sanksioneve, sistemi irlandez merr parasysh ndikimin që do të kishin këto tek ata që janë të varur, veçanërisht fëmijët; duke pranuar se kufizimet në përfitime mund të zgjasin dhe përkeqësojnë treguesit e varfërisë.

Perspektivat ndërkombëtare

Ky seksion konsideron politikën dhe dimensionet operationale të programeve të mirëqenies për punë me regjime të ndryshme të politikave sociale, ndërsa tabela e bashkangjitur ofron një përmbledhje të gatshme të aspekteve kryesore të skemave në njëzet e tri vende.

Shtetet e Bashkuara dhe Mbretëria e Bashkuar

Në Shtetet e Bashkuara, Akti i Përgjegjësisë personale dhe Mundësisë për Pajtimin e Punës në 1996 u bë baza ligjore për programet e mirëqenies për punë. Kalimi nga mirëqenia për punë tentonte sigurimin e stimujve për shtetet për të përfshirë përfituesit e mirëqenies në forcën e punës, ndërkohë që vendoste afatet kohore për pranueshmerinë e të papunëve për të përfituar si dhe kërkesa strikte pune apo dhe pasoja serioze për ata të cilët zgjidhnin programin ndaj rregullave të pjesëmarrjes në punë. Aplikimi i këtij modeli ka shkaktuar një rënie dramatike të kërkesave për mirëqenie nga të papunët. Që nga miratimi i ligjit, pjesëmarrja në skemat e mirëqenies për punë ka qenë më e ulët në krahasim me numrin e kërkuarve të papunë që në fakt janë caktuar për pjesëmarrje në skemat e mirëqenies për punë – kryesisht për



shkak të mungesës së aftësive nga ana e organizatave që zbatojnë skema të cilat ofrojnë nivele intensive të mbështetjes dhe trajnimit për pjesëmarrësit.

Mbretëria e Bashkuar ndoqi shumë të njëjtin model më 1997-n, megjithëse masat për mirëqenien për punë u konsoliduan në programin e punës më 2011-n. EP2011 nxori detyrën e bërjes të mundur të punësimit të të papunëve afatgjatë në një gamë të sektorit publik, sektorit privat dhe organizatave të sektorit të tretë, të cilat u nënshtroheshin kontratave me pagesa në bazë të rezultateve, sipas të cilave organizatat paguhen vetëm për gjetjen e punës për njerëzit.

Kutia 2: Mbretëria e Bashkuar, një shembull i ndihmës së limituar në gjetjen e punës për njerëzit

Regjimi i mirëqenies për punë në Mbretërinë e Bashkuar është i karakterizuar nga një sistem i dobët mbështetjeje për njerëz të papunë që kërkojnë punë dhe një grup i fortë sanksionesh që janë të aplikuara tek ata që nuk përmbushin kërkesat e zakte; për shembull, mungesa ose ardhja me vonesë për takimet në zyrën e punësimit. Një tipar tjetër i sistemit të mirëqenies për punë është që menaxhimi i tij është i kontraktuar jashtë sipërmarrjeve komerciale, të cilat janë paguar në bazë të rezultateve, dhe kanë iniciativë për të përqendruar përpjekjet e tyre në ata kërkuar që duket se janë më të suksesshëm në mbajtjen e punës. Nga ata që marrin pjesë në programin e mirëqenies për punë, rreth 62% kthehen në gjendje papunësie brenda dy viteve të para. Afërsisht dy të tretat e njerëzve që marrin pjesë në program janë meshkuj. Rreth 5% e pjesëmarrësve në program i nënshtrohen çdo muaj sanksioneve. Arsyet kryesore për sanksionimin janë dështimi në kërkimin aktiv për punë, në pjesëmarrjen në skemat e trajnimit dhe punësimit ose në realizimin e intervistave. Më shumë se çereku i sanksioneve I janë dhënë njerëzve me aftësi të kufizuara ose nga prindërit e vetmuar. Mbretëria e Bashkuar ka përgjysmuar nivelin e tyre të sanksioneve, më shumë mundësi, sepse nuk ka asnjë provë të qartë që sanksionet ndihmojnë njerëzit të gjejnë punë, dhe “dëmi kolateral” është i papranueshëm. Një studim i fundit nga Universiteti i Nju-Jorkut tregoi që sanksionet e përfitimeve bëjnë shumë pak për të rritur motivimin e njerëzve për t’u përgatitur, për të kërkuar ose për të hyrë në punë të paguar. Ata në mënyrë rutinë shkaktojnë rezultate thellësisht negative personale, financiare, shëndetësore dhe në sjellje.”

Programi i mirëqenies për punë i jep kërkuarëve:

- Këshilla bazike dhe orientuese në kërkimin e punës duke përfshirë përgatitjen e CV-së;

- Kurse në literaturë bazë kompjuteri;

- Për njerëzit e moshave 16–24 vjeçe skema e eksperiencës në punë zakonisht zgjat midis 2 dhe 8 javësh, dhe pjesëmarrësve u kërkohet zakonisht të punojnë midis 25 dhe 30 orësh në javë. Ata gjithashtu do të ndihmohen në lidhje me udhëtimin dhe kujdesin për fëmijët;

- Kërkuarëve mund t’u jepet orientim dhe mbështetje financiare si ndihmë për të filluar biznesin e tyre;

- Punëdhënësit mund të ndihmohen për të ngritur ‘stazhe pune’ që t’u bëjnë të mundur atyre të provojnë rekrutues potencialë.

Në vitin 2015, programi i punës u zëvendësua nga zgjedhja e punës me një program të ri pune dhe shëndetësie për të papunët më afatgjatë dhe ata me kushte shëndetësore. Përfitimi i mirëqenies i njohur më parë si përfitimi i papunësisë është rikrijuar si leja e kërkuarëve të punës. Me kalimin e viteve, Mbretëria e Bashkuar përgjysmoi numrin e sanksioneve të mëparshme të ashpra për njerëzit që nuk respektojnë kushtet për pjesëmarrjen në programin e mirëqenies për punë, teorikisht sepse nuk kishte prova të qarta që sanksionet i ndihmonin njerëzit të gjenin punë, dhe “dëmi kolateral” për kërkuarët të varur për shkak të sanksioneve të tilla u konsiderua i papranueshëm.

Megjithëse regjimi i kalimit nga kujdesi social në punësim i Mbretërisë së Bashkuar synon të ofrojë ndihmë dhe mbështetje të përshtatur, ofrimi i shërbimeve është i përgjithshëm dhe i kufizuar në shkrimin e CV-së, me kërkim për punë rastësore të monitoruara dhe praktikës së intervistimit. ‘Trajnimi’ është i kufizuar gjerësisht në aftësitë kompjuterike që janë raportuar si minimale dhe të synuara në nivelin totalisht fillestar. Pjesëmarrja në qendrat e mirëqenies për punë është zakonisht mujore, me ‘intervista të rishikimit që zgjasin rreth 15 deri maksimumi në 30 minuta. Këto intervista në përgjithësi përbëhen më shumë nga ‘biseda’ për jetën në përgjithësi, sesa ndërhyrje të synuara. Pjesëmarrës më të kualifikuar kanë vërejtur se nuk ka ndonjë dispozitë për njerëzit me kualifikime më të larta që kishin lënë përkohësisht tregun e punës.

Modeli nordik

Politikat sociale në vendet nordike synojnë të arrijnë barazinë sociale dhe kohezionin social, me ofrimin e programeve të mirëqenies të ofruara shpesh në formën e përfitimeve universale dhe jo të kujdesit për kategori të marginalizuara të përfituesve. Përveç pesë vendeve nordike (Danimarka, Finlanda, Islanda, Norvegjia dhe Suedia), modeli gjithashtu është aplikuar edhe nga



Holanda dhe ndikon në juridiksione të tjera të Evropës Veriore, siç është Gjermania. Përkundrajt një sfondi të varfërisë së ulët dhe përfshirjes së lartë sociale, rrjetet e sigurisë së mirëqenies në këto rajone janë të targetuara dhe bujare.

Kutia 3: Suedia, një shembull i mirë në ndihmesën dhënë njerëzve për të gjetur punë

Suedia së bashku me vendet e tjera nordike, ka nevojat e tregut të punës dhe një angazhim për barazi sociale janë parimet dominuese, shpesh vlerësohet si një model roli për politikat e saj të punësimit dhe trajnimit. Bashkëpunimi midis qeverisë dhe biznesit dhe lirisë që u jepet autoriteteve rajonale për të ndjekur zgjidhjet rajonale shihen si forca të vërteta. Në gusht 2019 vihet re se ishin 132000 njerëz të papunë; 76,000 burra dhe 56,000 gra, që përfaqësojnë 7% të fuqisë punëtore. Siç ndodh në Irlandë, sistemi suedez i mirëqenies për punë karakterizohet nga mbështetja gjithëpërfshirëse për njerëzit që kërkojnë punë, sigurime të gjera trajnimi dhe partneritet të ngushtë me biznesin. Një person i regjistruar si i papunë pritet të bëjë një plan individual të veprimit dhe të paraqesë një raport aktiviteti çdo muaj duke përshkruar përpjekjet që ka bërë për të gjetur një vend pune. Shërbimet e lejueshme për të ndihmuar një person që të punësohet përfshijnë:

- Mbështetje për ata që kanë nevojë për mbështetje intensive dhe të përshtatur individualisht ndërkohë që kërkon për një vend pune. Ata asistohen nga një mbikëqyrës i cili i mbështet ata në rrugën e tyre për të punuar ose studiuar.

- Për njerëzit që kanë reduktuar kapacitetet për të punuar për shkak të një paafësie, një punëdhënës mund të marrë një mbështetje financiare për fitimet e tij.

- Për njerëzit që kanë qenë të papunë për një kohë të gjatë, janë skema të reja pune "fillim i ri" që u jep atyre një shans për të filluar sërish.

- Janë një seri skemash trajnimi, arsimi dhe praktikimi.

Programet e kalimit nga kujdesi social në punësim kanë qenë prej kohësh një tipar i politikave gjithëpërfshirëse të tregut të punës në vendet skandinave. Këto programe kanë një theks në zhvillimin e kapitalit njerëzor, dhe politikat e aktivizimit të punës për të arritur një forcë pune të aftë, fleksible, të përshtatur me dinamikën ekonomike dhe zhvillimin teknologjik. Modeli nordik është i karakterizuar nga një angazhim për investime në arsim dhe trajnim të gjatë në karrierë për njerëzit brenda dhe jashtë punës.

Në Danimarkë, që është një ilustrim i mirë i modelit nordik, masat për kalimin nga kujdesi

social në punësim përfshijnë sigurimin e punësimit dhe trajnimit dhe këshillime. Masat e punësimit përbëhen nga lloje të ndryshme të punësimit të subvencionuar, kur personi me ndihmë sociale është përkohësisht i punësuar në një ndërmarrje private ose publike ose merr pjesë në një projekt bashkiak punësimi. Punëdhënësit inkurajohen të punësojnë të papunë afatgjatë me anë të subvencioneve të pagave dhe uljes së taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore. Përfituesit që dështojnë në detyrimet e tyre mund të sanksionohen nga tërheqja e pjesshme dhe për tërheqje të përkohshme të përfitimit.

Modeli mesdhetar

Modeli mesdhetar është karakteristik në vendet që rrethojnë Mesdheun–Portugalinë, Turqinë dhe Ballkanin Perëndimor. Modeli është i bazuar në parimin se familja është thelbësore për të mbështetur njerëzit vulnerabël, dhe mirëqenia ofrohet kryesisht në formën e pensioneve bujare të shoqëruara me tërheqje të parakohshme. Si pasojë, niveli i ndihmës sociale është shumë më i ulët se në vendet e tjera dhe për rrjedhojë nuk është një model efikas për uljen e varfërisë.

Një kombinim, në shumë vende rreth Mesdheut, i varësisë së lartë nga familje të zgjeruara, dërgesat e diasporës dhe aktiviteti ekonomik joformal bëjnë që kalimi nga kujdesi social te punësimi të jetë më problematik për politikë-bërësit sesa në modelet e tjera të kujdesit social. Sidoqoftë, duke qenë se shumë vende të rajonit kanë fituar ose kërkojnë të fitojnë anëtarësim në Bashkimin Evropian, proceset pasuese kanë nxitur zhvillimin e atyre që besohet se janë qasje më efektive për mirëqenie për punë.

Një shembull i tillë është Kroacia, në të cilën strategjia e kalimit nga kujdesi social në punësim promovohet përmes programeve të trajnimit dhe rregullohet përmes kërkesave me kushte për të drejtën e përfitimit. Një kërkuar do të penalizohet nëse refuzon të pranojë ofertën e parë të punës, nuk i përgjigjet një kërkesë ose refuzon të përpiqet të aplikojë për një vend pune të rekomanduar nga Agjencia e Punësimit, nëse nuk raporton për dy muaj radhazi tek Agjencia e Punësimit, ose refuzon të marrë pjesë në një program trajnimi. Administrimi i përfitimeve për të papunët i jepet pushtetit vendor dhe duke përdorur këtë autoritet në vitin 2018, qyteti i Bjelovar hartoi rregullore të reja për të lejuar pagesën e ndihmës sociale vetëm



për njerëzit që marrin pjesë në aktivitete të shërbimit në komunitet. Një kërkesë e ngjashme është prezantuar në Serbi.

Çfarë funksionon në programet e punësimit?

Nëse një program përcaktohet të jetë një sukses apo jo, varet nga ajo çfarë politikë-bërësit duan të arrijnë, pasi llojet e ndryshme të programeve të kalimit nga kujdesi social në punësim theksojnë qëllime të ndryshme.

Një program që ka si qëllim kryesor zvogëlimin e numrit të njerëzve që pretendojnë përfitime mirëqenieje ka më shumë të ngjarë të arrijë qëllimin e tij sesa ai që mat suksesin në bazë të numrit të të papunëve që punësohen. Në rrethanat kur përfitimi i mirëqenies është një element në të ardhurat e një personi, pjesa tjetër bëhet nga dërgesat nga ana e emigrantëve dhe aktiviteti në ekonominë informale, dhe perspektiva e pjesëmarrjes në çdo skemë të mirëqenies për punë do të ishte një nxitje për ta për të lënë regjistrin e papunësisë.

Suksesi i një programi që synon vendosjen e njerëzve në punë të çdo lloji, sesa në punë të duhura dhe të qëndrueshme, është me përfitim të kufizuar. Një studim i madh në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 2018¹⁴ zbuloi se rezultati më i zakonshëm për pjesëmarrësit me mirëqenie për punë ishte një seri punësh afatshkurtra dhe të pasigurta, të shoqëruara me periudha të mëtejshme të papunësisë, sesa një zhvendosje në punë të qëndrueshme të mirëpaguara. Kur paraqitësit e kërkesave kaluan në punë të qëndrueshme, sigurimi i mbështetjes së personalizuar për punën konsiderohej si thelbësor për këtë sukses.

Kutia 4: Irlanda, një shembull i mirë i ndihmës dhënë njerëzve për t'u punësuar

Sipas Zyrës Qendrore të Statistikave (OSHC), ka 135.100 persona të papunë në Irlandë që nga shkurti 2019, një shifër që përfshin 5.6% të të gjithë forcës punëtore. Ka rreth 84,000 njerëz që marrin pjesë në skemat e promovimit të punës.

Sistemi i financuar nga qeveria që ndihmon njerëzit për punësim në Irlandë karakterizohet nga një qasje pozitive dhe jo ndëshkuese për të mbështetur njerëzit që largësohen nga varësia e mirëqenies. Ekzistojnë tre shtylla për këtë: administrimi fleksibël i sistemit të përfitimeve, mbështetja për njerëzit që përgatiten të fillojnë punë dhe angazhimi me

punëdhënësit. E treta e këtyre është një karakteristikë e jashtëzakonshme; shërbimi qeveritar i punësimit punon ngushtë me punëdhënësit në nivelin qendror dhe rajonal për të identifikuar nevojat e forcave të punës dhe për t'i përfshirë ato në programet e ndryshme të krijuara për t'i futur njerëzit në punë të ndershme.

Ekzistojnë disa skema që ndihmojnë njerëzit në punësim.

a) JobPath ka të targetuar njerëzit që janë të papunë afatgjatë dhe njerëzit që janë të papunë rishtas, por që mund të kenë nevojë për mbështetje intensive për të gjetur punë.

b) Iniciativa Tús është një skemë për vende pune për komunitetin që ofron mundësi pune afatshkurtra për njerëzit e papunë.

c) Programi i Punësimit të Komunitetit (CE) është krijuar për të ndihmuar njerëzit që janë të papunë afatgjatë (ose të disavantazhuar për arsye të tjera) të kthehen në punë duke ofruar vende pune me kohë të pjesshme dhe të përkohshme, të cilat janë të bazuara në komunitetet lokale.

d) Ndihmë për personat me aftësi të kufizuara përfshirë tek intervistat; interpretues për njerëzit që nuk dëgjojnë, lexues për njerëzit e verbër.

Janë skema të ndryshme që inkurajojnë punëdhënësit që të angazhojnë njerëzit e papunë.

a) Programi i Hapave të Parë do të bëjë që punëkërkuarit pjesëmarrës të marrin një kurs trajnimi para-punësimit të financuar nga Departamenti për t'i përgatitur ata për punën e tyre të re.

b) JobsPlus Youth stimulon bizneset të punësojnë punëkërkuar të moshës nën 25 vjeç nga Regjistri Direkt duke siguruar pagesa mujore cash për të mënjnauar kostot e pagave.

c) JobsPlus ofron një stimulim financiar për punëdhënësit që rekrutojnë punonjës që ishin të papunë për një kohë të gjatë në Regjistrin Direkt.

d) JobBridge ofron një stazh prej 6-9 muajsh për një person që është regjistruar si i aftë për punë për të paktën tre muaj.

Në lidhje me sanksionet mbi përfitimet si një mjet për t'i futur njerëzit në punë, studimi në Mbretërinë e Bashkuar për vitin 2018 arriti në përfundimin se dënime të tilla kanë bërë shumë pak për të rritur motivimin e njerëzve për t'u përgatitur, kërkuar ose futur në punë. Përfundimi ishte se sanksionet kishin të ngjarë të vinin në situatë të vështirë ata që ishin të prekur nga varfëria, shëndeti i dobët dhe madje edhe krimi për mbijetesë.

Programet që synojnë të balancojnë zvogëlimin e shpenzimeve për mirëqenien me rritjen e të

¹⁴ Studimi i Universitetit të York-ut "Kushtëzimi i Kujdesit Social 2013–2015".



ardhurave të pjesëmarrësve, duke kërkuar nga individët që të marrin pjesë fillimisht në një aktivitet arsimimi ose trajnimi, ose në një aktivitet kërkimi të punës, mund të përmbushin këtë qëllim. Ky lloj programi është i dobishëm njëkohësisht për pjesëmarrësit dhe buxhetin e qeverisë.

Duke u bazuar në përvojë ndërkombëtare, një studim i vitit 2018, i Këshillit Kombëtar Ekonomik dhe Social të Irlandës jep udhëzime specifike se si kërkuesit mund të ndihmohen më mirë në punësim; ky udhëzim është përmbledhur këtu.

Duhet të ketë mbështetje të përshtatur për të gjithë personat e papunë. Në veçanti, mbështetja duhet të jepet duke pasur në konsideratë nevojat e atyre që janë më larg nga tregu i punës; siç janë prindërit e vetmuar, njerëzit me sëmundje/paaftësi, ata me vështirësi në arsim, pa eksperiencë pune, histori varësie ose kohë në burg. Duhet dhënë kohë e mjaftueshme që zyrtarët e çështjeve të angazhohen me përfituesit dhe oficerët e çështjeve më me përvojë dhe më të kualifikuar duhet të merren me rastet më të vështira. Kësaj teme i bëhet jehonë nga udhëzimet e UNDP-it për shërbimet e punësimit në Ballkanin Perëndimor.

Për ata që marrin pjesë në skemat e trajnimit dhe arsimimit të përqendruar në punësim, aktivitete të tilla duhet të jenë të lidhura ngushtë me nevojat e tregut të punës. Duhet të ketë mbështetje të plotë financiare për të mbuluar shpenzimet e atyre që ndjekin kurse arsimore dhe trajnimi. Duhet të bëhet një hulumtim se pse njerëzit që marrin kurse trajnimi nuk përparojnë në punësim.

Mbështetja dhe trajnimi për punësimin duhet të koordinohet me punëdhënësit, dhe punëdhënësit duhet të inkurajohen që të jenë më të gatshëm për të marrë në konsideratë aplikantët që nuk kanë një eksperiencë tipike pune.

5. PROGRAMI I DALJES NGA NE-ja

5.1 Qëllimi dhe objektivat

Objekti i këtij programi është transformimi i skemës ekzistuese të Asistencës Sociale, në një skemë të kalimit të përfituesve nga NE-ja në punësim përmes përfshirjes së prioritetit të përfituesve të punësueshëm të NE-së, në programe të politikave aktive të tregut të punës, (PPATP) bazuar në modele inovative dhe përvoja ndërkombëtare. PATP-të do të synojnë shfrytëzimin e të gjitha mundësive që vijnë nga kryerja e punëve publike në nivel qendror dhe lokal, subvencionimin e punësimit, trajnimet,

internshipet, arsimin profesional si masa të cilat synojnë integrimin dhe rritjen e suksesshëm në tregun e punës të përfituesve të punësueshëm të NE-së, me qëllim final daljen e tyre nga skema e NE-së. PATP-i do të mbështesin rritjen e punësimit dhe rritjen ekonomike nëpërmjet uljes së papunësisë dhe uljes së varësisë nga përfitimi i NE-së.

Politikat Aktive të Tregut të Punës (PATP) të targetuara në mënyrë prioritare të përfituesit e punësueshëm të NE-së, të cilat përfshijnë: i) punët publike janë një nga masat PATP, e cila përfshin një kategori të gjerë të projekteve të infrastrukturës, në bujqësi, transport, turizëm, arsim, shëndetësi të financuara dhe ndërtuara nga qeveria, bashkia ose palë të treta për përdorime të ndryshme nga komuniteti i gjerë; ii) mbështetja e vetëpunësimit dhe të sipërmarrjes që inkurajon pjesëmarrësit të fillojnë biznesin e vet ose të vetëpunësohen, kryesisht përmes skemave të mikrokreditit; iii) internshipet është një masë PATP që ofron mundësinë për të fituar eksperiencë, njohuri dhe aftësi të vlefshme në një mjedis pune për pjesëmarrësin, që mundëson hyrjen e tij në fushën specifike të punës; iv) trajnimi profesional është një masë e PATP-it, që përmbledh aktivitete që sigurojnë pjesëmarrje me aftësitë, njohuritë, kompetencat dhe qasjen e kërkuar për punësim në një profesion të caktuar apo një grup profesionesh në fusha të ndryshme të aktivitetit ekonomik; v) Trajnimi në punë është një tjetër masë e PATP-it që synon t'i mësojë pjesëmarrësit aftësitë, njohuritë dhe kompetencat që nevojiten për të kryer një punë specifike brenda vendit të punës apo mjedisit të punës; vi) Trajnim për ata që futen për herë të parë në tregun e punës është një masë tjetër e PATP-ve që synon të lehtësojë hyrjen në tregun e punës; vii) Subvencimi i punësimit është masë e PATP-ve e targetuar që të nxisë punësimin e grupeve të caktuara pjesëmarrësish të përcaktuara si prioritet,

Një pjesë e këtyre masave të PATP-ve janë, aktualisht, duke u zbatuar në Shqipëri¹⁵; edhe pse

¹⁵ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 16.1.2008, "Programi i nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit në punë", i ndryshuar.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 16.1.2008, "Programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë në vështirësi".

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 27.12.2006, "Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programeve të praktikave profesionale për punëkërkuesit e



përfituesit e NE kanë marrë pjesë në to, këto politika nuk targetojnë në mënyrë specifike apo prioritare përfituesit e NE-së. Plani i Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësimit, 2019–2022 dhe ligji nr. 15/ 2019, “Për nxitjen e punësimit” i përcakton politikat aktive të tregut të punës dhe nga të dhënat e deritanishme¹⁶, janë trajtuar nga zyrat e punësimit 15,000 persona, nga të cilët janë punësuar rreth 4.266 individë dhe janë dërguar në programet e formimit profesional 681 persona, ish-përfitues të skemës së ndihmës ekonomike dhe përfitues aktualë.

Shërbimet sociale ofrohen nga njësitë e qeverisjes vendore, për përfituesit e NE-së, sipas nevojave individuale, kur ato shfaqen, por ato në vetvete nuk ofrohen në funksion të integritetit apo riintegritetit të përfituesve të NE-së në tregun e punës. Qasja dhe llojet e shërbimeve sociale, detyrat edhe përgjegjësitë për ofrimin e këtyre shërbimeve janë të përcaktuara Planin e Veprimit të Strategjisë së Mbrojtjes Sociale dhe në ligjin për kujdesin shoqëror nr. 121/2016. Aksesit i përfituesit të punësueshëm të NE-së në shërbimet sociale, aktualisht mbështetet te zgjidhja apo lehtësimi i nevojës specifike individuale, por nuk shihet si një shërbim plotësues për të realizuar në këtë mënyrë integritetin apo riintegritetin e tyre në tregun e punës përmes PATP-ve.

Sistemi i politikave sociale dhe sistemi i politikave të punësimit, pavarësisht përpjekjeve, operojnë veçmas njëri-tjetrit. Strategjia për Mbrojtjen Sociale dhe Strategjia për Punësim dhe Aftësim nuk kanë një qasje të integruar në trajtimin e problemeve që mbartin të papunët afatgjatë

përfitues të NE-së. Janë bërë përpjekje për të krijuar një mekanizëm ndërinstitucional që synon kalimin e individit nga skema e NE-së në tregun e punës. Shërbimi Social Shtetëror dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi¹⁷, me synim që të realizojnë integritetin e përfituesve të punësueshëm të NE-së në tregun e punës. Zyrat e shërbimeve sociale dhe NE në bashki, Shërbimi Social Shtetëror dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive punojnë në mënyrë të fragmentuar. Këto institucione operojnë në nivele të ndryshme – shërbimet sociale janë të decentralizuara në nivel bashkie, ndërsa shërbimet e punësimit janë të centralizuara – në nivel rajonal. Koordinimi i tyre është i pamjaftueshëm për të lehtësuar integritetin dhe riintegritetin e përfituesve të NE-së në tregun e punës. Kapacitetet vlerësuese të nevojave të individëve (NARU dhe administratorët shoqërorë) kanë nevojë të plotësohen dhe përmirësohen. Informacioni për përfituesit e NE-së është i fragmentuar. Zyra e punës nuk ka akses në Regjistrin Elektronik Kombëtar të NE-së çka vështirëson përgatitjen e një profili të integruar social dhe profesional të individëve përfitues të NE-së – gjë e cila nuk lehtëson procesin e aktivizimit në tregun e punës dhe daljen e individit nga skema e NE-së. Mungon informacioni i integruar dhe një *database* e përbashkët për përfituesit e punësueshëm të NE-së në këto institucioneve.

Dalja nga skema e NE-së dhe integriteti i përfituesve të punësueshëm të NE-së në tregun e punës do të kryhet përmes një mekanizmi ndërinstitucional që është Plani Individual i Veprimit (PIV). PIV-ja harton profilizimin social dhe profesional të individëve përfitues të NE-së, duke përzgjedhur dhe duke kombinuar masat aktive të tregut të punës dhe të shërbimeve sociale të individualizuara për çdo përfitues të NE-së. PIV-ja ndërtohet me kontributin e zyrës për shërbimet sociale në bashki, Shërbimit Social Shtetëror dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive. PIV-ja përfaqëson një zinxhir të thjeshtë vendimmarrjeje që garanton sigurimin e shërbimeve dhe të përfitimeve, në përputhje me nevojat e individit, i cili hyn në procesin e kalimit nga NE-ja në punësim.

papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit”.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 11.1.2012, “Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta”.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 30.4.2014, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara, i ndryshuar.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 64, datë 27.1.2016, “Për programin e nxitjes së punësimit të të rinjve që kanë fituar statusin e jetimit”, i ndryshuar.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 11.1.2012, “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimit të punëkërkuarve të papunë që hyjnë për herë të parë në punë”.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 162, datë 21.3.2018, “Për pagesën e pjesëmarrjes në kurset e formimit profesional”, nxit pjesëmarrjen në kurse të aftësimit profesional të punëkërkuarve të papunë.

¹⁶ Intervistë me Agjencinë Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive.

¹⁷ Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet SHSSH-së dhe SHKP-së nënshkruar në datën 16.2.2018.



Rregulli për daljen nga skema parashikon që individi i përfitues i punësueshëm i NE-së, në momentin e fillimit të zbatimit të PIV-së del jashtë skemës së përfitimi të NE-së. Me mbarimin e kësaj mase, individi në rast se nuk vijon punësimin ka të drejtë të riaplikojë pas një periudhe 1- vjeçare nga e para për përfitimin e NE-së, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në ligjin për asistencën sociale¹⁸ për aplikimin dhe përfitimin e NE-së dhe akteve të tjera nënligjore të përcaktuara në ligj¹⁹. Refuzimi për zbatimin e PIV-së nga individi përfitues i NE-së, rezulton në humbjen e përfitimit të NE-së për një periudhë 1-vjeçare²⁰.

Çdo individ që aplikon për të hyrë apo rihyrë në skemën e NE-së ka të drejtë të ankimojë vendimet e autoriteteve për të cilat gjykon se i kanë shkelur apo nuk i kanë dhënë të drejtat që i takojnë. Procesi i ankimit²¹ rregullohet në ligjin për asistencën sociale dhe parashikon se ku ankimesi mund të dorëzojë me shkrim ankesën e tij – bashki, njësi administrative, struktura rajonale e SHSSH-së – dhe nëse nuk merr zgjidhje të kënaqshme edhe duke ngritur padi në gjykatën administrative. Po ashtu, parashikohen kohët brenda të cilave kryhet ankesa dhe marrja e përgjigjes.

Dalja nga skema e NE-së nuk aplikohet për kategoritë në vijim:

- a) familjet, anëtarët e së cilës janë mbi moshë pune;
- b) familjet me kryefamiljare gra, me të paktën një fëmijë që ndjek arsimin bazë.

Nevojitet që të shtohet gama e kategorive për të cilat mund të mos aplikohet kufizimi në kohë i ndihmës ekonomike, duke përfshirë edhe fëmijët nën moshën 16 vjeç, nënat me një fëmijë më pak se 3 muaj; prindi apo kujdestari i një personi me aftësi të kufizuara; personi që është kujdestar me kohë të plotë për bashkëshorten/in me aftësi të kufizuara; fëmija që ndjek shkollën fillore dhe të mesme me kohë të plotë; prind minoren që ndjek shkollën e mesme; individët e punësuar apo të vetëpunësuar

dhe personat që vuajnë nga paaftësi afatgjata.

5.2 Masat e politikave aktive të tregut të punës për përfituesit e NE-së

PATP-të duhet të prioritzojnë punësimin e përfituesve të NE-së, duke targetuar në mënyrë specifike këto kategori: i. të papunë afatgjatë; ii. të papunë të vështirë për t'u punësuar²²; dhe iii. të rinj të papunë, në përputhje me profilin e përfituesve të NE-së të paraqitur në kapitullin e parë dhe që përbëjnë kategorinë më të disavantazhuar e punëkërkesve të papunë përfitues të NE-së. Për këtë arsye, investimet publike, në tërësi, qendrore dhe lokale, koncesionet, punët komunitare duhet të kushtëzojnë zbatimin e tyre nga palë të treta me punësimin e përfituesve të pabesueshëm të NE-së. Në vijim, propozohen disa masa të cilat ofrojnë këto mundësi dhe janë pjesë e përvojës ndërkombëtare, të tilla si: punët publike, subvencionimi i punësimit dhe edukimi i vazhdueshëm.

Masa 1 - Programi i punëve publike²³

Programet e punëve publike do të adresojnë papunësinë, integrimin në tregun e punës, duke siguruar ndihmë ekonomike për më nevojtarët, ndërsa përmirësojnë njëherësh dhe infrastrukturën apo shërbimet në komunitet. Ato synojnë aktivizimin në punë të punëkërkesve përfitues të NE-së, të vështirë për t'u punësuar, në mënyrë që të ruajnë aftësinë e tyre për punë dhe rrisin mundësinë e integritit në tregun e punës duke dalë nga skema e NE-së.

Zbatueshmëria e programeve të punëve publike do të garantohet nga kryerja e investimeve publike të parashikuara çdo vit në buxhetin e shtetit dhe atë të bashkive, si edhe në ato raste ku palë të treta zbatojnë projekte të financuara nga fonde publike. Investimet publike në nivel qendror dhe lokal që do të shërbejnë si PATP janë të përqendruar në disa sektorë kryesorë, si bujqësia, infrastruktura, turizmi, arsimi, shëndetësia.

Në sektorin e bujqësisë ato përfshijnë:

¹⁸ Ligji nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, neni 15, “Përjashtimi nga ndihma ekonomike” dhe neni 16, “Për aplikimin dhe përfitimin e ndihmës ekonomike”.

¹⁹ VKM-në nr. 597, datë 4.9.2019, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe të përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.

²⁰ Ligji nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, neni 15, “Përjashtimi nga ndihma ekonomike”, pika 2.

²¹ Ligji nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, neni 29, “Ankimimi”.

²² Persona të vështirë për t'u punësuar janë ata të persona që kanë vështirësi për t'u punësuar si rezultat i një gjendjeje mjekësore, arsim të papërshtatshëm apo të pamjaftueshëm, përkatësisë së tyre sociale dhe demografike, mospërputhjes së kërkesës dhe të ofertës në tregun e punës apo rrethana të tjera objektive.

²³ Punët publike përdoren gjerësisht si masa PATP. Mund të përmendim: *Public Works Programme* në Republikën Çeke; *Community service jobs* në Danimarkë; *Public Work* në Estoni, Lituani Poloni, Kroaci etj.; *Temporary employment* në Rumani; *Employment scheme for persons in need* në Portugali etj.



i. Investime në fushën e infrastrukturës së kullimit dhe të ujitjes; ii) infrastrukturës së mbrojtjes nga përmbytja; iii) përmirësimi teknik i hidrovorëve; iv) mbështetje për peshkimin; dhe v. zhvillimi rural.

Në sektorin e **infrastrukturës** përfshijnë:

i. Kontratat koncesionare: ndërtim dhe sistemim rrugesh; ii) siguria rrugore; iii) rikonstruksion portesh; iv) rikonstruksion dhe riparim linjash hekurudhore; v) menaxhim i mbetjeve urbane, vi) furnizimin me ujë dhe kanalizimet; vii) përmirësim dhe rikonstruksionin e godinave për strehimin social.

Në sektorin e **arsimit** përfshijnë:

i. Ndërtim, rehabilitim, rikonstruksion të ambienteve të arsimit bazë, të mesëm të përgjithshëm, arsimit të lartë dhe ambienteve sportive.

Në sektorin e **shëndetësisë** dhe **mbrojtjes sociale** përfshijnë:

i. Rikonstruksion i qendrave shëndetësore dhe spitalore.

Në sektorin e **turizmit** përfshijnë: i) investime për zhvillimin e turizmit; ii) projekti 100 fshatrat.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit:

i. Projektet e zhvillimit në infrastrukturën rrugore, vendore dhe rajonale.

Për aktivizimin e programeve të punëve publike duhen marrë parasysh këto elemente:

Kohëzgjatja e programeve të punëve publike duhet të mbajë parasysh se një program duhet të jetë mjaftueshëm i gjatë që t'i mundësojë pjesëmarrësit të mësojë nga përvoja, të përftojë aftësi të reja dhe të rifitojë zakonet e të punuarit, por jo aq i gjatë sa pjesëmarrësi të mësohet me programin dhe të mos kërkojë më punë në treg.

Intensiteti i programeve të punëve publike duhet të ketë fleksibilitet, i cili duhet të mbajë parasysh kohëzgjatjen e programit dhe kategorinë e pjesëmarrësit. Në të gjitha rastet, orët e punës së detyrueshme duhet të jenë të tilla që t'i lejojnë pjesëmarrësit hapësirë për të kërkuar punë apo për t'u trajnuar. Për programet me kohëzgjatje afatshkurtër, orët e punës mund të variojnë nga 4 deri në 6 orë (kjo mund t'u ofrohet përfituesve të NE-së që i përkasin grup-moshës 15–24, duke u dhënë mundësi që të ndjekin arsim apo kurse profesionale. Për programet me kohëzgjatje 2–12 muaj orët e punës mund të variojnë nga 6 deri në 8 orë në ditë.

Faqe | 15120

Kategoritë e përfituesve NE që duhet të merren në konsideratë për programet e punëve publike janë të papunët afatgjatë, në grup-moshat 15–29 dhe në grup-moshat 45–64, persona të vështirë për t'u punësuar (për t'u riintegruar në tregun e punës) që kanë pengesa të ndryshme, siç mund të jenë ata të cilët kanë një nivel të ulët arsimimi (ata që kanë mbaruar vetëm arsimin e detyrueshëm ose atë 4-vjeçar) apo persona me probleme sociale.

Përfitimi monetar nga pjesëmarrja në programet e punëve publike duhet të jetë më i ulët se paga minimale – *pjesëmarrësi në programet e punëve publike do të përfitojë 100% të pagës minimale ose më shumë.*

Pjesëmarrja – Përfituesit e financimeve publike (fituesit e tenderave apo të të drejtave për të përdorur fonde publike) do të kenë detyrim që të punësojnë individë përfitues të NE-së në mënyrë prioritarë, për gjithë kohën e zbatimit të projektit rreth 5–7% ose edhe më shumë, numrit total të punonjësve që do të angazhohen në kryerjen e punës publike, rast pas rasti, në nivel qendror dhe lokal.

Masa 2 - Subvencionimi i punësimit²⁴

Masa për subvencionimin e punësimit synon të nxisë punësimin e përfituesve të NE-së, aftësimin e tyre, duke nxitur njëherësh dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Punëdhënësit të cilët marrin pjesë në këto programe për një periudhë 9-mujore, do të kenë një bonus prej 2–5 pikësh në çdo tender publik – qendror apo lokal, ku ata marrin pjesë në vitin pasardhës.

Subvencion për punësim të përfituesve të NE-së në punë të reja.

Subvencionimi i punësimit për kategorinë e punëkërkuesve përfitues të NE-së të vështirë për t'u punësuar u jepet si nxitës punëdhënësve në sektorin privat për krijimin e vendeve të reja të punës në të cilat ata do të punësojnë punëkërkuesit përfitues të NE-së të vështirë për t'u punësuar.

Përfitimi monetar – Subvencionimi do të jetë në masën 100% të pagës minimale ose më shumë.

Kategoritë e përfituesve NE – në fokusin e

²⁴ Subvencionimi i punësimit përmes subvencionimit të pagës përdoret, gjithashtu, gjerësisht si PATP. Shembuj që mund të përmendim janë: *Contrat Initiative Emploi* në Francë; *Perspektivën in Betrieben* në Gjermani; *Measures for unemployed representing disadvantaged groups* në Latvia; *Youth Employment Initiative* në Slovaki etj.



kësaj mase do të jenë, veçanërisht: të rinjtë deri në moshën 30 vjeç; persona mbi 50 vjeç; të papunë afatgjatë.

Kohëzgjatja për t'u përcaktuar rast pas rasti.

Subvencione për punësim të përfituesve të NE-së në moshë të re

Kategoritë e përfituesve NE – në fokusin e kësaj mase do të jenë të rinjtë të grup-moshës 16–25, që kanë mbaruar gjimnazin.

Përfitimi monetar – Subvencionimi do të jetë në masën e 100% të pagës minimale.

Kohëzgjatja e financimit të kësaj mase do të përcaktohet rast pas rasti.

Subvencion për punësim për herë të parë të përfituesve të NE-së.

Subvencionimi i punësimit për kategorinë e punëkërkuesve përfitues të NE-së që punësohen për herë të parë u jepet si nxitës punëdhënësve në sektorin privat.

Kategoritë e përfituesve NE – veçanërisht, në fokusin e kësaj mase do të jenë: të rinjtë e grup-moshës 16–25 vjeç.

Përfitimi monetar – subvencioni është në masën 100% të pagës minimale dhe shoqërohet edhe me financim të trajnimit të punëmarrësit nga punëdhënësi.

Kohëzgjatja e financimit do të përcaktohet rast pas rasti (muaj).

Masa 3 - Edukim dhe trajnim i mëtijshëm

Trajnim në përgjigje të nevojave të tregut

Kjo masë synon ofrimin e trajnimeve për punëkërkues përfitues të NE, që këta të fundit të fitojnë njohuri teorike dhe praktike, dhe aftësi të nevojshme për tregun e punës dhe të punëdhënësit dhe të jenë në gjendje të rrisin mundësitë për t'u punësuar.

Në fokusin e kësaj mase do të jenë kategoria që paraqet vështirësi për t'u punësuar me kualifikime të ulëta në grup-moshën 15–34 vjeç.

Pjesëmarrësit në trajnim do të përfitojnë një pagesë shtesë mbi NE-në, siç parashikohet në legjislacion.

Kohëzgjatja e kësaj mase është e barabartë me programin e trajnimit.

Stazh pune në një ndërmarrje (Internship)

Kjo masë synon që punëkërkuesi përfitues i NE-së të fitojë njohuri dhe eksperiencë për të kryer detyrat në punë specifike.

Kategoria që do të përfitojë nga kjo masë janë të rinjtë në grup-moshën 15–34 vjeç që nuk kanë pasur

eksperiencë të mëparshme në llojin e punës për të cilën kryejnë internshipin.

Pjesëmarrësit në internship do të përfitojnë një pagesë sa paga minimale.

Punëdhënësi do të rimbursohet për kostot e trajnimit, të rëna dakord në marrëveshje midis punëdhënësit dhe zyrës së punësimit.

Kohëzgjatja e internshipit nuk do të jetë më shumë se 6 muaj, por punëmarrësi duhet ta mbajë pjesëmarrësin në punë edhe për një periudhë 3-mujore.

Programet shoqëruese dhe riaftësimi duhet të kryhen gjatë dhe paralel me periudhën e punësimit të përfituesit të NE-së në programet e punëve publike. Këto programet mund të jenë trajnime, këshillime për pjesëmarrësit dhe për punëdhënësit. Sa më të personalizuar – sipas aftësive të pjesëmarrësit – të jenë programet e punëve publike dhe programet shoqëruese të tyre aq më shumë përfiton pjesëmarrësi. Nga ana tjetër pjesëmarrësi mund të përfitojë edhe nga punësimi në fusha ku nuk ka punuar më parë, sepse kështu i rriten aftësitë dhe mundësitë për punësim në tregun e punës.

Programet shoqëruese me të zakonshme janë trajnimet që bashkëshoqërojnë programin e punëve publike – kjo, për shkak se pritet që pjesëmarrësit të jenë me aftësi të ulëta dhe kjo u rrit atyre mundësitë e punësimit. Programet e tjera shoqëruese, më të përdorura pas trajnimit, janë sigurimi i trajnimit/instruktorit individual. Për të gjithë pjesëmarrësit në programet e punëve publike mund të ofrohet asistencë për të kërkuar pune, gjatë kohës që je i angazhuar në program.

Eksperiencia e deritanishme ka treguar se zbatimi i PATP-ve nuk është i mjaftueshëm për të integruar përfituesit e NE-së të punësueshëm në tregun e punës. PATP-të duhet të plotësohen, shoqërohen apo përfshihen në një kontekst me të gjerë përfitimesh dhe shërbimesh sociale, që lehtësojnë procesin e punësimit të përfituesit të NE-së dhe daljen nga skema, për arsye se në shumicën e rasteve kemi të bëjmë me papunësi afatgjatë dhe probleme komplekse që pengojnë integrimin në tregun e punës. Për këtë arsye, qasja që do të përdoret është sigurimi i shërbimeve të kujdesit social të individualizuara si mjet që lehtëson përfshirjen e priorizuar të përfituesve të punësueshëm të NE-



së në programe të politikave aktive të tregut të punës (PPATP).

Shërbimet e kujdesit social që synojnë lehtësimin e aksesit në tregun e punës për përfituesit e punësueshëm të NE-së, të cilat përfshijnë: shërbime të kujdesit shëndetësor apo në shërbimet që luftojnë varësitë nga alkooli apo nga substancat, që i mundësojnë individit përfitues të NE-së të ketë shëndet të mirë kur paraqitet për të kërkuar punë: Shërbime të kujdesit për fëmijët, për prindërit (sidomos për nënat kryefamiljare apo prindërit e rinj) që ata të kenë mundësi të kërkojnë për punë, të ndjekin kurse trajnimi apo të marrin pjesë në programe të tjera aktivizimit në tregun e punës; shërbime për kujdes ndaj të moshuarve, duke i lehtësuar punësimin dhe qëndrimin në punë të familjarëve të tyre, që përndryshe do të ishin të detyruar të mos mermin pjesë në tregun e punës; shërbime strehimi, shumë të rëndësishme që të mundësojnë një mjedis stabil jetese për personat që janë të papunë afatgjatë; shërbime mbështetëse për kapërcyer vështirësiti psikologjike për personat me varësi të ndryshme, viktimat e trafikimit apo të dhunës në familje; shërbime rehabilitimi për përfituesit e NE-së me aftësi të kufizuara etj. Të gjitha këto shërbime kontribuojnë në autonominë e personave përfituesve të punësueshëm të NE-së dhe lehtësojnë hyrjen apo riintegrimin e tyre në tregun e punës.

5.3 Procesi i përgatitjes së Planit Individual të Veprimit dhe institucionet përgjegjëse

Plani Individual i Veprimit (PIV) është mekanizmi i bashkërendimit ndërinstitucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë pune të familjeve përfituese të NE-së, në mënyrë që të sigurohet integrimi apo riintegrimi i tyre në tregun e punës dhe dalja nga skema e NE-së. PIV-ja harton profilizimin social dhe profesional të individëve përfitues të NE-së, duke përzgjedhur dhe kombinuar masat aktive të tregut të punës dhe shërbimeve sociale të individualizuar për çdo përfitues të NE-së. PIV-ja ndërtohet me kontributin e zyrës për shërbimet sociale në bashki, Shërbimit Social Shtetëror dhe Agjencisë Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive. PIV-ja përfaqëson një zinxhir të thjeshtë vendimmarrje që garanton sigurimin e shërbimeve dhe të përfitimeve, në përputhje me nevojat e individit i cili hyn në procesin e kalimit nga NE-ja në punësim.

PIV-ja është e përbërë nga 3 pjesë:

1. Të dhënat e përgjithshme;
2. Plani individual i shërbimeve sociale; dhe
3. Plani individual i punësimit.

PIV-ja është një dokument që krijohet dhe përpunohet në format elektronik nga institucionet përkatëse dhe zyra e punësimit, bashkia dhe Shërbimi Social Shtetëror kanë akses në kohë reale në sistemin e këtyre të dhënave (REK-ja është pjesë integrale e këtij sistemi).



Hartimi i Planit Individual të Veprimit kalon në disa faza.

HAPI I
PARE

Administratori shoqëror bazuar në Nenin 23 të Ligjit për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë nr. 57/2019 identifikon individet në nevojë dhe i fton të aplikojnë për ndihme ekonomike;

HAPI I
DYTË

Individi që kërkon të aplikojë për NE paraqitet në Zyrën Rajonale të Punësimit dhe regjistrohet si Punëkëkues i papunë;

HAPI I
TRETË

Individi aplikon në Regjistrin Elektronik Kombëtar pranë Bashkisë për të përfituar NE; struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki plotëson aplikimin për NE në bazë të vetëdeklarimit të aplikuesit; Administratori shoqëror brenda muajit, bën verifikimin në terren dhe dërgon aplikimin pranë Shërbimit Social Shtetëror;

HAPI I
KATËRT

Shërbimi Social Shtetëror merr vendimin për aprovimin e aplikimit për NE dhe njofton strukturën përkatëse në bashki se aplikanti është pranuar apo refuzuar si përfitues i NE; njëherësh njofton edhe Zyrën Rajonale të Punësimit që individi i punësueshëm i regjistruar më parë si i papunë është përfitues i NE.

HAPI I
PESTË

Struktura përgjegjëse për Shërbimet Sociale në Bashki plotëson të dhënat e nevojshme për Planin Individual të Shërbimeve Sociale – këto të dhëna janë:

Të dhëna të Përgjithshme – emër, mbiemër, gjinia, mosha, vendbanimi, përbërja familjare, edukimi, profesioni, eksperiencia në punë
Të dhëna specifike – nevojat për shërbime sociale që përbëjnë pengesë për punësim, të tilla si: probleme shëndetësore, varësinga alkoli apo substancat, viktima të trafikimit apo dhunës në familje, strehimi

HAPI I
GJASHTË

Struktura përgjegjëse për Shërbimet Sociale në Bashki harton Planin Individual të Shërbimeve Sociale dhe inicion zbatimin e tij;

HAPI I
SHTATË

Zyra Rajonale e Punësimit mbi bazën e informacionit të mbledhur nga Shërbimi Social Shtetëror dhe bashkia harton Planin Individual të Punësimit i cili bazohet në mundësitë aktuale të masave aktive të tregut të punës (punë publike, subvencion page, internship etj.) në aftësitë dhe eksperiencën e përfituesit të NE;

HAPI I
TETË


Plani Individual i Punësimit dhe Plani Individual i Shërbimeve Sociale integrohen së bashku në Planin Individual të Veprimit për daljen nga skema e NE. Në momentin kur PIV fillon të zbatohet, përfituesi i NE konsiderohet i dalë nga skema e Ndihmës Ekonomike dhe nuk mund ta përfitojë më atë. Bashkia dhe Shërbimi Social Shtetëror njoftohen në kohë reale për fillimin e zbatimit të PIV dhe daljen nga skema e NE të përfituesit të punësueshëm.

HAPI I
NËNTË

Zyra Rajonale e Punësimit dhe Administratori Shoqëror monitorojnë zbatimin e PIV – pjesëmanjen në masën aktive të tregut të punës. |



Procesi i bashkërendimit institucional për hartimin e PIV-së



5.4 Përfshirja e përfituesve të NE-së në masat aktive të tregut të punës në 2020–2022 dhe institucionet përgjegjëse

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë përgjegjëse për hartimin e politikave për integrimin në tregun e punës të përfituesve të NE-së dhe për integrimin e këtyre masave në planin e veprimit, sipas Strategjisë Kombëtare të Punësimit. Ministrinë janë përgjegjëse për monitorimin dhe për vlerësimin e zbatimit të masave në mënyrë periodike dhe raportimit të bërë në përmbushjen e objektivave. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dhe Shërbimi Social Shtetëror dhe bashkitë janë institucionet përgjegjëse për zbatimin e programeve të PATP-ve për përfituesit e punësueshëm të NE-së për rritjen e mundësive të tyre që të punësohen sa më shpejt, sipas aftësive, duke u dhënë atyre mbështetje për riintegrimin e suksesshëm në tregun e punës.

VENDIM Nr. 884, datë 27.12.2019

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 391, DATË 3.5.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË REGJISTRIMIT DHE TË PUBLIKIMIT NË QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 76, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 391, datë 3.5.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 28, të kreut IV, pas fjalëve “... të paktën nëpërmjet nënshkrimit elektronik të



avancuar ...” shtohen “... të formularit të aplikimit ...”.

2. Në kreun VIII bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) në pikën 61 bëhen këto ndryshime:

i. fjalët “... dhe që nuk i kanë depozituar më parë sipas afatit të parashikuar në pikën 5, të nenit 22, të ligjit të regjistrimit të biznesit ...” hiqen;

ii. fjalët “... jo më vonë se 7 muaj nga data e mbylljes së çdo viti financiar” zëvendësohen me “... nëpërmjet sportelit elektronik, brenda 7 muajve nga data e mbylljes së çdo viti financiar, jo më vonë se data 31 korrik.”.

b) Pikat 62, 63 dhe 64 ndryshohen, si më poshtë vijnë:

“62. Nëse një subjekt nuk përmbush detyrimin sipas pikës 61, të këtij kreu, atëherë QKB-ja zbaton sanksionin e parashikuar në pikën 3, të nenit 74, të ligjit të regjistrimit të biznesit.

63. Me refuzimin e aplikimit për depozitimin e pasqyrave financiare, subjektet kanë të drejtë të riaplikojnë për depozitimin e tyre, jo më vonë se 7 muaj nga data e mbylljes së çdo viti financiar, brenda datës 31 korrik. Riparaqitja e aplikimit për depozitimin e pasqyrave financiare, pas refuzimit, trajtohet si aplikim i ri.

64. Kundërvajtja administrative, e parashikuar në pikën 3, të nenit 74, të ligjit të regjistrimit të biznesit, nuk zbatohet për subjektet që kanë njoftuar pezullimin e veprimtarisë, në përputhje me nenin 44, të po këtij ligji.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 885, datë 24.12.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 750, DATË 27.11.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPALLJEN E GJENDJES SË FATKEQËSISË NATYRORE NË QARQET DURRËS, LEZHË DHE TIRANË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 100, 170, 174, pika 2, të Kushtetutës, dhe të pikës 2, të nenit 39, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, me

propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1, e vendimit nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë, si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, deri në datën 31.3.2020.”.

2. Ngarkohet Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 886, datë 30.12.2019

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN 2019, PËR MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE PËR INSPEKTIMIN DHE VLERËSIMIN E DËMEVE NË NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE, TË PREKURA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26.11.2019

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 13, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, dhe të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për përballimin e shpenzimeve për inspektimin dhe vlerësimin e thelluar të dëmeve në njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi, të prekura nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019, në buxhetin e miratuar për vitin 2019 i shtohet fondi prej 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekësh, nga i cili:

a) 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë si shpenzime korente për Bashkinë Tiranë, sipas kërkesave të përcaktuara në lidhjen nr. 1;

b) 40 000 000 (dyzet milionë) lekë në formën e transfertës, në artikullin 604, për Institutin e

Ndërtimit, sipas kërkesave për bashkitë e tjera të përcaktuara në lidhjen nr.1.

2. Vlera prej 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekësh përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2019.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Instituti i Ndërtimit dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas lidhjes nr.1 për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LIDHJA NR.1

TABELA ME PËRMBAJTJEN E KËRKESAVE TË BASHKIVE PËR INSPEKTIM DHE VLERËSIM TË THELLUAR TË PALLATEVE DHE NDËRTESAVE INDIVIDUALE

Nr.	Bashkia	Pallate	Ndërtesa individuale
1.	Tiranë	448	548
2.	Durrës	62	557
3.	Kavajë	25	30
4.	Shijak	30	550
5.	Vorë	20	596
6.	Kamëz	12	150
7.	Krujë	93	1500
8.	Kurbini	58	401
9.	Lezhë	14	214
10.	Mirditë	2	77
	Totali	764	4623

VENDIM

Nr. 888, datë 31.12.2019

**PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E ARKIVIT
SHTETËROR TË SISTEMIT GJYQËSOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18/4, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të neneve 20, pika 4, dhe 21, pika 2, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e

administratës shtetërore”, me propozim të ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**I. ORGANIZIMI I ARKIVIT SHTETËROR
TË SISTEMIT GJYQËSOR**

1. Pranë Ministrisë së Drejtësisë funksionon Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor (gjykatat dhe prokuroritë), me seli në Tiranë.

2. Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor është institucion publik buxhetor, në varësi të ministrit të Drejtësisë dhe gëzon personalitet juridik.

3. Struktura dhe organika e Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor miratohen me urdhër të



Kryeministrit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

4. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil.

5. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë në Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor rregullohen sipas Kodit të Punës.

II. DETYRAT DHE FUNKSIONIMI I ARKIVIT SHTETËROR TË SISTEMIT GJYQËSOR

6. Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor ka për mision ruajtjen, përpunimin dhe administrimin e dokumentacionit gjyqësor e hetimor, i cili i nënshtrohet procedurës së arkivimit nga gjykatat dhe prokuroritë, sipas ligjit për arkivin.

7. Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor kujdeset për menaxhimin e arkivave të gjykatave dhe të prokurorive, nëpërmjet aplikimit të teknikave të unifikuara për krijimin, përdorimin, mirëmbajtjen, ruajtjen, transferimin dhe asgjësimin e dosjeve, të regjistrave dhe të dokumenteve të tjera gjyqësore e hetimore si dhe sigurimin e aksesit për të interesuarit.

8. Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor mban dhe përditëson regjistrin, në formë shkresore dhe elektronike, të të dhënave për dokumentacionin gjyqësor e hetimor që i nënshtrohet procedurave të përpunimit dhe të administrimit. Formatit dhe përmbajtja e regjistrit përcaktohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë, me propozimin e drejtorit të Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor.

9. Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor ka të drejtë të kërkojë dhe të verifikojë, nga kancelarët e gjykatave dhe prokurorive zbatimin e njësuar të shërbimit arkivor gjyqësor e hetimor, si dhe çdo informacion, të cilin e konsideron të nevojshëm për ushtrimin e funksioneve të ngarkuara.

10. Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor, nën kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë, bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, për

zbatimin e metodologjisë profesionale, të rregullave dhe të kërkesave të ligjit për arkivat.

11. Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor drejtohet dhe përfaqësohet nga drejtori, i cili i raporton ministrit të Drejtësisë.

12. Drejtori i Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor ushtron kompetencat e mëposhtme:

a) drejton veprimtarinë e përditshme të institucionit;

b) përfaqëson institucionin në marrëdhënie me të tretët;

c) bashkëpunon me gjykatat dhe prokuroritë për realizimin e procedurave për transferimin dhe asgjësimin e dosjeve gjyqësore e hetimore, në përputhje me kriteret dhe rregullat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për arkivat;

ç) i propozon për miratim ministrit të Drejtësisë rregulloren e brendshme organizative të institucionit dhe çdo akt tjetër normativ të nevojshëm për procedurën në lidhje me caktimin e rregullave për administrimin e dosjeve gjyqësore e hetimore;

d) miraton rregullat tekniko-profesionale, metodikën dhe tipologjinë e unifikuar për shërbimin arkivor gjyqësor e të prokurorisë;

dh) kryen detyra të tjera të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, ligji dhe aktet nënligjore për arkivat, si dhe për organizimin e funksionimin e administratës shtetërore.

III. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

11. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë.

12. Vendimi nr. 903, datë 17.12.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e arkivit shtetëror të sistemit gjyqësor”, shfuqizohet.

13. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 1008 lekë